

# **ZBATIMI DHE NDIKIMI I INOVACIONEVE MËSIMORE NË MËSIMDHËNIE NË SHKOLLAT FILLORE TË REGJIONIT TË ANAMORAVËS SË KOSOVËS**

Fatmir Agaj


Dorëzuar  
Universitetit Europian të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në  
Departamentin e Shkencave Sociale me profil Pedagogji, për marrjen e  
gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ylljet Aliçka

Numri i fjalëve: 53789

Tiranë, Prill 2018



## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim është shkruar prej meje. Nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Fatmir Agaj.

2018

---

## **ABSTRAKTI**

Studimi shkencor me temën: “Zbatimi dhe ndikimi i inovacioneve mësimore në mësimdhënie në shkollat fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës”, ka si qëllim që të eksplorojë situatën aktuale të zbatimit të inovacioneve mësimore në mësimdhënie në shkollat fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës (RAK) si dhe ndikimin e tyre në arritjet e rezultateve më të mira në mësimdhënie.

Kërkimi është realizuar nga gërshetimi i hulumtimit të literaturës me kërkimin operacional. Konkretisht, gjatë hulumtimit fillestar është grumbulluar literaturë bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nga shqyrtimi kritik i literaturës, kemi nxjerrë konkludime në problematikat (kapitujt) kryesorë, si: Qasja teorike e punimit; Vështrimi teorik dhe historik i evoluimit të inovacioneve mësimore; Rolet e mësimdhënësit inovator dhe modele inovative të mësimdhënies.

Gjatë kësaj pune kërkimore është përdorur një metodologji mikse. Kjo metodologji, burim kryesor ka instrumentet matëse, si pyetëtorët për nxënës dhe mësimdhënës si dhe intervistat me drejtorët e shkollave fillore, duke i sistemuar të dhënat në tabela dhe grafikë të përpunuar me programin SPSS.

Procesi i kampionimit është realizuar duke stratifikuar popullsinë e shkollave fillore në 480 nxënës, 240 mësimdhënës dhe intervistat e zhvilluara me 6 drejtues të shkollave fillore. Në këtë hulumtim kemi përfshirë 6 shkolla të tri komunave të kësaj ane, siç janë: dy shkolla fillore nga komuna e Gjilanit, dy nga komuna e Kamenicës dhe dy nga komuna e Vitisë. Në hulumtimin tonë kemi përfshirë gjithsej 726 subjekte hulumtimi.

Për t`u ballafaquar me sukses mësimdhënësit me sfidat inovative të shekullit XXI, patjetër paraqitet nevoja për një ndryshim dhe reformim të roleve dhe funksioneve ekzistuese të tyre, me qëllim që njohuritë e nxënësve të jenë më të thella, duke vërtetuar edhe hipotezën kryesore, e cila tregon se:

Mësimi inovativ në klasë ndikon në ngritjen e rendimentit të cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies.

Për të vërtetuar problemin në fjalë, kemi bërë edhe pyetje kërkimore të hulumtimit: Si ndikojnë inovacionet mësimore në ngritjen e rendimentit dhe të cilësisë në punën mësimore edukative?

Qëllimi i këtij punimi është që të kontribuojë në diskutimin e gjithanshëm që është duke u zhvilluar për reformën e arsimit në vendin tonë, për t`i nxitur faktorët përgjegjës që të mendojnë dhe të marrin masa konkrete përkatëse në reformimin e konceptit, të organizimit, përmbajtjeve, mjeteve, formave dhe metodave të reja në mësimdhënie.

**Fjalët kyçe:** *Inovacione mësimore, mësimdhënie inovative, mësimdhënës inovator, aktivitete të reja, reformë në arsim, motivim për të nxënësit, qasje e re në mësimdhënie, teknikë, teknologji.*

## **ABSTRACT**

The scientific study on the topic: "The implementation and impact of innovations in the teaching process in primary schools in the region of Anamorava in Kosovo" aims to explore the current situation of the implementation of innovations in the teaching process in primary schools in the region of Anamorava in Kosovo (RAK ), as well as their impact on enhancing better results in students.

The research was utilized through a combination of the literature review and with an operational research. Hence, national and international contemporary literature review was done by the researcher. Having done a critical literature review specific chapters have been concluded such as: The theoretical approach of the research paper; The historical evolution of the educational innovations; The roles of innovative teachers and teaching models.

When it comes to data collection methods, there are two research approaches used for this dissertatio: quantitative and qualitative. Questionnaires with students as well as interviews with elementary schools directors were compiled. The findings are further illustrated in tables and graphics processing SPSS program.

The target of this study included 480 students, 240 teachers and 6 elementary school directors. Hence, 6 elementary schools of three different municipalities were part of this dissertation. Additionally, two elementary schools in the municipality of Gjilan, two from the municipality of Kamenica and the last two other schools from the municipality of Vitia. The overall population of this particular research paper consisted 726 respondents in total.

What is more, there are a lot of challenges that teachers face when dealing with innovations of the 21st century, that is why there is a need for a change and reformation of their existing roles and functions, so that students' knowledge is more profound, proving the main hypothesis which suggests: Teaching innovations have a great role in the enhancement of the quality of teaching and learning in school.

In order to find an answer to the proposed problem, a research question was set at the initial phase: 'How do teaching innovations influence the enhancement of efficiency and quality in educational teaching work?'

This research paper aims at contributing in the overall discussions in relation to various reforms newly implemented in the educational process in the state of Kosovo. Also, it aims at enhancing responsible factors in order to analyze and make specific rules in finding the problems in such reforms such as in: the organization of the lesson, contents, tools, forms and new teaching methods.

**Key words:** *educational innovations, innovative teaching, innovative teachers, educational reforms, motivation to learn, new approach to teaching, teaching/ learning techniques, technology.*

## **DEDIKIMI**

Punimin tim ua dedikoj dy shpresave më të shtrenjta të jetës sime: Vesës dhe Artit!

## FALËNDERIME

Për realizimin e punimit me temë: "Zbatimi dhe ndikimi i inovacioneve mësimore në mësimdhënie në shkollat fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës" kanë kontribuar shumë persona, të cilët i falënderoj tej mase.

Fillimisht, do të doja të falënderoja udhëheqësin tim shkencor, tani të ndjerin Prof. dr. Musa Kraja, që asnjëherë nuk hezitoi në mbështetjen time, si: me këshilla, sugjerime dhe udhëheqje profesionale. Andaj, profesor Musain do ta kujtoj me mall dhe në mendjen time ai do të mbetet përgjithmonë i paharruar.

Për vazhdimin e punimit të disertacionit të lënë nga i ndjeri Prof. Musai, falënderoj shumë udhëheqësin profesional, Prof. dr. Ylljet Aliçkajn, për përkushtimin, këshillat dhe ndihmën profesionale që më dha deri në variantin përfundimtar të punimit të disertacionit.

Falënderoj gjithashtu edhe Prof. dr. Tomi Treska, i cili për herë të parë, me një ton vërtet pedagogu, më këshilloi dhe më ndihmoi lidhur me caktimin dhe zgjedhjen e tematikës së punimit.

Falënderoj kolegët e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë në Universitetin European të Tiranës për ndihmën dhe bashkëpunimin e ndërsjellë.

Falënderoj drejtoritë komunale të arsimit të regjionit të Anamoravës së Kosovës lidhur me ndihmën dhe bashkëpunimin për mundësinë e lejimit të anketimit të nxënësve, mësimdhënësve dhe drejtorëve.

Falënderoj gjithashtu drejtorët apo udhëheqësit e SHFMU publike për mikpritjen, ndihmën dhe mirëkuptimin e treguar.



Falënderoj nxënësit dhe mësuesit e shkollave fillore për bashkëpunim serioz lidhur me anketimin e tyre, të cilët më mirëkuptuan dhe me shumë dëshirë më ndihmuan në plotësimin e pyetësorëve.

Një falënderim tjetër, që asesi nuk do ta harroj, vlen për familjen time, e cila pa asnjë dyshim më përkrahu moralisht dhe financiarisht dhe tani jam këtu falë asaj.

Një falënderim i veçantë shkon për bashkëshorten time, e cila për asnjë moment nuk ndaloi në përkrahjen time morale, së cilës do t'i jem mirënjohës gjatë gjithë jetës.

Ju faleminderit të gjithëve!

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

ABSTRAKTI .....	3
ABSTRACT .....	5
DEDIKIMI .....	7
Lista e figurave.....	14
LISTA E TABELAVE .....	17
LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORIT .....	21
KAPITULLI I: HYRJE .....	22
1.1. Shtrimi i problematikës së punimit.....	22
1.2. Përcaktimi i termit inovacion .....	28
1.3. Qëllimi i hulumtimit .....	31
1.4. Nevoja dhe rëndësia e hulumtimit .....	32
1.5. Detyrat e hulumtimit .....	33
1.6. Pyetjet kërkimore.....	35
1.7. Hipotezat e hulumtimit.....	35
1.8. Struktura e tezës së disertacionit.....	36
KAPITULLI II: VËSHTRIMI TEORIK I INOVACIONEVE NË ARSIM.....	38
2.1. Disa faktorë objektivë dhe subjektivë që kushtëzojnë mësimdhënien inovative .....	38
2.2. Teoritë bashkëkohore për mësimdhënien.....	46
2.3. Roli i inovacioneve mësimore në aspektin pedagogjik .....	50
2.4. Roli i inovacioneve mësimore në aspektin psikologjik.....	52
2.5. Përpyqjet rreth pasurimit të shkollave me inovacione mësimore.....	55
2.6. Ndikimi i mësimdhënies inovative në shkollën e shekullit XXI .....	57
2.7. Ndikimi i infrastrukturës bashkëkohore në shkollat inovative .....	60
2.8. Shkolla inovative për një të nesërme më të mirë .....	64

2.9. Vështrim historik i inovacioneve mësimore në shkollat fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës .....	67
2.10. Gjendja aktuale e mësimdhënies në shkollat fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës .....	79
2.11. Demokratizimi i mëtejshëm i mësimdhënësve dhe mësimdhënies .....	82
<b>KAPITULLI III: ROLET E MËSIMDHËNËSVE INOVATORË - MODELE TË SUKSESEVE NË MËSIMDHËNIE.....</b>	<b>85</b>
3.1. Rolet e mësimdhënësve inovatorë dhe ndikimi i tyre në organizimin e mësimdhënies..	85
3.1.1. Mësimdhënësit inovatorë ekspertë për gjetjen e inovacioneve mësimore .....	89
3.1.2. Mësimdhënësit inovatorë - menaxhues aktivë të klasës .....	94
3.1.3. Mësimdhënësit inovator, këshilltarë të denjë për të ardhmen e gjeneratave .....	97
3.1.4. Mësimdhënësit krijues, organizatorë kyç në përparim të shkollës .....	99
3.1.5. Mësimdhënësit inovatorë në rolin e aktorit në klasë .....	103
3.1.6. Mësimdhënësit hulumtues të inovacioneve mësimore .....	105
3.1.7. Mësimdhënësit inovatorë, pjesëmarrës të përpunimit të kurrikulës shkollore .....	108
3.1.8. Mësimdhënësit vendimmarrës në gjetjen e inovacioneve mësimore .....	111
3.1.9. Mësimdhënësit inovatorë në përshtatje të veçorive individuale të nxënësve.....	1164
3.1.10. Mësimdhënësit e shekullit XXI kreativë dhe nxitës të të nxënësve .....	116
3.1.11. Mësimdhënësit inovatorë motivues dhe model për nxënies të suksesshme .....	123
3.2. Dallimet mes mësimdhënësve tradicionalë dhe mësimdhënësve inovatorë .....	126
3.3. Modele dhe teknika inovative në mësimdhënie.....	133
3.3.1. Mësimi alternativ - nevojë e interesit të nxënësve dhe shoqërisë .....	136
3.3.2. Mësimi ekipor, model për mësimdhënie bashkëkohore .....	138
3.3.3. Mësimi në grupe, model pune për mësimdhënie të avancuar .....	141
3.3.4. Mësimi i individualizuar, përparësi reale në arritjen e rezultateve më të mira .....	145
3.3.5. Mësimi ekstrakurrikular, përparësi për thellim të mëtejshëm të njohurive të reja ....	148
3.3.6. Mësimi hap pas hapi, kërkesë reale për individualizimin e plotë të të nxënësve .....	151
3.3.7. Mësimi me projekte ballafaqim konkret me veprimtaritë praktike .....	153

3.4. Devijimet e mundshme të inovacioneve mësimore në mësimdhënie .....	158
<b>KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E STUDIMIT .....</b>	<b>169</b>
4.1. Dizajnimi i hulumtimit .....	169
4.2. Metodatat e hulumtimit .....	172
4.3. Instrumentet e hulumtimit .....	173
4.4. Kampioni i hulumtimit .....	175
4.5. Variablat .....	176
4.6. Vlefshmëria dhe besueshmëria e studimit .....	177
4.7. Etika .....	179
4.8. Kufizimet e studimit .....	180
<b>KAPITULLI V: ANALIZË EMPIRIKE .....</b>	<b>182</b>
5.1 ANALIZA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE .....	182
5.2 TESTI I BESUESHMËRISË .....	183
5.3 Të dhënat deskriptive - Nxënësit .....	184
5.4 Të dhënat deskriptive - Mësimdhënësit .....	202
5.5 INTERPRETIMI I INTERVISTAVE .....	220
5.6 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE .....	241
<b>KAPITULLI VI: PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>253</b>
6.1 Përfundimet .....	253
6.2 Rekomandimet .....	255
<b>LITERATURA: .....</b>	<b>256</b>
Burime parësore .....	256
Burime dytësore .....	263
Burime nga interneti .....	269
<b>SHTOJCA 1 .....</b>	<b>271</b>
Pyetësor për nxënës .....	271

SHTOJCA 2 .....	273
Pyetësor për mësimdhënës .....	273
SHTOJCA 3 .....	275
Intervistë me drejtorët e shkollave fillore .....	275
Hulumtim eksplorues .....	276
SHTOJCA 4 .....	280
Kërkesë Drejtorisë Komunale të Arsimit .....	280

## LISTA E FIGURAVE

Figura: 1 Shkolla dhe komuniteti kanë prioritet ndryshimet qe sjellin rezultate më të mira ne shkollë .....	185
Figura: 2 Mjedisi shkollor nxit dhe zhvillon aftësitë tuaja individuale?.....	186
Figura: 3 Mësimdhënësit diskutojnë me ju lidhur me përzgjedhjen e strategjive të reja mësimore? .....	187
Figura: 4 Mësimdhënësit ju angazhojnë të njiheni me teknika dhe teknologji të reja mësimore? .....	188
Figura: 5 Përzgjedhjet apo aktivitetet mësimore nga mësimdhënësit,.....	189
Figura: 6 Në shkollën tuaj jeni të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies?.....	190
Figura: 7 Mësimdhënësit zbatojnë mjete, metoda, teknika dhe teknologji inovative mësimore? .....	191
Figura: 8 Mësimdhënësit përshtatin inovacionet mësimore me përmbajtjet mësimore? .....	192
Figura: 9 Në momentet e paraqitjes së inovacioneve mësimore, ndiheni të motivuar për nxënie? .....	193
Figura: 10 Mësimdhënësit shpesh zbatojnë inovacionet mësimore në klasë? .....	194
Figura: 11 Aktivitetet inovative në klasë janë nxitës të mirë për të nxënë? .....	195
Figura: 12 Gjërat e reja ju tërheqin më shumë për të mësuar?.....	196
Figura: 13 Jeni kureshtarë për të mësuar diç të re nga mësimdhënësit? .....	197
Figura: 14 Është tërheqëse ora mësimore atëherë kur mësimdhënësit zbatojnë inovacione mësimore?.....	198
Figura: 15 Është tërheqëse ora mësimore atëherë kur mësimdhënësit zbatojnë inovacione mësimore?.....	198
Figura: 16 . Inovacionet mësimore, ndikojnë që rezultatet në shkollë-klasë të jenë më të mira?.....	199
Figura: 17 . Inovacionet mësimore ndikojnë mjaftueshëm në ngritjen e rezultateve mësimore? .....	200
Figura: 18 Jeni të kënaqur me rezultatet që dalin nga mësimdhënia inovative?.....	201
Figura: 19 Në shkollën tuaj, ka kushte të mjaftueshme për zbatimin e strategjive të reja mësimore? .....	202
Figura: 20 Shkolla ju nxitë në zbatimin e mësimdhënies bashkëkohore? .....	203

Figura: 21 Bashkëpunoni me kolegët tuaj lidhur me gjetjen e mundësive më të mira për mësimdhënie?.....	204
Figura: 22 Shkolla juaj është në rrjedha të ndryshimeve inovative? .....	205
Figura: 23 Shkolla juaj është e pasur me teknologji të re mësimore?.....	206
Figura: 24 Shkolla juaj ka nevojë për ndryshime në teknikë dhe teknologji të re mësimore? .....	207
Figura: 25 Zbatoni metoda dhe teknika të reja mësimore në mësimdhënies? .....	208
Figura: 26 Jeni në përcjellje të ndryshimeve inovative që ndodhin në shkollë dhe jashtë saj?.....	209
Figura: 27 I përzgjidhni vet inovacionet mësimore gjatë mësimdhënies?.....	210
Figura: 28 Në mungesë të inovacioneve mësimore, shfrytëzoni alternativa të tjera?...	211
Figura: 29 Keni pasur raste të vërtetoni arritjet e rezultateve më të mira me nxënës atëherë kur keni zbatuar strategji të reja në mësimdhënies? .....	212
Figura: 30 Në rast kur në klasë zbatoni inovacione mësimore, keni vërejtur ndryshime pozitive tek nxënësit tuaj?.....	213
Figura: 31 Inovacionet mësimore, nxisin interesimin tuaj për aktivitete pune në klasë? .....	214
Figura: 32 A mendoni se inovacionet mësimore kanë efekte pozitive në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies në krahasim me mësimdhënien tradicionale? .....	215
Figura: 33 Mendoni se inovacionet mësimore ndikojnë që njohuritë e nxënësve të jenë më të qëndrueshme?.....	216
Figura: 34 Mendoni se inovacionet mësimore ndikojnë që rezultatet në shkollë të jenë më të mira?.....	217
Figura: 35 Inovacionet mësimore, bëjnë që shanset të jenë më të mëdha në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies?.....	218
Figura: 36 Jeni të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies, falë strategjive të reja mësimore? .....	219
Figura: 37 Grafiku 1- Hipoteza 1 .....	243
Figura: 38 Grafiku 2 - Hipoteza 1 .....	243
Figura: 39 Grafiku 3 - Hipoteza 1 .....	244
Figura: 40 Grafiku 4 - Hipoteza 1 .....	244
Figura: 41 Grafiku 1 - Hipoteza 2.....	247

Figura: 42 Grafiku1 - Hipoteza 3 .....	250
Figura: 43 Grafiku 2 - Hipoteza 3 .....	251
Figura: 44 Grafiku 3 - Hipoteza 3 .....	251
Figura: 45 . Grafiku 4 - Hipoteta 3.....	252



## LISTA E TABELAVE

Tabela: 1 Pasqyra tabelore e shkollave pjesëmarrëse në hulumtim.....	176
Tabela: 2 Analiza e besueshmërisë – Mësimdhënësit	Tabela: 3 Analiza e besueshmërisë - Nxënësit.....
	183
Tabela: 4 Analiza e besueshmërisë - Mësimdhënësit 2	Tabela: 5 Analiza e besueshmërisë - Nxënësit 2.....
	183
Tabela: 6 Shkolla dhe komuniteti kanë prioritet ndryshimet që sjellin rezultate më të mira në shkollë? .....	184
Tabela: 7 Mjedisi shkollor nxit dhe zhvillon aftësitë tuaja individuale për të ditur më shumë?.....	186
Tabela: 8 Mësimdhënësit diskutojnë me ju lidhur me përzgjedhjen e strategjive të reja mësimore? .....	187
Tabela: 9 Mësimdhënësit ju angazhojnë të njiheni me teknika dhe teknologji të reja mësimore? .....	188
Tabela: 10 Përzgjedhjet apo aktivitetet mësimore nga mësimdhënësit, janë të përshtatshme për ju?.....	189
Tabela: 11 Në shkollën tuaj jeni të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies? .....	190
Tabela: 12 Mësimdhënësit zbatojnë mjete, metoda, teknika dhe teknologji inovative mësimore? .....	191
Tabela: 13 Mësimdhënësit përshtatin inovacionet mësimore me përmbajtjet mësimore? .....	192
Tabela: 14 Në momentet e paraqitjes së inovacioneve mësimore, ndiheni të motivuar për nxënie? .....	193
Tabela: 15 Mësimdhënësit shpesh zbatojnë inovacione mësimore në klasë?.....	194
Tabela: 16 Aktivitetet inovative në klasë janë nxitës të mirë për të nxënë? .....	195
Tabela: 17 Gjërat e reja ju tërheqin më shumë për të mësuar? .....	196
Tabela: 18 Jeni kureshtarë për të mësuar diç të re nga mësimdhënësit?.....	197
Tabela: 19 Është tërheqëse ora mësimore atëherë kur mësimdhënësit zbatojnë inovacione mësimore?.....	198
Tabela: 20 Inovacionet mësimore, ndikojnë që rezultatet në shkollë-klasë të jenë më të mira?.....	199

Tabela: 21 Inovacionet mësimore ndikojnë mjaftueshëm në ngritjen e rezultateve mësimore? .....	200
Tabela: 22 Jeni të kënaqur me rezultatet që dalin nga mësimdhënia inovative? .....	201
Tabela: 23 Në shkollën tuaj, ka kushte të mjaftueshme për zbatimin e strategjive të reja mësimore? .....	202
Tabela: 24 Shkolla ju nxit në zbatimin e mësimdhënies bashkëkohore?.....	203
Tabela: 25 Bashkëpunoni me kolegët tuaj lidhur me gjetjen e mundësive më të mira për mësimdhënie?.....	204
Tabela: 26 Shkolla juaj është në rrjedha të ndryshimeve inovative? .....	205
Tabela: 27 Shkolla juaj është e pasur me teknologji të re mësimore? .....	206
Tabela: 28 Shkolla juaj ka nevojë për ndryshime në teknikë dhe teknologji të re mësimore? .....	207
Tabela: 29 Zbatoni metoda dhe teknika të reja mësimore në mësimdhënies?.....	208
Tabela: 30 Jeni në ndjekje të ndryshimeve inovative që ndodhin në shkollë dhe jashtë saj?.....	209
Tabela: 31 I përzgjidhni vetë inovacionet mësimore gjatë mësimdhënies?.....	210
Tabela: 32 Në mungesë të inovacioneve mësimore, shfrytëzoni alternativa të tjera? ..	211
Tabela: 33 Keni pasur raste të vërtetoni arritjet e rezultateve më të mira me nxënës atëherë kur keni zbatuar strategji të reja në mësimdhënie?.....	212
Tabela: 34 Në rastet kur në klasë zbatoni inovacione mësimore, keni vërejtur ndryshime pozitive tek nxënësit tuaj? .....	213
Tabela: 35 Inovacionet mësimore, nxisin interesimin tuaj për aktivitete pune në klasë? .....	214
Tabela: 36 Mendoni se inovacionet mësimore kanë efekte pozitive në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies në krahasim me mësimdhënien tradicionale .....	215
Tabela: 37 Mendoni se inovacionet mësimore ndikojnë që njohuritë e nxënësve të jenë më të qëndrueshme?.....	216
Tabela: 38 Mendoni se inovacionet mësimore ndikojnë që rezultatet në shkollë të jenë më të mira?.....	217
Tabela: 39 Inovacionet mësimore, bëjnë që shanset të jenë më të mëdha në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies? .....	218

Tabela: 40 Jeni të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies, falë strategjive të reja mësimore? .....	219
Tabela: 41 A mund të tregoni sa vjet përvojë pune të drejtorit keni? .....	220
Tabela: 42 Shkolla juaj ka kushte të mira për mësimdhënie bashkëkohore?.....	221
Tabela: 43 I monitoroni ndonjëherë mësimdhënësit tuaj gjatë procesit të mësimdhënies?.....	222
Tabela: 44 Nëse i keni monitoruar, a keni vërejtur se mësimdhënësit tuaj kanë zbatuar strategji të reja mësimore (teknika, teknologji, metoda, forma, modele...)?.....	223
Tabela: 45 A zbatohen mjaftueshëm inovacionet mësimore nga mësimdhënësit e shkollës suaj? .....	224
Tabela: 46 Mësimdhënësit e cilës moshë i zbatojnë më tepër inovacionet mësimore gjatë procesit të mësimdhënies?.....	225
Tabela: 47 I këshilloni mësimdhënësit tuaj lidhur me reformat shkollore?.....	226
Tabela: 48 A komunikoni ndonjëherë me mësimdhënësit lidhur me gjetjen e formave, metodave dhe teknikave të reja mësimore? .....	227
Tabela: 49 Nëse po, si janë përgjigjur ata? .....	228
Tabela: 50 A jeni të kënaqur me punën e mësimdhënësve tuaj? .....	229
Tabela: 51 A stimulohen ata ndonjëherë nga ju ose nga institucionet përkatëse të arsimit?.....	230
Tabela: 52 A keni bërë ndonjë matje apo vlerësim rreth zbatimit të inovacioneve mësimore nga mësimdhënësit tuaj? .....	231
Tabela: 53 Nëse po, si kanë rrjedhur rezultatet e punës gjatë mësimdhënies? .....	232
Tabela: 54 Mjetet mësimore që posedon shkolla juaj, si: laptop, videoprojektor, skaner, shtypës, kopjues, harta me xhepa, kartat me shkronja dhe fjalë, fotografi, harta gjeografike, kamera... Sa i përdorin mësimdhënësit gjatë procesit të mësimdhënies? .	233
Tabela: 55 I këshilloni mësimdhënësit tuaj se mjetet mësimore janë të dedikuara për nxënësit me qëllim të arritjeve të rezultateve më të mira në shkollë? .....	234
Tabela: 56 A ndikojnë këshillat tuaja pozitivisht që mësimdhënësit t'i zbatojnë inovacionet gjatë procesit të mësimdhënies? .....	235
Tabela: 57 A e kuptojnë mësimdhënësit se zbatimi i mjeteve inovative në mësimdhënie ndikon që rezultatet e nxënësve në shkollë të jenë më të mira?.....	236

Tabela: 58 A mendoni se mësimdhënësit inovatorë sjellin rezultate më të mira në shkollë? .....	237
Tabela: 59 A u lejohet mësimdhënësve të marrin iniciativa në bërjen e ndryshimeve pozitive në shkollë?.....	238
Tabela: 60 A jeni të kënaqur me rezultatet e arritura në shkollën tuaj?.....	239
Tabela: 61 A ka nevojë shkolla juaj për investime shtesë që mësimdhënësit tuaj të jenë zbatues më të mirë të praktikave të reja në mësimdhënie? .....	240
Tabela: 62 Analizat deskriptive - Hipoteza 1.....	241
Tabela: 63 Analizat e korrelacionit - Hipoteza 1 .....	242
Tabela: 64 Analizat deskriptive - Hipoteza 2.....	245
Tabela: 65 Analiza e korrelacionit - Hipoteza 2 .....	246
Tabela: 66 Analizat deskriptive - Hipoteza 3.....	248
Tabela: 67 Analiza e korrelacionit - Hipoteza 3 .....	249

## **LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORIT**

ISA	Rinovimi i Sistemit Arsimor
SHFMU	Shkolla Fillore e Mesme e Ulët
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
ECDL	European Computer Driving Licence
TM	Teknologji Mësimore
RKS	Republika e Kosovës
ERR	Evokim – Realizim – Reflektim
IKAP	Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar
SHLP	Shkolla e Lartë Pedagogjike
MPP	Mbrojtja e Përgjithshme Popullore
BAT	Bazat e Arsimit Politeknik
SPDA	Sistemi i Pavarur Demokratik i Arsimit
SAK	Sistemi i Arsimit të Kosovës
IAK	Institucionet e Arsimit Kosovar
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
GJV	Gjysmëvjetori
TIK	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit
IT	Institucionet e Arsimit
CU	Cikli i Ulët
MSA	Measure of Sampling Adequacy (Masat e mjaftueshme të të dhënave)
KMO	Kaise-Meyer-Olkin

## KAPITULLI I: HYRJE

### 1.1. Shtrimi i problematikës së punimit

Sfida më e madhe e njeriut për të ardhmen, është dhe do të jetë: Gjetja e metodave, formave, teknikave dhe teknologjive të reja mësimore, për t'ia bërë nxënësit shkollën sa më pak të lodhshme. Andaj, *“Revolucioni tekniko-shkencor shkaktoi një krizë të theksuar në organizimin e veprimtarisë edukativo-arsimore dhe në përmbajtjen e metodat e saj dhe në këtë mënyrë nxori në pah shumë probleme në marrëdhënie midis mësimdhënësit dhe nxënësit, shkollës dhe shoqërisë, arsimit dhe prodhimit shoqërorë. Prandaj, sot asnjë vend në botë nuk është plotësisht i kënaqur me cilësinë e punës së shkollave dhe të universitetit. Ky është njëri nga shkaqet kryesore që ka ndikuar që shkollat dhe universitetet të bëhen arenë lufte midis së resë dhe së vjetrës në punën mësimore”* (Mandič, 1985: 15).

Inovacionet në mësim dhe kuptimi i tyre nga aspekti tematik, janë risi, përmes së cilës ky hulumtim do të ndikojë në bindjen, nxitjen dhe stimulimin e mësimdhënësve për ta respektuar të kaluarën, me synim për të ndikuar në pasurimin e mësimdhënies me teknika, metoda, forma dhe mjete të reja të punës, në dizajnimin dhe rezultatet e veprimtarisë mësimore, në zgjerimin e burimeve të njohurive dhe në imponimin e formave më të përshtatshme të mësimdhënies.

Këtij hulumtimi i jemi qasur nga arsyeja se inovacionet mësimore mund të ndikojnë mjaft mirë në ngritjen e cilësisë në mësimdhënie, duke zënë vend shumë të rëndësishëm në pasurimin e nxënësve me njohuri të reja dhe duke i ndihmuar ata të

motivohen, të zgjerojnë njohuritë, të ndryshojnë qëndrimet dhe të rrisin aftësitë e vlerat e tyre me qëllim të arritjeve të rezultateve sa më të mira.

Problematikë e këtij punimi është analiza e gjendjes ekzistuese dhe njohja e strategjive të reja të mësimdhënies në sektorin e arsimit fillor të rajonit të Anamoravës së Kosovës dhe ndikimi i tyre në mësimdhënie. Këtë e kemi bërë me qëllim për të nxjerrë të vërtetën rreth ndikimit të inovacioneve mësimore në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Problematika e studimit paraqet një fushë të gjerë veprimtarie të mësuesve, nxënësve dhe organeve arsimore, të cilat bashkërisht mund të ndikojnë fuqishëm në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies, me qëllim të bërjes së ndryshimeve pozitive, duke formuar nxënës të suksesshëm, krijues e vizionarë të së nesërme.

Qëllimi është që të ecim përpara, në favor të diskutimit të gjithanshëm rreth reformës së arsimit në vendin tonë, për t'i nxitur faktorët përgjegjës që të mendojnë për të marrë masa konkrete në reformën e konceptit të organizimit të mësimdhënies. Nxënësit vazhdimisht do të njihen me ndryshimet më të reja që ndodhin në arsim, si në rajon ashtu edhe në botë, sepse nga kjo mund të ketë dobi shoqëria, ngase ajo çdoherë është në pritje të ndryshimeve për një ekonomi dhe treg të zhvilluar. Inovacionet mësimore mund të kontribuojnë shumë edhe në praktikat edukativo-arsimore, ngaqë ato vazhdimisht sjellin gjallëri pune në shkollë, duke u mbështetur në të kaluarën, e duke i dhënë përparësi së ardhmes.

Në këtë kuadër, tema jonë e hulumtimit analizon dhe trajton zbatimin e inovacioneve mësimore në mësimdhënie dhe ndikimin e tyre në ngritjen e cilësisë së mësimimit tek nxënësit e shkollave fillore.

“Mësuesi dhe reforma janë faktorë të përhershëm për zhvillimin e gjithanshëm të shkollës në të gjitha nivelet” (Kraja, 2012: 389).

Proceset e globalizimit politik, ekonomik, kulturor dhe ekologjik, implikojnë iniciativa, të cilat kanë për qëllim afrimin e popujve në botë dhe zgjidhjen e problemeve me të cilat ata ballafaqohen. Andaj, “Shkolla është themeluar si institucion shoqëror me qëllim që t’i ndihmojë gjeneratës së re që më shpejt, më mirë dhe në mënyrë sa më të gjithanshme të zhvillohet në pikëpamje psikofizike e të përgatitet për jetë” (Bektashi, 2009: 1). Shoqëria e së ardhmes asnjëherë nuk bën të ndalet e të kënaqet me të tanishmen, por vazhdimisht duhet të jetë në kërkim të më të mirës, me qëllim që nxënësve t’ua bëjë shkollën një kopsht gëzimi, ku mbillet dashuria për dijen e së ardhmes.

E ardhmja e njerëzimit, gjithnjë e më shumë varet nga zhvillimi i arsimit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë, nga të cilat shoqëritë bashkëkohore vazhdimisht bëjnë ndryshime pozitive për një të ardhme më të lumtur dhe më të ndritshme. Në kohën tonë kemi mjaft risi në arsim, si: në teknikë, teknologji, plane dhe programe mësimore, në objekte shkollore etj., për të cilat dyshohet se përdoren pak dhe zbatohen në mënyrë jo të organizuar sa duhet, duke mos e kuptuar mjaftueshëm ndikimin e tyre në cilësinë e mësimin.

Këta ortekë ndryshimesh, që vazhdimisht kaplojnë arsimin, na imponojnë nevojën e pakontestueshme që të ndërrojmë edhe mënyrën e organizimit të strukturës së brendshme në institucion, duke ndikuar edhe në strukturën e jashtme, në mënyrë që të ndikohet në ndryshimin edhe të vetë sjelljeve të individëve, pjesëmarrës në veprimtarinë e arsimit. Pra, “Çdo ndryshim para planifikimit të tij dhe vënies në praktikë, nënkupton studimin thelbësor të gjendjes ekzistuese dhe shkaqet që e kushtëzojnë atë. Ky është



parakusht për ndryshimin e suksesshëm të gjendjes së papëlqyeshme, në lëvizjen më të sigurt drejt asaj që dëshirojmë” (Osmani, 2010: 18).

Zbatimi i inovacioneve në mësimdhënie, është një hap i rëndësishëm në reformimin thelbësor të organizimit, të përmbajtjes, formave, parimeve dhe metodave të punës edukativo-arsimore në institucionet shkollore, i cili që në fillim vërehet qartë se është mjaft efikas në zgjidhjen e disa çështjeve të tjera vitale të mësimdhënies.

Kur prej fëmijëve të një moshe të re kërkohet të mësojnë e të përvetësojnë përmbajtje mësimore të stërngarkuar me përmbajtje të gjata teorike, për të cilat kërkohet më shumë kohë sesa lejojnë mosha dhe aftësia e tyre, atëherë në këto raste shkolla, në vend se të mbjell dashuri për të, ajo për nxënësit bëhet një vend ku mbillet frika dhe urrejtja. Për ta larguar këtë brengë nga fëmijët, mësimdhënësit janë njerëzit më të qëlluar që mund të bëjnë ndryshime radikale, duke bërë që nxënësit në klasë të ndihen rehat dhe shkollën ta duan sikur shtëpinë e tyre.

Megjithatë, inovacionet që u paraqitën viteve të fundit, kanë qenë të orientuara që të kapërcehet rigoroziteti i sistemit të vjetër të arsimit, të modernizohen mjetet mësimore, të përparohen format dhe metodat e punës si dhe t`u përshtaten interesave të nxënësve (Mandiq, 1985: 9).

Në të vërtetë, problemi i inovacioneve në mësimdhënie, qysh herët është vërejtur si dukuri pozitive, nga nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe specialistët e tjerë, por asnjëherë nuk është vërtetuar shkencërisht nëse me të vërtetë inovacionet në mësimdhënie ndikojnë që rezultatet në shkollë të jenë më të mira. Për ta vërtetuar një gjë të tillë, kemi bërë hulumtim shkencor dhe nga të dhënat e të anketuarve, kemi arritur në përfundim se një gjë e tillë është vërtetuar edhe shkencërisht. Është një kërkesë e patjetërsueshme e shkollës bashkëkohore për qasje të reja pune ndaj mësimdhënies, me

të vetmin qëllim për t'iu përshtatur interesave të nxënësve, që rezultatet të jenë më të avancuara, duke ditur se inovacionet mësimore ndikojnë në motivimin e nxënësve për aktivitete pune në klasë dhe jashtë saj, ngase ato kanë natyrë argëtuese, zhvillojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat me qëllim për ta avancuar dhe përshtatur mësimdhënien.

Lidhur me këtë problematikë, pothuajse mjaft pak është shkruar nga autorët vendorë, përpos që për inovacionet në mësim është publikuar libri i përkthyer në shqip nga gjuha serbokroate më 1985 në Prishtinë nga autori Petar Mandić. Ndërkaq, për sa i përket ndonjë botimi tjetër të plotë kombëtar apo ndërkombëtar lidhur me ndikimin e inovacioneve në mësimdhënie, ende nuk kemi hasur. Në rastin e hulumtimit tonë, literatura vendore nuk ka qenë e mjaftueshme sa duhet për shtjellimin e një kërkimi të tillë, përderisa jemi bazuar apo mbështetur në literaturën ndërkombëtare, sidomos në literaturën e atyre vendeve që kanë ecur më shpejt në reformimin e procesit të arsimit.

Në këtë punim kemi dhënë informacione të rëndësishme lidhur me zbatimin dhe ndikimin e inovacioneve në mësimdhënie, duke u nisur nga përcaktimi i termit inovacion deri tek strategjitë e reja të mësimdhënies, si dhe tendencat rreth pasurimit të objekteve shkollore me infrastrukturë bashkëkohore. Në punim janë trajtuar edhe format inovative të organizimit të punës mësimore, duke theksuar rolin e mësimdhënësit inovator në organizimin e punës mësimore dhe gatishmërinë e nxënësve për të nxënë.

Nëpërmjet këtij hulumtimi kemi marrë të dhëna nga të anketuarit e tri komunave më të mëdha (Gjilan, Kamenicë, Viti) të regjionit të Anamoravës së Kosovës, dhe përmes metodës sasiore e cilësore kemi paraqitur rezultatet e këtyre anketimeve. Përpos tri komunave më të mëdha të regjionit të Anamoravës së Kosovës, të banuara me shumicë shqiptare, që llogaritet të jetë mbi 90% e popullatës, shtrihen edhe tri komuna

të tjera të sapoformuara serbe, siç janë Ranillugu, Parteshi dhe Klllokoti, të cilat, fatkeqësisht, nuk patën mundësi të jenë pjesë e hulumtimit tonë, edhe pse jemi përpjekur shumë herë t'i bindim se ky hulumtim është personal yni dhe thjesht shkencor e nuk ka asgjë të bëjë me çështje politike.

Sfida më e madhe e njeriut për të ardhmen është dhe do të jetë: Gjetja e mjeteve, metodave, formave, teknikave dhe teknologjive të përshtatshme mësimore, për t'ia bërë nxënësit shkollën sa më pak të lodhshme. Andaj, *“Revolucioni tekniko-shkencor shkaktoi një krizë të theksuar në organizimin e veprimtarisë edukativo-arsimore dhe në përmbajtjen e metodat e saj dhe në këtë mënyrë nxori në pah shumë probleme në marrëdhënie midis mësimdhënësit dhe nxënësit, shkollës dhe shoqërisë, arsimit dhe prodhimit shoqëror. Prandaj, sot asnjë vend në botë nuk është plotësisht i kënaqur me cilësinë e punës së shkollave dhe të universitetit. Ky është njëri nga shkaqet kryesore i cili ka ndikuar që shkollat dhe universitetet të bëhen arenë luftime midis së resë dhe së vjetrës në punën mësimore”* (Mandić, 1985: 15).

Këtij hulumtimi, i jemi qasur nga arsyeja se inovacionet mësimore mund të ndikojnë në ngritjen e cilësisë në mësimdhënie, duke zënë vend shumë të rëndësishëm në pasurimin e nxënësve me njohuri të reja dhe duke i ndihmuar ata të motivohen, të zgjerojnë njohuritë, të ndryshojnë qëndrimet, të rrisin aftësitë dhe vlerat e tyre.

Këtij hulumtimi i jemi qasur nga arsyeja se, sikurse nga brenda ashtu dhe nga jashtë institucioneve tona arsimore, jemi të rrethuar me lloje të shumta risish, por në disa raste institucionet tona arsimore, porse edhe disa nga mësimdhënësit, nuk merren sa duhet me implementimin e tyre.

Synimi i këtij punimi është analiza e gjendjes ekzistuese dhe e njohjes së strategjive të reja të mësimdhënies në sektorin e arsimit fillor të rajonit të Anamoravës së Kosovës dhe, ndikimi i tyre në mësimdhënie. Gjithë këtë e kemi bërë me qëllim që të nxisim mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave për të zbatuar inovacionet mësimore me qëllim që rezultatet në shkollë të jenë më të mira.

Problematika e studimit paraqet një fushë të gjerë të veprimtarisë së mësuesve, nxënësve dhe organeve arsimore, të cilët si një trup i përbashkët mund të ndikojnë fuqishëm në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies.

Qëllimi është të ecim përpara në favor të diskutimit të gjithanshëm rreth reformës së arsimit në vendin tonë, duke synuar që të nxisim faktorët përgjegjës për të menduar dhe për të marrë masa konkrete në reformën e konceptit të organizimit të mësimdhënies, ngase nxënësit vazhdimisht duhet të jenë në rrjedhë të ndryshimeve më të reja që ndodhin diku në arsim, si në rajon ashtu edhe botë. Andaj, pa asnjë hezitim mund të themi se nga kjo ka dobi shoqëria, ngaqë ajo çdoherë është në pritje të ndryshimeve për një ekonomi të zhvilluar.

Inovacionet mësimore mund të kontribuojnë shumë edhe në praktikat edukativo-arsimore, ngase ato sjellin gjallëri pune në shkollë.

## **1.2. Përcaktimi i termit inovacion**

Fjala inovacion rrjedh prej gjuhës latine novus, innovatio - e re, të bërit diçka të re. Meqenëse ky term në teorinë pedagogjike ende nuk është përkufizuar qartë, në aspektin global, nënkuptojmë të bërit diçka të re me qëllim të përmirësimit, përparimit, modernizimit apo zhvillimit të veprimtarisë pedagogjike dhe didaktike-metodike. Dragutin Frankovič, inovacionin e përkufizon si ndryshim apo një sërë ndryshimesh që ndodhin në qëllimet, përmbajtjet, në strukturën organizative, metodat apo format materiale dhe në gjithë atë që është futur në sistemin dhe praktikën arsimore, me qëllim që ajo të përmirësohet dhe të përparohet (Vilotijevič, 1998: 299).

Termi “inovacion” apo “risi” mund të nënkuptojë një objekt, një ide apo një praktikë të re, ose një proces me anë të të cilit bëhet përshtatja e një objekti, ideje apo praktike të re nga një grup apo institucion i caktuar (Marsh, 2009: 114). Një përkufizim tjetër i inovacionit, është zbatimi i planifikuar i synimeve apo mjeteve që janë të reja apo të ndryshme nga ato që përdoren tani, e që kanë për qëllim përmirësimin e procesit mësimor. Nëse inovacioni konsiderohet si përmirësim apo jo, kjo do të varet sigurisht nga gjykimi i institucionit apo individit që do ta zbatojë atë, sepse ata do të jenë në gjendje ta vlerësojnë risinë, duke bërë krahasime me përvojat e tyre të mëparshme dhe aspiratat për të ardhmen (Marsh, 2009: 115).

Përkufizimi tjetër është se inovacioni është një ide e re, proces ose pajisje më efektive. (<http://www.wikiwand.com/sq/Inovacioni>).

Ekzistojnë edhe përkufizime të shumta lidhur me nocionin *inovacion*. Disa autorë inovacionin e përkufizojnë si tërësi të qëllimeve, strategjive, taktikave dhe veprimtarive që bëjnë të mundur ndryshimet sociale brendapërbrenda institucionit ose shoqërisë. Meqenëse edhe shkolla paraqitet si organizatë sociale, duhet ndryshuar ritmi i arsimit për lehtësim dhe për arritje të qëllimeve të caktuara, duke u siguruar nxënësve mundësi që të pajisen me dituri sistematike dhe operative, si dhe me shkathtësitë elementare, të cilat do t'u mundësojnë t'i shfrytëzojnë dituritë e tyre në situata të ndryshme, me rastin e zgjidhjes së problemeve në mënyrë krijuese.

Inovacioni nuk lind aty, për aty për të dhënë planin për një zhvillim të ri. Inovacioni është një proces gradual, i cili ndërtohet në diçka të re dhe të vlefshme gjatë një periudhe kohore, nëpër faza të llojllojshme, por nuk do të thotë se ato janë të pandryshueshme, sepse ato ndryshohen dhe rinovohen vazhdimisht.

Me ISA (Rinovim të Sistemit Arsimor) duhet ndryshuar edhe organizimi i punës mësimore. Ndonëse në të kaluarën, dy breza shërbeheshin me dituri të njëjta të fituara, sot, nën ndikimin e arritjeve tekniko-shkencore, një brez gjatë aktivitetit punues duhet të arsimohet gati tri herë për t'u aftësuar për kryerjen me sukses të një veprimtarie të caktuar (Zylfiu, 2005: 94).

Shikuar në përgjithësi, inovacionet ndahen në tre përbërës, që përfshihen në zbatimin e çdo programi apo politike të re:

- a. Përdorimi i mundshëm i materialeve të reja, si materialet ose teknologjitë shkollore të kurrikulës;
- b. Përdorimi i mundshëm i qasjeve të reja të mësimdhënies;
- c. Ndryshimi i mundshëm i bindjeve të disa teorive të disa politikave ose programeve të reja (Fullan, 2010: 66).

Inovacionet mësimore janë një gjë shumë e rëndësishme dhe domosdoshmëri e kohës për të siguruar më lehtë dhe më shpejt informacionin e ri. Andaj, arsimi më së tepërmi ka nevojë për risi dhe ndryshime pozitive në fushën e mësimdhënies, sepse risitë e zbatuara mirë dhe drejt gjatë procesit mësimor, sjellin ndryshime pozitive në shoqëri.

Në këtë hulumtim, si koncepte të tjera themelore tek ndikimi i inovacioneve në procesin mësimor, kemi: nxënësin, mësimdhënësin, mësimdhënien, mësimnxënien, teknikën, teknologjinë mësimore, infrastrukturën shkollore etj.

Në këtë studim, me inovacion mësimor kuptohet ai lloj komunikimi i integruar, që një mësimdhënës përdor për të realizuar synimet e mësimdhënies dhe që përfshin në misionin e vet strategjitë e reja organizative të mësimdhënies.

### **1.3. Qëllimi i hulumtimit**

Qëllimi kryesor që na ka shtyrë të merremi me këtë hulumtim, është të vërtetuarit e hipotezës se: Mësimi inovativ ndikon në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Qëllimi shkencor i këtij studimi është:

- Të kontribuojë në diskutimin e gjithanshëm shkencor, që është duke u zhvilluar për reformën e arsimit në vendin tonë;
- Të nxisë faktorët përgjegjës për të menduar dhe për të marrë masa konkrete në reformimin e konceptit dhe të organizimit të shkollave bashkëkohore;
- Të rrisë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënien në klasë, me qëllim të arritjeve të rezultateve më të mira në shkollë;
- Të përcaktojë lidhjen dhe forcën e ndikimit mes inovacioneve mësimore dhe rezultateve që dalin nga to;
- Të identifikojë rëndësinë e ndikimit të inovacioneve mësimore në mësimdhënie për motivimin e nxënësve gjatë aktiviteteve të punës në klasë;
- Të vërtetojë ndikimin e inovacioneve mësimore në mësimdhënie, në sektorin e arsimit fillor të regjionit të Anamoravës së Kosovës.

#### **1.4. Nevoja dhe rëndësia e hulumtimit**

Nevoja e trajtimit të këtij hulumtimi është mjaft aktuale dhe mjaft debatuese, ngase tani jemi duke jetuar në mesin e ndryshimeve të mëdha. Andaj, shkolla nuk mund të qëndrojë duarkryq, kur e dinë të gjithë se ajo është dhe do të jetë baza e ndryshimeve sociale, kulturore dhe ekonomike të një vendi. Shkolla është ajo e cila ka obligime morale dhe ligjore në bërjen e ndryshimeve themelore për të përparuar dhe për të funksionuar vendi më mirë. Nevoja për ta çuar vendin përpara në ekonomi është aq e madhe, saqë nganjëherë radhitet menjëherë pas ajrit, ujit dhe bukës.

Trajtimi i kësaj teme në këtë studim, besojmë që do t'i ndihmojë mësimdhënësit në kapërcimin më të lehtë nga mësimdhënia tradicionale në atë bashkëkohore, si në ndryshimin e sjelljes së mësimdhënësit në klasë, zbatimin e metodave dhe formave të reja në mësim dhe të teknikave e teknologjive të reja. Po ashtu, besojmë që, nëpërmjet një transformimi të punës arsimore, së paku do të të arrihet të përparohen deri diku edhe rrjedhat e shoqërisë për një të ardhme më të mirë.

Për çdo risi në mësimdhënie, paraprakisht duhet të mendojmë se çfarë të mirash do të sjellë ajo në praktikë dhe çfarë ndikimi do të kenë ato në thellimin e njohurive të nxënësve. Nëse e gjithë kjo ka një notë pozitive, atëherë mendojmë se barra kryesore i mbetet mësimdhënësit, si bartësi dhe indikator parësor në zbatimin e inovacioneve mësimore në shkollë.

Lidhur me këtë, shkolla është e detyruar të bëjë ndryshime progresive për të mirën e shoqërisë, e cila vazhdimisht është në pritje të ndryshimeve për një jetë më të mirë.



Gjithë këtë e bëjmë për ta përsosur mësimdhënien, me qëllim të mosveprimit sikurse në shkollën e vjetër të shekullit XIX, në të cilën konsiderohej se detyra themelore dhe e vetme e mësimi ishte detyra materiale (Bektashi, 2009: 1). Përfaqësuesit e kësaj shkolle mendonin se nxënësve duhet t'u ofrohen sa më shumë njohuri, sepse në atë mënyrë ata do të bëheshin më të ditur dhe do të përgatiteshin më mirë për jetë, edhe pse në disa raste moshë dhe aftësitë përgatitore të nxënësve nuk ishin në gjendje t'i pranonin ato ngarkesa të rënda. Lidhur me këtë, ata kanë qenë të ngarkuar vetëm me pjesën teorike, duke bërë që më tepër të mësohet mekanikisht, kurse tani, mësimdhënia inovative, më tepër i jep përparësi mësimi logjik dhe praktik, nga i cili nxënësit janë përfitues të drejtpërdrejtë, si në thithjen e njohurive të reja, ashtu edhe në zbatimin e lirë të atyre njohurive në veprimtaritë praktike.

Inovacionet mësimore ndikojnë edhe në shtimin e besueshmërisë së nxënësve ndaj shkollës. Kjo do të thotë se zbatimi i punës krijuese në shkollat e zonës, do të thellojë dituritë e nxënësve për të njohur më gjerë pozicionin e tyre gjeografik, zhvillimin historik, social, për t'u ballafaquar me veprimtaritë praktike etj.

### **1.5. Detyrat e hulumtimit**

Për ta hulumtuar dhe për ta studiuar këtë dukuri si problem pedagogjik, kemi kryer disa obligime dhe detyra hulumtuese. Si detyrë parësore për studimin e çështjeve të tilla, së pari kemi hulumtuar dhe kemi kompletuar literaturën përkatëse, e cila trajton këtë dukuri dhe pikërisht pastaj i kemi hyrë një analize për një trajtim më të gjithanshëm e më të thelluar të kësaj dukurie. Si, p.sh.:

- Kemi analizuar dhe kemi studiuar historikun dhe teorinë e këtij problemi;

- Lidhur me anketimin e respondentëve, paraprakisht kemi njoftuar DKA-të (Drejtoritë Komunale të Arsimit) dhe drejtorët e shkollave fillore;

- Kemi grumbulluar të dhënat nga të anketuarit;

- Kemi përpunuar të dhënat e grumbulluara;

- Të dhënat e grumbulluara i kemi analizuar dhe i kemi paraqitur përmes dokumenteve, grafikëve dhe tabelave, në mënyrë që punimi të dalë sa më i qartë, sa më i arsyeshëm dhe sa më real dhe më pas kemi bërë edhe interpretimin e rezultateve të hulumtimit.

Detyrë shumë e rëndësishme e këtij hulumtimi, është edhe argumentimi i ndryshimeve të qasjeve të reja ndaj mësimdhënies, duke bërë analizën e gjendjes ekzistuese të mësimdhënies në sektorin e arsimit fillor të Regjionit të Anamoravës së Kosovës.

Si detyrë jona morale dhe shkencore, është që nga ky punim, në radhë të parë, të ketë interes nxënësi;

Të ketë interes shkenca, sepse rrit interesimin për një studim më të thelluar;

Të kenë interes praktikant shkollorë, me qëllim për t'u ballafaquar më lehtë me ndryshimet e procesit të mësimdhënies;

Si dhe të ketë dobi e tërë shoqëria, ngase ajo çdoherë është në pritje të një jete më të avancuar, e cila doemos që arrihet nëpërmjet zbatimit të inovacioneve edhe në fushë të arsimit.

## **1.6. Pyetjet kërkimore**

Si ndikojnë inovacionet në ngritjen e rendimentit dhe të cilësisë në punën mësimore edukative?

- Cili është ndikimi i mësimit inovator në përmirësimin e metodave mësimore të mësimdhënies?

- Sa ndikon infrastruktura shkollore në zhvillimin e mësimit inovator dhe stimulimin e nxënësve për punë kreative në klasë?

- A munden inovacionet mësimore të rritin shanset e ngritjes së cilësisë në mësimdhënie?

## **1.7. Hipotezat e hulumtimit**

Nga përcaktimi i objektit të hulumtimit, del hipoteza kryesore e punës, e cila tregon se: Mësimi inovativ ndikon në ngritjen e rendimentit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Nga hipoteza kryesore, kemi nxjerrë edhe disa hipoteza ndihmëse:

**H1.** Inovacionet mësimore ndikojnë pozitivisht në veprimtaritë social-pedagogjike.

**H2.** Infrastruktura shkollore ndikon fuqishëm në zbatimin e inovacioneve mësimore gjatë procesit të mësimdhënies.

**H3.** Inovacionet mësimore janë indikatorë të mirë në stimulimin e nxënësve për punë kreative në klasë.

## **1.8. Struktura e tezës së disertacionit**

Parashtrimi i problematikës së këtij punimi është strukturuar në gjashtë kapituj, duke përshkruar ecurinë e përgjithshme teorike të fushës së studimit dhe metodologjinë e përdorur në studim.

*Në kapitullin e parë*, është paraqitur problematika e punimit lidhur me gjendjen ekzistuese të strategjive të reja të mësimdhënies në sektorin e arsimit fillor të Regjionit të Anamoravës së Kosovës. Kemi bërë sqarimin e nocioneve bazë të inovacioneve mësimore, kemi paraqitur qëllimin dhe objektivat e hulumtimit, pyetjet kërkimore, hipotezat dhe detyrat që dalin nga ky studim.

*Në kapitullin e dytë*, kemi bërë një vështrim teorik të inovacioneve mësimore në arsim, duke qenë më pranë problematikës së zgjedhur lidhur me qasjen teorike të punimit përkitazi me temën e projektit tonë kërkimor. Ky kapitull përfshin:

- faktorët objektivë dhe subjektivë që kushtëzojnë mësimdhënien;
- teoritë lidhur me rolin e inovacioneve mësimore në aspektin pedagogjik dhe psikologjik;
- rolin dhe ndikimin e inovacioneve mësimore në mësimdhënie;
- ndikimin e infrastrukturës shkollore për një mësimdhënie të avancuar.

Po kështu, kemi përshkruar kontekstin e problematikës së punimit lidhur me evoluimin e risive në një rrafsh historik për Regjionin e Anamoravës së Kosovës e më gjerë, duke kaluar nëpër disa etapa kohore, që nga viti 1915 deri në momentin kur fillon analiza.

*Në kapitullin e tretë*, kemi përshkruar rolet e mësimdhënësit inovator, disa modele të suksesshme të mësimdhënies, si dhe ndikimin e tyre në arritjen e rezultateve

në shkollë. Kemi vijuar pastaj me qasjen mësimdhënies bashkëkohore krahas asaj tradicionale. Gjithashtu, i kemi bërë edhe një vështrim kritik literaturës në lidhje me çështjen e hulumtimit, duke trajtuar apo duke hetuar mangësitë e literaturës së tanishme.

***Kapitulli i katërt***, përbën një nga kapitujt më të rëndësishëm të studimit, duke u ndarë në këto nënpika:

Dizajnimi;

Metodat e hulumtimit;

Instrumentet e hulumtimit;

Kampioni i studimit;

Variablat;

Besueshmëria e studimit;

Etika dhe

Kufizimet e studimit.

***Në kapitullin e pestë***, kemi paraqitur të dhënat e përgjithshme lidhur me zbatimin dhe ndikimin e inovacioneve në mësimdhënie në shkollat fillore të Regjionit të Anamoravës së Kosovës, me tri subjektet e anketuara (mësimdhënës, nxënës dhe drejtorë). Të dhënat e grumbulluara i kemi përpunuar sipas sistemeve SPSS (Paketave statistikore për shkenca shoqërore). Dhe, në fund të këtij kapitulli, kemi paraqitur rezultatet përfundimtare të të anketuarve. duke bërë edhe verifikimin e hipotezave.

***Në kapitullin e gjashtë***, në mënyrë të përmbledhur kemi prezantuar përfundimet dhe rekomandimet, të mbështetura nga rezultatet e dala nga hulumtimi dhe në fund kemi radhitur literaturën e përdorur për realizimin e këtij studimi.

## KAPITULLI II: VËSHTRIMI TEORIK I INOVACIONEVE NË ARSIM

### **2.1. Disa faktorë objektivë dhe subjektivë që kushtëzojnë mësimdhënien inovative**

Si faktor, nga i cili mund të kushtëzohet mësimdhënia inovative, në disa raste është vetë mësimdhënësi, ngase, përpos diplomës që posedon, ai shumë pak merret me ndjekjen e zhvillimeve të avancuara. Pos kësaj, disa prej mësimdhënësve, sidomos ata të moshës së shtyrë, për fat të keq, shumë pak e njohin teknologjinë e re mësimore dhe pothuajse tepër rrallë bëjnë zbatimin e saj në klasë. Ata mësimdhënës, me vështirësi i përshtaten shoqërisë së ndryshimeve të vullshme. Ndërkaq, shkolla vazhdimisht synon që këto mjete mësimore të gjejnë zbatim, mirëpo disa nga mësimdhënësit nuk janë të aftë t'i zhvillojnë këto cilësi individuale, përderisa disa prej mësimdhënësve, që kanë njohuri të mjaftueshme lidhur me zbatimin e teknologjisë së re mësimore, fatkeqësisht nuk janë të stimuluar për zbatimin e tyre.

Dominimi dhe numri i tepruar i teksteve shkollore, e obligon mësimdhënësin që më tepër të jetë i përqendruar tek tekstet shkollore për ta kryer detyrën e tij sipas planit dhe programit mësimor, duke i bërë nxënësit të mendojnë se tekstet shkollore janë burimi i vetëm i diturive. Me këto veprime, nxënësit po i ndajmë nga praktika dhe disi po i kushtëzojmë që të mos dalin nga kornizat teorike tekstuale.

Në shumicën e shkollave fillore, ende dominojnë metodat e monologut, dialogut dhe ajo tekstuale, përderisa pothuajse tërësisht lihen anash metodat e demonstrimit,

ilustrimeve, punimeve grafike etj. Pastaj, përderisa forma frontale e mësimdhënies konsiderohet si më e efikasja, fatkeqësisht, shpesh lihen anash puna në grupe, në çifte dhe individuale.

Edhe pse jemi në kohën e zhvillimit të hovshëm të teknikës dhe teknologjisë së re mësimore, në shumicën dërrmuese të shkollave ende dominojnë tabela (dërrasa e zezë), shkumësi, lapsi dhe libri, përderisa tepër pak gjejnë zbatim rrjetet online, tabelat elektronike, ipad-ët etj.

Mësimdhënësit mund të pranojnë ndryshime në rolin e tyre dhe në ndërveprime me nxënësit e tyre (Harris, 2002: 457). Kjo përshtatje tek mësuesit lind për të transferuar përgjegjësinë më të madhe për vete dhe për nxënësit (Smeets & Mooij, 2001: 404).

Sikurse në shkollë, ashtu edhe në shtëpi, shpesh dëgjojmë zëra pakënaqësie nga mësimdhënësit dhe prindërit, duke u ankuar se nxënësit-fëmijët e tyre, nuk janë duke mësuar sa duhet, duke mos u bërë asnjëherë vetëkritikë për të menduar se rrjedha e të mirave dhe e të këqijave të fëmijëve të tyre vijnë nga edukatorët dhe rrethi ku jetojnë e mësojnë ata fëmijë.

*Duke iu referuar Marsh (2009), “Ata mësues që kanë pasur një nivel të lartë angazhimi në një ndryshim të caktuar, kohët e fundit, kanë më shumë gjasa të kenë një qasje dhe qëndrim pozitiv ndaj risive të ardhshme. Ata që më parë u kanë bërë rezistencë ndryshimeve, kanë gjasa të kenë reagim negativ edhe në të ardhmen” (f. 118).*

Meqenëse **shkolla** paraqitet si organizatë sociale, ajo mund të pësojë ndryshime me ritmin e arsimit për lehtësim dhe për arritjen e qëllimeve të caktuara, duke u siguruar nxënësve mundësi që të pajisen me dituri sistematike dhe operative, si dhe me

shkathësi elementare, të cilat do t'u mundësojnë t'i shfrytëzojnë ato dituri të tyre në situata të ndryshme, me rastin e zgjidhjes së problemeve në mënyrë krijuese.

Në këtë hulumtim, si koncepte të tjera themelore tek ndikimi i inovacioneve në procesin e mësimdhënies, kemi:

nxënësin,  
mësimdhënësin,  
mësimdhënien,  
mësimnxënien,  
technikën,  
teknologjinë mësimore,  
infrastrukturën shkollore etj.

- Në këtë rast, **nxënësi**, si subjekt në mësim dhe si bartës kryesor i realizimit të procesit edukativo-arsimor, është një krijesë e butë, e re dhe krejtësisht e pafajshme. I gjithë personeli i shkollës dhe i gjithë organizimi që bëhet brenda dhe jashtë saj, "Për nxënësin organizohet mësimi dhe kjo në funksion të pajisjes së vetëdijes së tij me njohuri të reja që të formojë botëkuptime shkencore mbi botën" (Brada, 2010: 148).

- Si koncept tjetër është **mësimdhënësi**, që do të thotë se ai është planifikuesi, organizatori dhe realizuesi i punës mësimore me nxënës, duke mundësuar krijimin e kushteve për kryerjen e suksesshme të detyrave shkollore.

Me nocionin "mësimdhënës" apo "mësues", nënkuptojmë njeriun që di dhe që mëson atë që nuk di (Zajazi, 2003: 80).

Mësimdhënësit janë ata të cilët kanë për detyrë të ndihmojnë të tjerët, që të mësojnë dhe të përvetësojnë shprehje të mënyra të reja dhe që të sillen në një mënyrë krejtësisht të re, ata të cilët në procesin e mësimdhënies do të jenë ndryshe nga më parë.



Mësimdhënësi i mirë, dallohet me kulturën e tij profesionale dhe pedagogjike, njih aftësitë psikofizike të nxënësve, ndryshimet dhe dallimet moshore, gjinore, nevojat, prirjet, dëshirat etj., duke zgjedhur dhe përdorur drejt teknikën dhe teknologjinë mësimore (Brada, 2010: 157).

- **Mësimdhënia** është dhënie e mësimi në shkollë, apo puna e organizuar dhe e rregullt, që bën mësuesi në shkollë, sipas një programi të caktuar për formimin e gjithanshëm të nxënësve, për t'i pajisur ata me arsim dhe edukatë, duke përdorur metoda të përshtatshme për moshën e tyre. “Mësimdhënia, sipas përkufizimit pedagogjik, është proces unik i arsimit dhe edukimit intencional dhe institucional të nxënësve nën udhëheqjen e arsimtarit” (Brada, 2010: 44).

Mësimdhënie do të thotë edhe atëherë kur synohet zhvillimi i njohurive, i shprehive dhe i qëndrimeve pozitive e të argumentuara të nxënësve. Dhe, “si rrjedhojë, mësimdhënia prodhon efekte dhe vlera që e përbëjnë zhvillimin e nxënësit” (Zajazi, 2003: 101). Në këtë rast, mësimdhënia inovative ndihmon nxënësit të ndërtojnë kuptime dhe ide të reja për bazën e njohurive që kanë. Mirëpo, ”Mësimdhënia e mirë është vështirë të përcaktohet, sepse termi *i mirë* ka më shumë ngjyrim emocional” (Musai, 2003: 16).

- Termin **mësimnxënie**, e kuptojmë si një proces unik edukativo-arsimor, i cili me udhëheqjen e mësimdhënësit dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve, zhvillohet me plan dhe në mënyrë sistematike, me qëllim të përvetësimit të diturive, shkathtësive dhe shprehive të reja. Pra, mësimnxënia është një proces i përhershëm dhe i pandërprerë i marrjes dhe i nxënies së njohurive. “Të nxënit është një proces, nëpërmjet të cilit çdo njeri fiton njohuri, shkathtësi dhe shprehi” (Kraja, 2009: 244).

- Termi *teknikë*, buron nga fjala greke – *techna*, që do të thotë shkathtësi, mjeshtëri, aftësi, mënyrë, veprim dhe rrjedhje (Vojka-Ismajli, 2012: 22). Në kuptimin më të ngushtë, fjala teknikë paraqet përmbledhjen e të gjitha mjeteve për punë, me të cilat njeriu shërbehet (Vojka-Ismajli, 2012: 22). Shikuar nga këndvështrimi i punës mësimore, me fjalën teknikë, kuptojmë tërësinë e mjeteve të ndryshme, përmbajtjeve, metodave dhe komponentët e tjerë që mësimdhënësit dhe nxënësit i zbatojnë apo i përdorin në procesin mësimor. Ndërkaq, teknika mësimore është rruga apo mënyra e veprimeve në zbatimin e mjeteve mësimore.

Në fjalorin e pedagogjisë, Shefik Osmani thekson se teknika përfshin ”tërësinë e rrugëve dhe të mjeteve që ndjek mësuesi për të zhvilluar mësimin” (Vojka-Ismajli 2012: 23).

- Termi *teknologji*, nënkupton një koncept të gjerë që merret me aplikimin e njohurive për veglat dhe profesionet, në funksion të kontrollimit dhe përshtatjes së rrethanave në ambientin jetësor në përputhje me nevojat e tij.

Emërtimi teknologji rrjedh nga dy fjalë të gjuhës greke: *techne*, që do të thotë *shkathtësi*, mjeshtëri dhe *logos* – *shkencë* (Opča enciklopedija, 1982: 149).

Studimet e kohëve të fundit, theksojnë natyrën plotësuese të inovacioneve organizative dhe teknologjike (Batisti & Stoneman, 2010), duke treguar se sinergjia në mes të këtyre dy llojeve të inovacioneve i bën ato procese komplementare dhe jo procese zëvendësuese (Camison & Villar – Lopez, 2014).

Në fjalorin e Shqipërisë së sotme, nocioni *teknologji* përfshin ”tërësinë e njohurive për mënyrën e përpunimit fizik, kimik, pjesërisht edhe mekanik, të lëndëve të para, të mallrave etj.” (2002: 1330).

Teknologjia është shkencë e cila merret me studimin e shkathtësive dhe diturive për të vepruar gjatë proceseve të ndryshme, domethënë shkencë mbi mjeshtërinë e punës, e cila, në kushtet bashkëkohore të punës dhe të prodhimit, luan rolin e ndërmjetësuesit midis teorisë dhe praktikës. Ndërsa në këtë rast, teknologjia mësimore kryesisht fokusohet në shkathtësitë dhe aftësitë për t'i përdorur mjetet, teknikat dhe format e ndryshme të punës organizative.

Sikurse mësimdhënësit që janë në hulumtim të pandërprerë të gjetjes së strategjive të reja mësimore, ashtu edhe institucionet e arsimit, familja, komuniteti dhe të gjitha organizatat qeveritare e joqeveritare, vazhdimisht janë në kërkim të më të mirës për shkollën, me qëllim që gjeneratave të reja dhe shoqërisë në përgjithësi, t'ju bëhet jeta më e mirë.

Sipas Musait (2003), mësimdhënia e fakteve, rregullave dhe veprimet për formimin e shprehive për përvetësimin e tyre, është një strategji e mësimdhënies së drejtpërdrejt, e cila ka në qendër mësuesin. Kjo zakonisht merr formën e një shpjegimi, i cili shoqërohet me shembuj dhe u krijon nxënësve mundësi për t'u ushtruar dhe të reagojnë përmes komenteve dhe analizës (f. 106).

Në kuptimin kibernetik, procesi mësimor është proces i informimit dhe komunikimit ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësit, me ndihmën e teknikës dhe teknologjisë mësimore dhe me mjedisin social e natyror. (Brada, 2010: 106).

Si teori mbi mësimdhënien dhe mësimnxënien e suksesshme janë:

- a) teoria e informacionit;
- b) teoria e komunikimit dhe
- c) teoria efektive. (Po aty: 106-121).

Sipas Fullanit (2010), "Interesi për reformat në arsim ka arritur maja të reja. Sfida e re tani është zgjidhja e problemit për arritjen e një reforme të gjerë, që i ka rrënjët tek përkatësia vendore – duke e kapërcyer kështu zgjedhjen e rreme midis risive vendore dhe makro-reformave të cekëta" (f. 7). Këto mësim të reja për reformën bëjnë të mundur që të jemi shumë më të saktë për mënyrën se si funksionojnë së brendshmi proceset e ndryshimit në mësimdhënie.

"Sikur ta përdornim terminologjinë e mësimdhënies tradicionale, kjo do të quhej mësimdhënie frontale, që do të thotë udhëheqje e drejtpërdrejtë e mësimdhënësit të të gjithë nxënësve të klasës njëkohësisht. Kjo teknikë e punës, e largon mësimdhënien nga individi dhe e drejton atë në grupin e tërë klasës" (Zajazi, 2003: 289). Nga ky citat mund të kuptojmë se teknikat e mësimdhënies që kanë mbushur afërsisht 10 vjet, ato tashmë kanë filluar t'i takojnë së kaluarës. Andaj, për ta thyer këtë monotoni dhe për ta kthyer vullnetin dhe dëshirën e nxënësit ndaj shkollës, mësimdhënia për nxënësit kërkohet të jetë tërheqëse, e larmishme, argëtuese, relaksuese, konkrete, inovative etj. Dhe, mu për këtë dhe arsye të tjera, mësimdhënia inovative më lehtë u përshtatet kërkesave dhe dëshirave të nxënësve, me qëllim për të arritur suksese më të favorshme, si në organizimin e punës në grupe punuese dhe çifte, ku, në shumicën e rasteve, mësimi u përshtatet aftësive individuale me qëllim që nxënësi të jetë në qendër të vëmendjes.

"Kapja" e botës, e arritur përmes mësimdhënies, nuk shërben vetëm për të përcjellë njohuritë dhe për të formësuar aftësitë dhe mjeshtëritë, por së pari fillon që të zhvillojë një intuitë morale dhe të forcojë karakterin. (Mendimtarët për edukimin, Byroja Ndërkombëtare e Edukimit, 2008: 111).

Për të qenë mësimdhënia inovative dhe e suksesshme, mësimdhënësit në klasë luajnë disa role pozitive, me qëllim për ta bërë nxënësin të ndihet i qetë në klasë, i lirë, pa stres, aktiv, hulumtues, bashkëpunues etj., që klasa të marrë një pamje të vërtetë pune. Për ta realizuar një mësimdhënie të tillë, mësimdhënësi është shtylla kryesore në bërjen e ndryshimeve në shkollë dhe në klasë, ngase mësimdhënësi i së ardhmes është ekspert, motivues, menaxher, këshilltar, model, moderator, aktor, hulumtues, reformues, ndjekës i ndryshimeve inovative dhe zbatues i tyre në praktikë.

Që nga Komenski e gjer në ditët e sotme, mësimdhënia ka pësuar mjaft ndryshime, nën ndikimin e kushteve shoqërore dhe ekonomike dhe të arritjeve në dijet e fushave të ndryshme shkencore. “Meritat e Komenskit dhe të pasardhësve të tij janë të pamohueshme, sidomos për kohën kur ata krijuan dhe vepruan, por edhe për atë që na kanë lënë, në mënyrë që, me përpjekjet tona, të ecim përpara drejt përsosjes dhe zhvillimit të teorisë dhe të praktikës mësimore” (Zylfiu, 2011: 38).

Kur flasim sot për mësimdhënien bashkëkohore, themi se kjo veprimtari ka arritur shkallën më të lartë të ndryshimit dhe zhvillimit në pikëpamje të njohjes së formave dhe strategjive të reja didaktike në organizimin dhe zhvillimin funksional të veprimeve të tjera të procesit të mësimdhënies. Mirëpo, nuk do të thotë se tani është gjithçka e përfunduar. Ajo ka ende shumë punë për të bërë dhe vazhdimisht ka nevojë të rinovohet, të përshtatet, të ndryshohet, të përmirësohet dhe të pasurohet me inovacione mësimore, me qëllim që mësimdhënia të jetë sa më e përshtatshme për aftësitë dhe moshën e nxënësve.

Në aspektin teorik, kemi analizuar literaturën tonë dhe të huaj lidhur me strategji të shumta të mësimdhënies, me qëllim për të pasur rezultate më të mira në shkollë.

Hulumtuesit kanë referuar këtë lloj problemi në kushtet e një ndarjeje midis teorisë dhe praktikës, duke ngritur dyshime në lidhje me efikasitetin e arsimimit të mësuesve, në përgjithësi, dhe duke sugjeruar që paraqitjet e reja dhe premtuese të të mësuarit dhe të mësimdhënies do të mund të shërbejnë më mirë për shkollën (Korthagen, 2010).

Nga eksperiencia jonë e mësimdhënësit, këtë temë e kemi zgjedhur për hulumtim, duke ditur që inovacionet mësimore rrisin cilësinë në mësimdhënie dhe ndryshojnë stilin e punës.

Përmes këtij hulumtimi, do të mundohemi që sadopak të ndikojmë pozitivisht në ngritjen e nivelit të vetëdijes së mësimdhënësve për një mësimdhënie bashkëkohore, që në klasë të dominojë vullneti, motivi dhe dëshira e nxënësve për të ditur më shumë. Andaj, ofrimi i shanseve të duhura për nxënës, zhvillon njohuritë dhe potencialin krijues të tyre (Williamson & Payton, 2009).

Mësimdhënia, në fakt, as në të kaluarën, as tani dhe as në të ardhmen, nuk ka qenë, nuk është dhe nuk mund të jetë e përsosur, pa marrë parasysh zhvillimet e kohëve të fundit, dhe asnjëherë nuk kemi të drejtë të kënaqemi me atë që e kemi arritur.

## **2.2. Teoritë bashkëkohore për mësimdhënien**

Nëse në shoqërinë tonë ka profesione që janë me përgjegjësi, atëherë një prej këtyre profesioneve është ai i mësimdhënies. Mësimdhënia është një proces jo i lehtë, është veprimtari e rëndësishme shoqërore dhe me përgjegjësi. Ka mendime se mësimdhënia është art, është shkencë, apo të dyja së bashku. “Nëse është mësimdhënia art, kërkon frymëzim, intuitë, talent e krijimtari. Nëse është shkencë, mësimdhënia

kërkon njohuri dhe shprehi, që me të vërtetë mund të mësohen”  
(<http://naimbabaj67.weebly.com.meumlmsimdheumlmiabashkeumlkohore.html>).

Teoria e Vigotskit, e formuluar afro 60 vjet më parë, ka një potencial të tillë heuristik, që shumë mirë mund të bëhej një nga instrumentet për këtë përtëritje të arsimit zyrtar të kohëve të sotme (Mendimtarët për edukimin, Byroja Ndërkombëtare e Edukimit, 2008: 378).

“Filozofia e shekullit XXI kërkon që brezi aktual të përgatisë krijuesit e rinj, që do të çojnë përpara zhvillimin e jetës në nivel lokal, kombëtar dhe global në të ardhmen” (Vuji, 2015: 52). Nga ky citat mund të kuptojmë se, varësisht nga niveli i përgatitjes së gjeneratave të sotme, atë nivel do të ketë shoqëria e së nesërme.

Shumë studime në lidhje me këtë çështje janë zhvilluar gjatë dekadave të fundit, duke trajtuar aspekte të ndryshme të interesit dhe progresit në ndërtimin e njohurive të reja në këtë fushë. Lidhur me analizën e këtyre çështjeve studimore u morën (Krapp & Prenzel, 2011; Potvin & Hasni, 2014; Renninger & Hidi, 2011; Schraw & Lehman, 2001) etj.

Mësimdhënia është një veprimtari refleksive dhe vepron me qëllime të menduara arsimore për zhvillimin e nxënësit dhe me përmbajtje të caktuar, që e bëjnë të mundur atë zhvillim (Zajazi, 2003: 101).

Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton ndryshimin e roleve të mësuesit dhe të nxënësit, me qëllimin kryesor, lehtësimi i të nxënësit (<https://darvlore.wikispaces.com/file/view/revista+pedagogjike+2011.pdf>).

Për të bërë ndryshime madhore dhe inovative në institucionet e arsimit, përpos mësuesve, barra i bie edhe ministrisë së arsimit, bashkë me institucionet e tjera, duke

krijuar politikat dhe buxhetet me të cilat mbështesin shkollat në implementimin e reformave (VanBalkon & Mijatoviq, 2006: 3).

Për të krijuar inovacione mësimore në mësimdhënie, sistemet arsimore e pranojnë se shpenzimi në arsim është një investim në zhvillimin e kapitalit njerëzor, që nga fëmijëria e hershme deri në moshën e rritur, duke shpënë kështu drejt produktivitetit ekonomik dhe kohezionit social gjeneratat e ardhshme (Hargreaves & Fullan, 2013: 36).

Si proces i organizuar, mësimdhënia është një veprimtari, me të cilën arrihet realizimi i një qëllimi të caktuar me detyrat e parashtruara, e në literaturën didaktike kryesisht njihen dy modele të mësimdhënies (Zylfiu, 2010: 40):

1. *Mësimdhënia e drejtpërdrejtë*, me objektiv të përqendruar në arritje të shpejtë të zotërimit të fakteve, rregullave dhe formim të shprehive për to, kurse përmbajtja e lëndës është e ndarë në hapa të vegjël, që përvetësohen lehtë dhe procesi mësimor mbikëqyret nga mësimdhënësi (Po aty: 40);

2. *Mësimdhënia jo e drejtpërdrejtë*, tek e cila objektivi qëndron në përfshirjen e nxënësve në shqyrtim dhe hetim, gjë që ndihmon në formimin dhe zhvillimin e koncepteve në formën e modeleve dhe abstraksioneve (Po aty: 40).

Nga të dyja këto modele të mësimdhënies, mund të kuptojmë se, sikurse njëra, ashtu edhe tjetra, janë procese që vazhdimisht kërkojnë ndryshime dhe plotësime me qëllim që nxënësit gjatë mësimnxënies të jenë më afër realitetit lidhur me problematikën e shtruar. Në disa shkolla urbane dhe rurale të Anamoravës së Kosovës, disa mësues rrugë të bashkëpunimit me prindër e kanë zgjedhur internetin, me qëllim të komunikimit më të mirë mes vete. Lidhur me këtë formë të komunikimit janë deklaruar edhe prindërit (disa prej tyre, nga komuna e Gjilanit dhe Kamenicës), duke e parë si formën



më të lehtë, më të shpejtë dhe mjaft konstruktive, që të mos humbet kohë për arritjen e qëllimeve të caktuara (Komunikim personal, 11-12 maj, 2016).

Është shumë e qartë se shoqëria dhe shumë prindër nuk besojnë se ajo që po ndodh në shkollë, rrit cilësinë e jetës së tyre. (Glasser, 1993: 33). Andaj, qëllimi i shkollave është të ndryshojë këtë situatë, në mënyrë që nxënësit, mësimitdhënësit, prindërit dhe komuniteti të kenë mundësi të punojnë dhe të kontribuojnë në përparimin e shkollave.

Nëse do të kemi parasysh që mësimitdhënës inovator është ai që organizon, zhvillon, kontrollon, ndryshon dhe drejton tërë procesin edukativo-arsimor, atëherë na del e qartë që rezultatet e punës në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie varen drejtpërdrejt nga mësimitdhënësi dhe lidhur me këtë, “Shumë mësimitdhënës mendojnë se, nëse i zgjerojnë përmbajtjet programore, e përmirësojnë cilësinë e mësimit” (Bektashi, 2009: 126).

Edhe Kurrikula e re e Kosovës, parasheh që gjatë gjithë niveleve të arsimit, nxënësit përgatiten për të mësuar gjatë gjithë jetës për botën e punës, kur dija bazohet në digjitalizim (MASHT, Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Kosovës, 2011: 25). Kjo do të thotë se shkollat mund të përgatisin nxënësit të së ardhmes, që në situata të ndryshme dinë të ndeshen me veprimtaritë praktike të rrethit ku jetojnë e më gjerë.

Teoritë bashkëkohore, nga mësimitdhënësit kërkojnë të jenë ekspertë të përsosur, organizatorë të mirëfilltë dhe realizues të suksesshëm të procesit të mësimitdhënies.

### **2.3. Roli i inovacioneve mësimore në aspektin pedagogjik**

Çdo mësues mund të punojë me ritmin e duhur për të kërkuar e për të gjetur mjetet dhe rrugët më të mira për zbatimin e fjalëve drejt praktikave të përditshme mësimore (Vuji, 2015: 179).

Pedagogjia është e lidhur ngushtë me të gjitha shkencat që merren me studimin e ligjësive të zhvillimit psikik dhe fizik të njeriut dhe të shoqërisë njerëzore (Kraja, 2012: 71). Prandaj, lidhur me këtë, zbatimi i inovacioneve mësimore në mësimdhënie, nxit, stimulon dhe, në shkallën më të lartë, i ndihmon nxënësit në zhvillimin e përgjithshëm edukativ në shkollë e më gjerë.

Zhvillim i procesit edukativo-arsimor në shkollë, në mungesë të risive mësimore, nuk është i mjaftueshëm për një zhvillim intelektual të personalitetit të nxënësve, ngase tani, kudo që jetojmë dhe veprojmë, jemi të rrethuar nga risi të shumta dhe të larmishme. Zbatimi i inovacioneve në procesin e mësimdhënies ka efekt pozitiv, sepse sjell dobi dhe ndikon në tërheqjen e vëmendjes së nxënësve dhe stimulon ata për ta dashur më shumë shkollën.

Çështja e ndikimit të inovacioneve mësimore në aspektin pedagogjik, është një çështje edukimi e arsimimi të nxënësve në krahasim me ndryshimet që po ndodhin, mandej “Shkolla ka qenë e mbetet edhe sot faktori qendror për formimin dhe përgatitjen e nxënësve sipas kërkesave të shoqërisë” (Krasniqi; Deva-Zuna, 2012: 346).

Sot nuk është mençuri dhe as për t'u bërë krenar me atë se si punohet dhe ku punohet, duke menduar shpesh gabimisht se vetëm klasa është vendi ku mund të edukohen gjeneratat e reja. “Puna për një kohë të gjatë në lokale të mbyllura, së pari në shkollë, e pastaj edhe në shtëpi, pa dritë të mjaftueshme dhe pa kushte të mjaftueshme

higjienike, jo vetëm që pengon zhvillimin e drejtë të aftësive fizike dhe pedagogjike, po mund të ndikojë dëmshëm edhe në shëndetin përgjithshëm fizik të nxënësve” (Bektashi, 2009: 56). Nga kjo mund të konkludojmë se klasa nuk është vendi i vetëm për edukimin e nxënësve, sepse, përpos shumë vetive pozitive që ka ajo, ka edhe vetitë negative, prej të cilave gjithsesi mund të nxjerrim mësim dhe mund të bëjmë ndryshime. Ndryshimet në klasë ndodhin atëherë kur mësimdhënësi e thyen monotoninë e mbylljes në klasë, duke dalë nga brendia e mureve të klasës në një klasë të verës (në natyrë), duke i edukuar dhe duke i njohur nxënësit drejtpërdrejt me natyrën, si: buzë një lumi apo liqeni ose edhe në një uzinë etj.

Për nxënësin, çdo gjë e re që shikohet, preket apo shijohet për herë të parë është inovacion, andaj të gjitha ato dukuri natyrore me të cilat nxënësit ballafaqohen drejtpërsëdrejti dhe që për herë të parë kanë arritur të mësojnë apo kuptojnë për to, kanë të bëjnë me inovacione nëpërmjet të cilave nxënësit fitojnë përvojë të drejtpërdrejtë edukimi se si duhet të kujdesen për mjetet e punës, për natyrën dhe rrethin ku ata jetojnë.

“Qëllimi i edukatës dhe mësimi, me zhvillimin e mjeteve të punës dhe të prodhimit dhe të fuqive prodhuese, kryesisht me rrjedhat e zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, përherë ndryshon dhe fiton në cilësi” (Brada, 2010: 48).

Sipas Vujit “Për të aftësuar nxënësin për të menduar e vepruar si vizionar, kërkohen që të përpunohen praktika të reja pedagogjike, që krijojnë kushte që ata të punojnë vetë për vetëformimin e sistemit të tyre të të nxënit” (2015: 93).

Zbatimi i inovacioneve në aspektin pedagogjik, ndikon dukshëm edhe në tjetërsimin e nxënësit. Pra, inovacionet, sikurse edhe shumë faktorë të tjerë, janë ndër

faktorët e rëndësishëm që nxënësit i nxit të mos jenë pasivë gjatë orës mësimore, por të jenë më të suksesshëm, më të sjellshëm dhe më të socializuar.

Roli i inovacioneve gjatë procesit mësimor është mjaft i rëndësishëm, sidomos atëherë kur shfaqen në të gjitha nivelet e shkollimit, sepse ato nxënësit i bëjnë të jenë më të kujdesshëm, më vigjilentë, më të afërt dhe më të qëndrueshëm ndaj veprimtarisë mësimore.

Ka mjaft diskutime rreth strategjive të edukimit dhe aplikimi i tyre lidhet me mjaft probleme shoqërore dhe shkencore (Kraja, 2009: 136). E gjithë kjo ka një qëllim të vetëm, për t'i ndihmuar nxënësit që të përshtaten më lehtë në aspektin edukativo-arsimor.

#### **2.4. Roli i inovacioneve mësimore në aspektin psikologjik**

Të gjithë mësuesit janë të vetëdijshëm se zhvillimi i shprehive të menduarit, është mënyrë mjaft e rëndësishme për të ndihmuar nxënësit t'u përshtaten ndryshimeve apo risive që paraqiten.

Studiuesit, administratorët dhe prindërit janë të ndërgjegjshëm për kohën e ndryshimeve jashtëzakonisht të shpejta. Shoqëria njerëzore, sikurse në aspektin kulturor, psikosocial, ashtu edhe në atë arsimor, vazhdimisht po ndryshon, ndaj edhe nxënësve gjithashtu u nevojiten shprehi të reja që t'u përshtaten më lehtë këtyre ndryshimeve. Mësuesit shpesh zbatojnë ndryshime që i ndihmojnë nxënësit për t'i zhvilluar shprehitë e arsytimit dhe proceset e zgjidhjes së problemit. Lidhur me këtë, ata zhvillojnë strategji dhe teknika që i ndihmojnë nxënësit të kërkojnë në brendësi të të nxënësve të tyre për të arritur një zgjidhje (Musai, 1999: 144).

Ndikimi i inovacioneve mësimore në aspektin psikologjik lidhet edhe me përjetimet emocionale të nxënësit në mësim, në rastet kur ai për herë të parë ballafaqohet me ndonjë veprimtari të re mësimore, çka do të thotë se çdo risi e paraqitur për herë të parë në klasë, shoqërohet me emocione nga nxënësit. Zbatimi i risive nga ana e mësimit në procesin e mësimit, varet shumë se a do ta pranojnë apo do ta refuzojnë nxënësit mësimin, pra a do të jenë ato risi për ta tërhequr apo për ta larguar nxënësin nga procesi.

Gjatë procesit të mësimit, inovacionet i ndihmojnë nxënësit në zhvillimin psikologjik të tyre, por në raste kur mospërputhja midis risive dhe përmbajtjeve mësimore është e madhe dhe i gjithë materiali kuptohet me vështirësi, atëherë kjo mund të ndikojë negativisht në zhvillimin psikologjik të nxënësit. Punën arsimore, nxënësi e përjeton shpirtërisht, në mënyrën intelektuale dhe emocionale, andaj përjetimet intelektuale kanë të bëjnë me proceset intelektuale, të cilat i shërbejnë njeriut për të përvetësuar dituri.

Shpesh fëmijët duken se e kanë humbur interesimin për shkollën! Përgjigjja për këtë pyetje dhe të tjera, është se nxënësit nuk janë sa duhet të motivuar, ngase disa nga mësimit vazhdimisht zbatojnë të njëjtat teknika dhe metoda mësimore, duke mos ndryshuar asgjë në të mirë të nxënësit, duke u arsyetuar se nuk ka mjete të mjaftueshme mësimore, si dhe nuk kanë ide se çfarë inovacionesh të paraqesin në klasë.

*“Është e natyrshme, madje edhe e domosdoshme që didaktika të bashkëpunojë me psikologjinë, sepse, përmes mësimit, nxënësi ndryshon në mënyrë progresive natyrën e tij, zhvillon aftësitë psikofizike të secilit nxënës të zhvillimit të proceseve psikike kognitive – të ndijimeve, perceptimeve, vëmendjes, përfytyrimeve, kujtesës, të të*

*menduarit – formimit të nocioneve, gjykimeve, konkluzioneve, të aftësive të veçanta të personalitetit – të inteligjencës, shkathtësive dhe shprehive etj.” (Brada, 2010: 28).*

Të dhënat e vlefshme lidhur me ndikimin e inovacioneve në procesin mësimor tek nxënësit e shkollimit fillor, dëshmojnë se psikologjia zhvillimore në të mësuarit apo në të nxënësit ofron mësim të suksesshëm, ngase inovacionet i bëjnë nxënësit më të ndjeshëm, më të afërt me lëndën mësimore dhe më të vëmendshëm në kapjen e përmbajtjeve mësimore.

Ndikimi i risive tek nxënësit e shkollimit fillor, në aspektin psikologjik, ngërthen në vete një numër komponentësh të natyrës psikosociale, duke përfshirë në rend të parë klimën e përshtatshme në mësim, duke krijuar mundësi dhe kushte të favorshme që nxënësit emocionalisht ta përjetojnë orën mësimore.

Duke pasur parasysh ndikimin e inovacioneve në procesin e mësimdhënies dhe zbatimin tyre të drejt dhe në kohën e duhur, tek nxënësit mjaft pozitivisht ato ndikojnë në pengimin harresës dhe zbutjen e lodhjes në klasë, duke bërë të mundur mbamendje më të qëndrueshme. Çdo risi që silltet në klasë, orën mësimore e bën më interesante dhe më tërheqëse, duke kontribuar që përmbajtjet mësimore të nguliten tek nxënësit më lehtë dhe në mendjet e tyre të mbeten të ruajtura për një kohë më të gjatë.

Për t'u bërë më tërheqëse mësimdhënia, në partneritet me nxënësit, mësimdhënësit marrin vendime të përbashkëta (Krasniqi & Deva, 2012: 86). Kjo do të thotë se një veprim i tillë i mësimdhënësit ndikon pozitivisht në shmangien e pasivitetit të nxënësve në klasë.

Bashkëpunimi, mirëkuptimi, klima psiko-pedagogjike, mirësjellja e dyanshme, gjetja e formave dhe metodave të përshtatshme për mësimdhënie, ndryshimet dhe rinovimet e përmbajtjeve mësimore etj., bëjnë që nxënësit, po edhe mësimdhënësit, ta ndiejnë veten më të sigurt, më aktivë dhe më të qëndrueshëm gjatë punës mësimore.

## **2.5. Përpjekjet rreth pasurimit të shkollave me inovacione mësimore**

Që nga kohët më të vjetra, tani dhe në vazhdimësi, asnjëherë nuk do të ndalet kërkimi i risive mësimore për të bërë një shkollë sa më të përparuar, me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira nga nxënësit.

Nëse jemi të sigurt se mund të ndryshojmë dhe të pasurojmë organizimin dhe zhvillimin e mësimdhënies, atëherë është e logjikshme që, para marrjes së ndonjë hapi konkret në këtë drejtim, duhet t'i njoftojmë mësimdhënësit me karakterin e ndryshimeve. Për fat të keq, sot iniciativa të mëdha reformash ndërmerren vetëm për arsye se gjendja ekzistuese nuk u përgjigjet nevojave momentale shoqërore dhe fitohet përshtypja se arsimi më tepër duhet të plotësojë kërkesat momentale shoqërore sesa ato që do të pasojnë më vonë.

Pasurimi i shkollave me inovacione mësimore bëhet me qëllim të shfrytëzimit të mjeteve moderne mësimore dhe koordinimit të punës së mësimdhënësve me qëllim të nxitjes së aktivitetit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Pasurimi dhe ndryshimi i një shkolle gjithashtu kërkon që mësuesit dhe administratorët të mbështesin njëri-tjetrin dhe të ndajnë një vizion për të ardhmen e shkollës (Abbott et al, 2006; Billig et al, 2005; Glazer et al, 2005; Staples et al, 2005).

Qëllimi i inovacioneve mësimore është që të tejkalohet sistemi i vjetër i mësimdhënies, duke synuar që mësimdhënësia t'u përshtatet aftësive individuale të nxënësve.

Inovacionet mësimore në organizimin dhe realizimin e procesit të mësimdhënies, janë shumë më të ndërlikuara se inovacionet e fushave të tjera, ngase ato kërkojnë një

angazhim profesional të mësimit dhe përshtatje moshës dhe aftësive psikofizike të nxënësit.

Mësimit janë të kujdesshëm ndaj nxënësve, si në respektimin e karakteristikave fizike dhe moshës së caktuar, sigurimin e kushteve në shkollë – klasë, ofrimi i shanseve të barabarta në mësim, respektimi i nevojave të veçanta etj. (Krasniqi & Deva-Zuna, 2012: 39).

Pasurimi i shkollës me inovacione mësimore, bën të dominojë puna individuale, puna në çifte dhe puna në grupe. Lokali shkollor është i tillë që të ketë mjaft hapësirë për manipulime me mjete didaktike, për punën e bibliotekës së shkollës, për shfrytëzimin e materialeve të programuara për mësim etj. Dominojnë metodat mësimore, të cilat e motivojnë nxënësin që të punojë për përvetësimin e diturive në mënyrë të pavarur. Madje zhvillohet dhe begatohet në mënyrë të ndjeshme baza teknike dhe teknologjike e mësimit.

Kur inovacionet mësimore gjejnë zbatim në shkollë, procesi i mësimit orientohet në hulumtimin, analizën, gjykimin, konkludimin etj., përderisa ndryshon funksioni i mësimit, duke qenë gjithnjë e më pak ligjërues dhe kontrollues i diturive, ndërsa gjithnjë e më shumë hulumtues dhe organizator i punës edukativo-arsimore.

Në kohën që po jetojmë, edhe problemet ekonomike janë një ndër shkaktarët kryesorë të zhvillimit të shoqërisë sonë, që reflektohen edhe në fushën e arsimit dhe kështu në një masë stagnojnë pasurimin e shkollave me inovacione mësimore.



## **2.6. Ndikimi i mësimdhënies inovative në shkollën e shekullit XXI**

“Filozofia arsimore e shekullit XXI kërkon që nxënësit të formohen si forca krijuese vizionare, të afta për të vetideuar të ardhmen e tyre dhe për ta kthyer atë në një realitet të ri në dobi të vetes dhe të shoqërisë” (Vui, 2015: 19).

Shkollat në fillim të shekullit XXI, ishin mjedise komplekse, kishte rritje të diversitetit në komunitetet e shkollave, kurrikula vazhdimisht ndryshonte, kishte sfida, pasiguri dhe paqartësi të ndryshme në mësimdhënie (Goodfellow & Sumsion, 2000: 253).

Shkolla bashkëkohore bazohet në sistemet shkollore të Evropës Perëndimore dhe në ato të tjera më të përsosura botërore (Rexhepagiq, 2008: 296). Shkolla e shekullit XXI është e orientuar nga e ardhmja, duke zbatuar metoda dhe mjete të reja gjatë procesit të mësimdhënies, duke mbizotëruar frymë e re dhe bashkëpunim midis nxënësve dhe mësimdhënësve. Kjo shkollë vazhdimisht përpiqet të ndjekë sa më shumë rezultatet dhe ndryshimet në jetën shoqërore dhe kulturore. Andaj, nuk është e rastësishme përse këto shkolla quhen edhe shkollat efektive ose edhe shkolla të së nesërme, duke qenë njëkohësisht të lira, të hapura dhe multikulturore.

Mjetet për arritjen e orientimit të integruar të punës profesionale të mësuesve të shekullit XXI, janë mjete që ndikojnë jo vetëm për të përmirësuar aftësitë profesionale të mësimdhënësve, por edhe për të siguruar zgjerimin e përvojës së tyre me burime të reja elektronike të mësimdhënies dhe për të dhënë njohuri në procesin e koncepteve të asimilimit brenda një mjedis virtual didaktik (MacDonald et al, 2013).

Aktualisht, ka një numër studimesh mbi aktivitetin e nxënësve në procesin arsimor të zbatimit elektronik me burime arsimore, të cilat përfshijnë materiale mësimore elektronike (Galchenko, 2015: 37).

*“Në shkollën bashkëkohore kërkohet që mësimit dhe nxënësi të afirmohen si subjekte të mësim, të marrin qëndrim aktiv kritik ndaj burimeve të njohurive në mësim, të zgjedhin dhe të shtjellojnë përmbajtje shkencërisht të vërtetuara, aktuale dhe të dobishme, të cilat mund dhe kërkohet t'i përvetësojnë nxënësit” (Brada, 2010: 103).*

Në shkollën e shekullit XXI, mësimit respekton personalitetin e nxënësve, motivon ata për mësim aktiv dhe kreativ, lejon lirinë e veprimit, të mendimit dhe të shprehjes së lirë, si parakusht për zhvillimin e potencialeve njerëzore të tyre. Në këtë kontekst, mësimit në shkollën e shekullit XXI, vazhdimisht fiton kuptim, rol dhe funksion të ri.

Sot, në kohën e kompjuterizimit dhe të mundësive të pakufizuara të internetit, me më shumë rëndësi është që shkolla vazhdimisht të hulumtojë gjetjen e informacioneve të nevojshme për pasurimin e nxënësve me to. Në shekullin XXI, do të kemi nevojë për njerëz të cilët mund të gjejnë metoda, forma apo teknika efektive për kryerje më të mirë të punës. Këtë duhet ta kuptojnë të gjitha palët e përfshira në procesin edukativo-arsimor, ata që e krijojnë politikën e arsimit, si dhe ata të cilët janë drejtpërdrejt të përfshirë në procesin mësimor.

Në shkollën e shekullit XXI, prindërit dhe familjet ndihen si partnerë të cilët gjithashtu marrin pjesë në suksesin e ardhshëm të nxënësve. Shkolla e shekullit XXI, nuk i përgatit nxënësit për botën e tanishme, por për botën e së nesërme, e cila është e vështirë për t'u imagjinuar, por e vërtetë për t'u dëshmuar.

Mësimi inovativ nuk toleron shabllonizime, por kërkon transparencë ndaj risive, interesanteve, metodave të reja, formave dhe mjeteve që inkurajojnë për zhvillimin e shkathësive krijuese te nxënësit dhe të rolit më kreativ në komunikimin me nxënësit. ([http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Krijimi\\_i\\_mjedisit\\_p%C3%ABrt%C3%AB\\_nx%C3%ABnit\\_p%C3%ABr\\_shekullin\\_XXI.pdf](http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Krijimi_i_mjedisit_p%C3%ABrt%C3%AB_nx%C3%ABnit_p%C3%ABr_shekullin_XXI.pdf)).

Shkolla inovative e shekullit XXI përpiqet të mbajë baraspeshë midis detyrave materiale dhe funksionale në mësim, mes ndryshimeve dhe integriteteve, mes individualizimit dhe socializimit, mes konkretizimit dhe abstraksionit etj.

Mësimdhënësi inovator i nxit nxënësit që përmes të menduarit logjik, fotografive, vizatimeve, skemave dhe mjeteve të tjera didaktike, t'i mësojnë të vërejnë problemet dhe zgjidhin detyrat. Shumë më pak fjalë do të shpenzojë mësimdhënësi nëse përmbajtjen mësimore e kombinon me film apo me fotografi, që paraqet një detaj nga jeta, duke zgjuar interesimin dhe motivimin e nxënësve për aktivitete pune në klasë.

Objekti shkollor i shekullit XXI, përveç lokaleve të mësimin teorik, duhet të ketë edhe ato të mësimin praktik (kabinete, laboratorë, klasë elektronike, punëtori universale dhe repartin didaktik të prodhimit për shkollat profesionale, lokalin për sistemin multimedial të informimit dhe komunikimit), lokalet në të cilat nxënësit ushtrojnë aktivitete edukative gjatë kohës së lirë, palestrën për kulturë fizike dhe për argëtim, terrenet për sportet e vogla, pishinë etj. (Brada, 2010: 324).

Duke përdorur teknologjitë e reja mësimore, si, për shembull: kompjuterët, telefonat celularë, kamerat digjitale, Ipad-ët me MP3, pajisjet e lojërave, tabelat digjitale, grafikët, fotografitë, videopamjet, videoprojektorët e deri te përfshirja e përdorimit të internetit etj., shkollat arrijnë më shpejt të shndërrohen në shkolla të së ardhmes.

Mjediset mësimore të shekullit XXI, vazhdimisht përpiqen të krijojnë partneritete të gjera në forcimin e fuqisë punëtore të arsimit, si një lloj "investime kapitale" shoqërore dhe intelektuale (Hargreaves & Fullan, 2012).

Në shekullin XXI, nuk është çështje e rëndësishme se a jemi për zbatimin e teknologjisë mësimore apo nuk jemi, por çështja shtrohet se si të krijojmë kushte që në procesin e arsimit dhe të edukimit, nxënësit të përvetësojnë teknikat bashkëkohore, duke qenë të kënaqur në arritjet e tyre.

### **2.7. Ndikimi i infrastrukturës bashkëkohore në shkollat inovative**

*“Ndërtesat shkollore, si objekte të dedikuara për nevoja mësimore, në të kaluarën e hershme, së pari u paraqiten në epokën historiko-shoqërore skllavopronare, në Greqinë antike. Andaj, deri më sot ato kanë pësuar ndryshime të shumta, që ndodhin krahas zhvillimit të teorisë dhe të praktikës mësimore, si dhe të bazës ekonomike-shoqërore” ( Zylfiu, 2004: 141).*

Shkolla është një institucion i organizuar arsimor, në cikle të ndryshme moshore dhe mësimi. Ajo nuk ka për qëllim vetëm riprodhimin, por synon të aftësojë individin që ai të zotërojë informacionin, ta përpunojë atë dhe të zgjidhë problematika të ndryshme (Peshkopia, 2012: 19).

Inovacionet e vëna në gjendje aktive dhe objektive, pozitën e mësimdhënies dhe të mësimnxënies e kanë sjellë në afirmimin e vlerave humaniste në të cilat mbështetet tërë jeta dhe puna në shkollë.

Infrastruktura shkollore është pjesë shumë e rëndësishme në mbështetje të inovacioneve për zhvillimin social të nxënësve. Ky mjedis social luan një rol të

rëndësishëm edhe në suksesin e nxënësve, duke siguruar një kontekst ekzistues për risitë që të angazhohen në të (Zhao & Frank, 2003: 830). Ky mjedis social ofron burime në formë të kapitalit social për të mbështetur praktikën inovative (Frank, 2004).

Sot gjithnjë e më shumë po i kushtohet rëndësi ndërtimit të objekteve shkollore, me qëllim që ato të jenë sa më të përshtatshme për zhvillimin e papenguar të mësimin, për organizimin e punës grupore dhe individuale të nxënësve, që është në ndërlidhje me jetën shoqërore. Sot ndërtesat shkollore ndërtohen në atë mënyrë që, përveç klasave, kabineteve dhe laboratorëve, kanë edhe bibliotekën dhe sallën e leximit, mjetet dhe pajimet e nevojshme mësimore për punë grupore dhe individuale, lokal të mjaftueshëm për zbavitje kulturore, punëtoritë shkollore, lokalin për edukim muzikor dhe atë të artit figurativ, për aktivitete sportive, për shërbimin psikologjik-pedagogjik, kuzhinën për ushqimin e fëmijëve, lokalin për takime me prindër etj. Përpos kësaj, objekti shkollor, mund të jetë një ndërtesë moderne, ku nxënësit më tepër do të gjejnë argëtim dhe kënaqësi në këto objekte shkollore, sesa në shtëpitë e tyre. Në të kundërtën, nxënësve shumë shpejt do t'u mërzitet shkolla dhe në njëfarë mënyre do ta urrejnë atë.

Në shumicën e shkollave, ngjyra e mureve është e bardhë dhe pothuajse aspak në institucionet arsimore nuk flitet lidhur me këtë çështje, ngase ngjyra e bardhë nuk i zvogëlon emocionet dhe shkakton tmerr si dhe nuk rrezaton ngrohtësinë e shtëpisë dhe nuk i motivon nxënësit (Ministarstvo Prosvete Srbije, 2010: 40). Ndërkaq, ngjyra e verdhë e theksuar, tek nxënësit zgjon humor të mirë, rrit qetësinë dhe përqendrimin gjatë punës me nxënës (Po aty: 40). Nëse korridoret e shkollave kanë hapësira të mëdha, do të ishte mirë që në to të vendoseshin disa tabela muri, të cilat nxënësit gjatë kohës së lirë, do të mund t'i shfrytëzonin për të shkruar apo për të zgjidhur në grup ndonjë

problem për të cilin tashmë kanë diskutuar me mësimdhënësin gjatë orës mësimore (Ministarstvo Prosvete Srbije, 2010: 40).

Ndërtesat moderne shkollore kanë kopshtet shkollore, terrenet sportive për aktivitete fizike, pishinat për notim etj. Muret e objekteve shkollore kanë makina dhe instalime të ndryshme për përdorimin e mjeteve moderne mësimore dhe, krahas këtyre, funksionaliteti pedagogjik i mobilieve, nxehjes, pastrimit dhe ndriçimit të lokaleve është i rregulluar mirë, me qëllim që puna në shkollë jo vetëm të jetë e sigurt, por edhe të mbrojë shëndetin e nxënësve (Ministarstvo Prosvete Srbije, 2010: 40). Ndërtesat moderne shkollore, ndërtohen në atë mënyrë që për të ardhmen të kenë parasysh edhe qëndrimin tërëditor të nxënësve në shkollë, siç janë disa shkolla të Prishtinës, bashkë me shtegun e lëvizjes për nxënësit me nevoja të veçanta, sidomos për ata nxënës që janë me aftësi të kufizuara të lëvizjes.

Objektet shkollore janë të tipit të hapur, me korridore të gjera, me mësonjëtoje që kanë sipërfaqe të madhe, me dritare të shumta dhe ndriçim të mjaftueshëm, me banka lëvizëse, që mundësojnë organizimin e mësimit frontal, në dyshe dhe në grupe (Brada, 2010: 323).

Zhvillimi i arkitekturës së ndërtesave shkollore ka ecur në harmoni me kërkesat bashkëkohore të organizimit të mësimit, duke mundësuar që mësimi në to të zhvillohet në forma, metoda, teknika dhe teknologji bashkëkohore (Zylfiu, 2004: 144).

Kur kemi të bëjmë me shkallën arsimore të shkollimit të nxënësve, ndërtesat shkollore mund të jenë me përmbajtje të objekteve mësimore dhe pajisje të tjera, sipas moshës së fëmijëve (6 – 15 vjeç). Ndërsa objektet mësimore, për nga mënyra e zgjidhjes arkitektonike, u përshtaten kushteve dhe rrethanave të punës mësimore me fëmijët me të

meta në të parë, në të dëgjuar, në të folur si dhe me fëmijë me ngecje në zhvillimin mendor dhe fizik.

Sipas rregullave apo kriterëve të lartpërmendura, kuptojmë se, për të pasur objekte shkollore për mësimdhënie dhe mësimnxënie aktive, ato u duhen përshtatur nxënësve sipas moshës, profesionit (profileve) dhe aftësive psikofizike të tyre dhe pikërisht atëherë mund të themi që jemi afër së vërtetës se një objekt mësimi është me infrastrukturë bashkëkohore.

Shkolla bashkëkohore, është e pajisur edhe me kabinete, si mësonjëtoje të specializuara me pajisje didaktike, në mënyrë që mësimdhënia të paraqesë një ndër mundësitë dhe rrethanat më adekuate për krijimin e situatave mësimore në realizimin e plotë të lidhjes së njohurive teorike me praktikën, të lidhjes së shkollës me jetën dhe të përgatitjes së nxënësve për jetë (Zylfiu, 2011: 265).

Pajisja e shkollës me kabinete, mjete mësimore dhe me mundësi të organizimit praktik të veprimtarisë së nxënësve sipas përmbajtjeve lëndore-mësimore, bën të mundur që shumë probleme mësimore të zgjidhen dhe të kuptohen më mirë, po edhe njohuritë e fituara të jenë më të qëndrueshme.

Në shkollat me infrastrukturë moderne, raportet ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve janë raporte pune, bashkëpunimi, bashkëveprimi dhe komunikimi, sepse, sikurse mësimdhënësit ashtu edhe nxënësit, japin dhe marrin informacione kthyesë për cilësinë e përvetësimit dhe të zotërimit të aktiviteteve punuese (Brada, 2010: 200).

Në rastet kur shkolla i plotëson kushtet e lartpërmendura dhe mësimdhënia është e tipit bashkëkohor, atëherë gjithësesi edhe rezultatet mësimore do të jenë më të mira.

## **2.8. Shkolla inovative për një të nesërme më të mirë**

Shkolla e së nesërme është një bazë e fortë dhe shpresëdhënëse për një epokë të re, me qëllim për t'i afruar njerëzit më pranë njëri-tjetrit, qoftë mësimdhënësit dhe nxënësit, qoftë udhëheqësit e shkollave dhe prindërit etj.

Njerëzit e sotëm po bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për rëndësinë e ndjenjës së tendencave të zhvillimeve globale për vendimmarrjen e tyre të sotme, duke ndier veten qytetarë të botës, si në mënyrën e të menduarit ashtu edhe në të vepruarit, duke i lidhur problemet kombëtare me ato globale, duke krijuar zgjerim të njohurive, zhvillim të teknologjisë së informacionit elektronik si dhe duke krijuar një rend informativ botëror (Kraja M., Mustafa, Çela, Kraja E. 2013: 247). Roli i ardhshëm i mësuesve, nuk varet vetëm nga specifikat se si është organizuar mësimi, por, në pozicionin e ardhëm, shkolla do të jetë një institucion kyç social, ku secili pjesëmarrës në të do të gjejë ngrohtësi dhe besueshmëri njerëzore

(<http://www.oecd.org/edu/school/1840205.pdf>).

Shkolla e së nesërme është e hapur, me rrjet të drejtpërdrejtë dhe vazhdimisht është në shërbim të njerëzve që e duan dhe dëshirojnë ta ndihmojnë atë, si: në shërbim të mësimdhënësve, të cilët mund të bashkëpunojnë mes vete lidhur me aktivitetet e tyre mësimore, shkoqitjen e planeve dhe programeve mësimore (ditore, javore, mujore dhe vjetore) etj.; në shërbim të nxënësve, ngase edhe ata mund të komunikojnë mes vete lidhur me problemet apo detyrat e shtëpisë etj.; në shërbim të prindërve, ngase ata janë njerëzit që më së shumti duan të dinë për fëmijët e tyre, për ndryshimet që bëhen brenda dhe jashtë shkollës, për aktivitetet edukativo-arsimore dhe kulturo-artistike si dhe për suksesin, sjelljen apo disiplinën e tyre.



Shkolla është një dritare e madhe në të cilën vazhdimisht depërtojnë rrezet e ngrohta të një dielli të përbashkët të kësaj bote, nga të cilat rreze nxënësit marrin ngrohtësinë për të ngrohur veten dhe të tjerët. Andaj, gjeneratat e reja, për të përjetuar më lehtë dhe më shpejt “rrezet e ngrohta” të informacionit të ri, është kusht i patjetërsueshëm që shkolla të ketë internetin.

Me futjen e internetit në shkolla, mësimitdhënësit dhe nxënësit kanë në dispozicionin e tyre një instrument, i cili kombinon të gjitha avantazhet e ndihmave audiovizuale, duke qenë burimi kryesor i të gjitha llojeve të informacionit (Serafinova, 2014: 189).

Interneti shërben:

- Për të zhvilluar dhe për të përmirësuar aftësitë e të dëgjuarit;
  - Për të përmirësuar aftësitë e monologut dhe dialogut;
  - Për të përmirësuar aftësitë e të shkruarit;
  - Për të zgjeruar fjalorin aktiv dhe pasiv me njësitë gjuhësore bashkëkohore;
  - Për të siguruar më shpejt informacionin e ri;
  - Për të mësuar gjuhët e huaja;
  - Për të racionalizuar kohën;
  - Për të mësuar nga distanca;
  - Për përpunimin elektronik të të dhënave;
  - Për të shkarkuar materiale të nevojshme shkollore, me shumëllojshmëri të gjerë të materialeve referuese, si fjalorë online, enciklopeditë-e etj.
- (Serafinova, 2014: 189).

Nëse shkolla ka pranuar një detyrë të rëndë dhe të shenjtë, se si t'i mësojë nxënësit, atëherë ajo patjetër duhet të punojë edhe në drejtimin se si të sjellë informata të reja, të shpejta, të nevojshme dhe konkrete për nxënësit (Vilotijevič, 2000: 13).

Shkolla e së ardhmes, mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve u mundëson që bashkërisht të punojnë në zgjidhjen e problemeve mësimore.

Interneti në mësim mund të përdoret për të vjelë informacione tekstuale, ilustrime dhe materiale të tjera pamore (dokumente të shkruara, fotografi, filma mësimorë, filma shkencorë, artistikë etj., që do t'u shërbenin nxënësve për nxënie të pavarur dhe vetarsimim permanent. Për të arritur këtë objektiv kaq të rëndësishme të mësimin bashkëkohor, nxënësit trajnohen të përdorin teknikën kompjuterike, pra internetin, në klasën elektronike, të udhëhequr nga mësimdhënësi i lëndës (Brada, 2010: 199).

Të tëra këto masa nuk do të ishin të suksesshme, nëse ne nuk do t'i edukonim të rinjtë në këtë frymë dhe nuk do t'i aftësonim me shkathtësi të duhura për të përdorur kompjuterët, internetin, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në mënyrën më të drejtë të mundshme.

Shkollat që zbatojnë aftësimin esencial në fushën e informatikës, janë shkollat cilësore që dinë mirë se nga po shkojnë dhe këto shkolla arrijnë më shpejt të shndërrohen në shkolla të së nesërme.

Arsimi në Evropë është duke bërë të mundur zhvillimin e kompetencave të mësuesve për stimulimin dhe angazhimin e tyre në të mësuarit gjatë karrierës, duke vlerësuar zhvillimin e tyre që ofrojnë mundësitë e duhura dhe relevante të mësimin për të gjithë mësuesit e së ardhmes (Komisioni Evropian, 2014: 43).

Një mobilizim i përgjithshëm i shkollës, së bashku me prindërit dhe komunitetin lokal, duk u angazhuar në ndërtimin e elasticitetit në të gjitha aspektet e jetës shkollore, do të ndihmojnë për të krijuar një kontekst mbështetës në arritjen e rezultateve më të favorshme për shkollën e së ardhmes (Cefai & Cavioni 2013; Greenberg et al, 2003; Weare & Nind, 2011).

Interneti është një revolucion i madh elektronik i kohës, i cili në njëfarë mënyre e ka përshkuar botën me rrjetin e vet të fortë të një “merimange gjigante”, andaj, deshëm apo nuk deshëm, mund të jemi brenda atij rrjeti, përndryshe do të na shkelë koha dhe asnjëherë nuk do të mund të arrijmë hapin e duhur.

## **2.9. Vështrim historik i inovacioneve mësimore në shkollat fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës**

Është vështirë të vërtetohet me saktësi se kur u themeluan shkollat e para dhe sistemi i arsimit në trevat shqiptare, por me rëndësi është se format e para të mësimin në institucione arsimore, shënohen qysh në kohën e Ilirisë së lashtë, në shekullin III para erës sonë (<http://www.germ-a.com/?p=1921>).

Në këto shkolla, fëmijët (djemtë), nga mosha 7 – 11 vjeç, vijonin edukimin dhe arsimimin në shkollat fillore (gramatikore), të cilat ishin private (<http://www.germ-a.com/?p=1921>).

Historia e çdo populli, pra edhe e shqiptarëve, është e gërshetuar me zhvillimin e jetës kulturo-arsimore, e cila jo vetëm që është produkt i kushteve të caktuara shoqërore-historike, por është edhe faktor me rëndësi për njohjen dhe përparimin

material e shpirtëror të një bashkësie të caktuar shoqërore të njerëzve (Rexhepagiq, 1970: 5).

Në vitin 1909, me përpjekje të përbashkëta të klubeve shqiptare dhe të patriotëve të Kosovës, u hapën disa shkolla kombëtare shqipe në Regjionin e Anamoravës së Kosovës e më gjerë, si p.sh.: Shkolla shqipe e Gjilanit, me mësuesin Adem Efendiun; Shkolla shqipe e Pozhoranit, me mësuesin Nezir Baki Efendiun (Veseli, 2003b: 95). Në të njëjtën kohë, nga Gjilani, Hasan Prishtina i dërgoi 5 nxënës të varfër për shkollim në Shkollën Normale të Elbasanit, si: Shyqëri Malushi, Qamil Zeneli, Nevzat Sherifi dhe Said Ademi (Veseli, 2003b: 98).

Shkolla shqipe në Kosovë ka një të kaluar mjaft të hidhur, duke u ballafaquar vazhdimisht me armiq të shumtë për ekzistencën apo mosekzistencën e saj.

Populli shqiptarë i Kosovës, në periudhën e okupimit nga Austro-Hungaria të viteve 1915–1918, për herë të parë pati mundësinë që legalisht të hapë shkolla në gjuhën shqipe, ngase gjatë sundimit shekullor, Perandoria Osmane asnjëherë nuk lejoi hapjen e shkollave shqipe (Shatri, 2006: 13). Ato shkolla ishin publike, punonin me plane dhe programe unike mësimore, me tekste në gjuhën shqipe dhe financoheshin nga Austro-Hungaria. Shkolla të tilla shqipe u çelën kryesisht në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Kosovën Perëndimore, në rrethinën e Prizrenit, në Gjakovë, Pejë, Istog, Skenderaj, Mitrovicë dhe në Vushtrri me rrethinë. Këto shkolla punuan për tre vjet, prej klasës së parë deri në klasën e pestë. Kurse në regjionin e Anamoravës së Kosovës, sa i përket hapjes së shkollave shqipe, pothuajse nuk pati asnjë të tillë (Shatri, 2006: 16).

Kjo ishte një periudhë shumë e vështirë për shkollat shqipe të asaj kohe, ngase në vitet 1915–1918 Kosova ishte e ndarë në dy zona, zona okupuese Austro-hungareze dhe zona tjetër bullgare. Nën okupimin e zonës bullgare, përpos shumë qyteteve të tjera,

përfshihej edhe regjioni i Anamoravës së Kosovës (Grup autorësh, 2003: 136), ku të drejtat për shkollim në gjuhën shqipe ishin rreptësisht të ndaluara.

Në këtë kohë, tekstet e para shkollore në gjuhën shqipe ishin të shkruara nga emigrantët shqiptarë që jetonin dhe vepronin jashtë Shqipërisë. Gjatë viteve 1916-1918 u përdorën tekste të hartuara dhe të botuara në Austri, të cilat nuk përkonin me historinë dhe traditën shqiptare. Gjatë periudhës 1919-1940, tekstet shkollore në gjuhën shqipe u ndaluan plotësisht dhe nxënësit shqiptarë në shkollën fillore mësonin sipas teksteve serbe, të botuara në Beograd, të cilat fare pak i kuptonin dhe ishin me përmbajtje fyese për shqiptarët (Shatri, 2006: 17).

Një gjendje e tillë mbeti deri në Luftën e Dytë Botërore, kur u krijuan kushte dhe rrethana të reja më të favorshme për zhvillimin e arsimit dhe të shkollës shqipe (Ukaj, 2006: 31).

Nga Lufta e Dytë Botërore, në shkollat shqipe në Kosovë, si risi ishte përdorimi i teksteve të hartuara nga Shqipëria, porse, fatkeqësisht, jeta e tyre qe e shkurtër, ngase në vitin 1948 pushteti jugosllav i ndaloi të gjitha këto tekste.

Është shumë e rëndësishme të ceket se në historinë e arsimit dhe shkollimit në ish-Jugosllavi, më së shumti mungesë të arsimit të të rinjve ka pësuar populli shqiptar në të gjitha trevat etnike, si: në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi Jugore.

Nga të gjithë popujt dhe pakicat kombëtare, që kanë jetuar në Jugosllavi midis dy luftërave botërore, shqiptarët e Kosovës nuk i kishin shkollat e tyre në gjuhën amtare, nuk kishin të drejtë të përdornin gjuhën në komunikim zyrtar, nuk gëzonin të drejtën e veprimtarisë botuese në gjuhën shqipe, të drejtën e kulturës nacionale, individuale etj. E njëjta gjë ishte edhe në zonën e Anamoravës, ngase qëllimi i Serbisë ishte që shqiptarët

të mos shkolloheshin dhe atyre të mos u jepej asnjë e drejtë, sepse kishin frikën që ata dikur do të vetëdijesheshin dhe do ta ngrinin zërin për padrejtësitë që u bëheshin.

Në vitet e para të shkollës shqipe në mënyrë institucionale, mungonte lokali shkollor, çka ndikonte ndjeshëm në zhvillimin dhe suksesin e procesit mësimor (Ukaj, 2006: 39). Në mungesë të lokaleve shkollore, procesi mësimor organizohej në shtëpi private, në lokalet e kooperativave bujqësore apo në kazermat ushtarake të boshatisura, të cilat nuk kishin as kushte elementare për mësim (Po aty: 39).

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, mësuesit e shkollave shqipe në Kosovë ishin kryesisht nga Shqipëria, të cilët kishin mbaruar njëri nga shkollat normale, apo edhe shkolla të tjera të mesme. Këta mësues, edhe pse punonin në Kosovë, financoheshin nga Shqipëria, duke jetuar e duke punuar në kushte shumë të vështira (Shatri, 2006: 21).

Për herë të parë, përgatitja dhe ngritja profesionale e mësuesve në gjuhën shqipe në Kosovë, filloi në shkollën normale “Sami Frashëri” të Prishtinës, e hapur në vitin 1941. Kjo shkollë ishte një lloj universiteti për arsimin kosovar, sepse për herë të parë mësuesit shqiptarë në Kosovë, patën mundësi të njiheshin me metodologjinë bashkëkohore të mësimdhënies. Më pas, shkolla të tjera normale u hapën në Mitrovicë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Gjilan dhe Ferizaj e kështu më vonë u hapën edhe në shumë qytete të tjera të Kosovës. Ndërsa përgatitja e mësimdhënësve të mësimit lëndor fillon që nga viti 1958, kur për herë të parë hapet SHLP-ja (Shkolla e Lartë Pedagogjike) në Prishtinë (Shatri, 2006: 22). Ndërsa, për herë të parë në vitet shtatëdhjetë fillojnë të botohen tekste në gjuhën shqipe nga autorë shqiptarë (Po aty: 22).

Sikurse në pjesët e tjera të Kosovës, ashtu edhe në Regjionin e Anamoravës, arsimi shqip kishte mungesë të madhe të mjeteve mësimore. Kjo ishte një kohë shumë e

vështirë për shqiptarët, por falë atdhetarëve dhe arsimdashësve të asaj kohe, shqiptarët e Kosovës hapën dyert e odave dhe të shtëpive me qëllim të mosndërprerjes së mësimi.

Në mungesë të mjeteve të konkretizimit në objektet shkollore të Anamoravës së Kosovës, nga lënda e matematikës përdorehin kokrrat e misrit, të fasules etj., kurse nga mësimi i gjuhës shqipe, në shkollat urbane ndoshta sigurohej ndonjë abetare, e në zonat rurale, pothuajse abetarja mungonte tërësisht. Si mjet pune përdorej tabela e punuar nga materiali i thjeshtë prej druri (B. Mujaj, komunikim personal, nëntor, 2001).

Në shkollat serbe investohej si me mësues të kualifikuar, ashtu edhe me mjete mësimore, të cilat përgatiteshin dhe silleshin nga Beogradi, ndërsa atyre pak shkollave shqipe që ishin, mjetet u mungonin pothuajse tërësisht, por edhe ato pak mjete që ishin, kishin pretendime serbe, si libri i historisë kombëtare serbe, libri i gjuhës shqipe me autorë serbë, harta të përpiluara me vendbanime serbe etj. Pra, këto ishin “risitë” e asaj periudhe, me të cilat ndesheshin mësimdhënësit dhe nxënësit shqiptarë në zonën e Anamoravës dhe në tërë Kosovën (B. Mujaj, komunikim personal, nëntor, 2001).

Kontribut të madh për fillimin e punës së shkollës shqipe në Kosovë në prill të vitit 1941 dha pa dyshim “Komiteti i Kosovës” në organizimin e administratës shqiptare në hapjen e kurseve shkollore ditë e natë (Veseli, 2003: 16). Secila shkollë fillore ishte e detyruar t'i themelonte kurset e ditës dhe të mbrëmjes për analfabetët e dy gjinive dhe për nxënësit e moshuar (Veseli, 2003: 19).

Me qëllim të hapjes dhe rihapjes së shkollave fillore në gjuhën shqipe në Kosovë, në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, ministri i arsimit i atëhershëm i Qeverisë së Shqipërisë, Ernest Koliqi, dërgoi 300 mësues nga Shqipëria në Kosovë. Mësuesit e ardhur nga Shqipëria ishin të rinj dhe shumica e tyre pa përvojë. Kushtet e punës ishin shumë të vështira, sepse mungonte çdo gjë, mungonte lokali mësimor,

inventari, tekstet shkollore, mungonin orenditë dhe mjetet didaktike, të cilat gjatë luftës ishin djegur dhe plaçkitur (Veseli, 2003: 27).

Hapjes së shkollës shqipe i parapriu edhe aktiviteti arsimor i mësimit të leximshkrimit të gjuhës shqipe nëpërmjet kurseve verore tremujore gjatë verës së vitit 1941, ku këtë kurs ndjekin rreth 15300 të rritur dhe 12500 nxënës të shkollave fillore (Veseli, 2003: 136).

Si “inovacion” i asaj kohe, në vitin shkollor 1941-1942, vetëm disa javë para se të fillonte punën shkolla shqipe në Kosovë, dolën nga shtypi 37 tekste mësimore për shkollat fillore e të mesme me përmbajtje shkencore dhe kombëtare (Veseli, 2003a: 289).

Për të dhënë kontributin e tyre kombëtar, më 26 nëntor 1941 mësuesja Elefterie Çekaj dhe bashkëshorti i saj, mësuesi Isuf Çekaj nga Qarku i Dibrës, me vetëdëshirë ishin dërguar në Gjilan për të mbajtur mësim me klasën I/A dhe klasën I/B. Ata shkonin shtëpi për shtëpi për t'i regjistruar nxënësit. Që të dy kishin rregulluar ambientin e shkollës fillore “Bogdani” në Gjilan, duke i mbyllur dritaret me letër, ngase mungonin xhamat, përderisa dita e 8 dhjetorit 1941 për gjilanasit ishte një risi, ngase ishte dita e parë e fillimit të mësimit të Abetares Shqipe për Gjilanin me rrethinë (Veseli, 2003b: 113). Kjo shkollë kishte punuar deri më 26 qershor 1943, kur prefektura e Gjilanit kishte mbyllur shkollën duke e kthyer atë në kazermë ushtarake (Veseli, 2003b: 173).

Më 20 nëntor 1942 në “Fletoren Zyrtare” ishte shpallur lista e mësuesve të emëruar në shkollat e Kosovës. Mësuesit e emëruar në shkollat e regjionit të Anamoravës së Kosovës ishin në 5 shkollat nga komuna e Gjilanit (dy në Gjilan, një në Livoç, një në Kmetofc dhe një Bresalc); Në komunën e Kamenicës 4 shkolla (Hogosht,



Desivojcë, Strezovc, Koretin); Në komunën e Vitisë, tri shkolla (Sllatinë e Epërme, Cernicë, Pozhoran) (Shatri, 2006: 53).

Në këtë periudhë kohore, një ndër patriotët, atdhetarët, oratorët e mjeshtrit e penës të Anamoravës së Kosovës, që ka kontribuar në edukimin e popullit si fetar, duke u nisur nga disa parime kuranore, që përcaktonin vlerat e arsimit të kulturës dhe të edukatës, është Mulla Idriz Gjilani, kur thotë : “Pa shkollim nuk ka as fe të mirëfilltë”; “Nxënësit tanë nuk duhet të mësojnë më vetëm për leximin e Kuranit, por edhe për njohjen e mjeshtërisë së shkrimit”; Të mësojmë “të ndihmojmë njëri-tjetrin me fjalë, me penë, me pasuri, të duhemi si vëllezër” ([https://sq.wikipedia.org/wiki/Idriz\\_Gjilani](https://sq.wikipedia.org/wiki/Idriz_Gjilani)).

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, arsimi në Kosovë filloi të riorganizohet në parime të reja socialiste. Gjendja e trashëguar ekonomike dhe politike për popullatën e saj ishte tejet e rëndë. Në Kosovë nuk kishte ngelur gati asgjë, duke u djegur dhe shkatërruar shumë objekte shkollore dhe mbi 90% e popullatës së Kosovës ishte analfabete (Hadri, 1971: 60).

Sikurse në pjesët e tjera të Kosovës, ashtu edhe në regjionin e Anamoravës, mungesa e lokalit për mësim ishte ndër problemet kyçe (Ukaj, 2006: 119). Edhe ato pak objekte shkollore që ekzistonin, gjatë luftës ishin shkatërruar, ndërkohë që disa shtëpi private u shndërruan në lokale mësimi. Veç shtëpive, populli dhuroi edhe troje falas për ngritjen e objekteve shkollore, ndërsa objektet ku mbahej mësimi në të shumtën e rasteve nuk kishin kurrfarë kushtesh për mësimdhënie, ishin me dritare të vogla, pa dritë të mjaftueshme e shumë prej tyre e lëshonin edhe pikën e ujit (Ukaj, 2006: 119).

Më 30 tetor 1945 është nxjerrë “Ligji mbi shkollimin e obligueshëm fillor shtatëvjeçar”. Deri në këtë vit shkolla kishte vetëm 5 klasa. Në këtë ligj përcaktohet

futja e shkollimit fillor shtatëvjeçar për fëmijët e të dy gjinive, duke filluar nga mosha 7-vjeçare deri në moshën 15-vjeçare (Shatri, 2006: 61).

Shkollat fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës, ishin mjaft të varfra, si në ndërtim ashtu edhe për sa u përket mjeteve mësimore. Sipas mësuesve të vjetër të kësaj zone, në shkollën fillore “Kika” në Hogosht, nxënësit uleshin në dërrasa, kurse me ndërtimin e shkollës së re, më 1965, i sollën disa banka, të cilat ishin të palëvizshme, duke qenë të ngjitura me karrige, që për atë kohë ishte risi për shkollat e kësaj ane (Xh. Mujaj, komunikim personal, 11 prill 2016). Tabelat ishin shumë të papërshtatshme për të shkruar, kurse si mjet shkrimi në tabelë përdorehin disa lloje shkumësash, por ishin mjaft të kufizuar. Ndërsa për ta pastruar tabelën, nxënësit merrnin nga shtëpia ndonjë sfungjer të vjetër. Nga lënda e edukatës fizike kishte vetëm një top, i cili ruhej dhe përdorej mjaft me kujdes. Zilja e shkollës nuk ishte elektrike, por ajo ishte fizike dhe përdorej nga punëtorët ndihmës të shkollës, duke e shkundur atë me forcën e krahut (Xh. Mujaj, komunikim personal, 11 prill 2016).

Në mungesë të lokaleve shkollore, gati gjysma e nxënësve procesin mësimor e mbanin në shtëpi private dhe në ndërtesa të organizatave të tjera, si në kooperativa bujqësore, kazerma ushtarake etj., të cilave pothuajse u mungonin tërësisht mjetet mësimore (Shatri, 2006: 64).

Në vend të mjeteve didaktike, si inovacione mësimore të asaj kohe, gjatë mësimdhënies përdorehin shkopinjë, kartoni, kokrrat e misrit dhe të fasules, fjetet e shkrepëses, mella dhe shumë mjete të tjera improvizuese, përmes të cilave mësimdhënësit bënë konkretizimin e mësimimit (Xh. Ahmetaj, komunikim personal, 15 qershor 2016).

Në vitin shkollor 1946/1947, në disa qytete të Kosovës, po edhe në Gjiilan, u hapën gjimnaze të ulëta trevjeçare, të cilat pas vitit 1948 shkrihen në shkolla fillore. Këto lloj gjimnazesh, si shkalla e dytë e shkollimit, kanë zgjatur deri në vitin 1952, kur bëhet reforma e arsimit fillor dhe shkolla fillore bëhet tetëklasëshe dhe e obligueshme, ndryshe nga ajo shtatëvjeçare, që ishte deri në këtë kohë (Shatri, 2006: 65).

Në këtë kohë, objektet shkollore filluan të rinovohen dhe klasat të pasurohen me tabela të reja dhe me mjete didaktike, edhe pse nuk ishin të mjaftueshme, por për mësimdhënësit dhe nxënësit ato ishin inovacion dhe dukej se diçka kishte filluar të lëvizte për së mbari.

Në pjesën e dytë të viteve gjashtëdhjetë, populli shqiptar i Kosovës lirohet nga përndjekjet barbare të pushtetit serb për kërkimin e armëve dhe fillojnë të hapen shkollat e mesme në të gjitha qendrat e mëdha komunale. Në mesin e vendeve ku u hapën këto shkolla ishte edhe Gjiilani, ndërsa rrjeti i shkollave fillore filloi të shtrihej me të madhe edhe nëpër fshatra, por, fatkeqësisht, planet dhe programet mësimore, tekstat shkollore etj., ende miratoheshin nga Serbia (Shatri, 2006: 72).

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1963, autonomia e Kosovës erdhi duke u avancuar dhe në këtë periudhë, përpos që numri i nxënësve shqiptarë filloi të rritej në shkollat fillore, ajo ndikoi pozitivisht edhe në ngritjen, zgjerimin dhe shtrirjen e rrjetit shkollor në të gjitha nivelet e shkollimit, duke u shtuar numri i shkollave fillore, të mesme, shkollave të larta dhe fakulteteve (Shatri, 2006: 73).

Në vitet 1974 – 1980 ishte një rilindje e shkollave shqipe në Kosovë, duke filluar nga e drejta e administrimit të arsimit, shtimi i strukturës kualifikuese të mësimdhënësve, krijimit të kushteve më të mira politike dhe ekonomike (Shatri, 2006: 74).

Kjo ishte mjaft e mirë për shkollat shqipe, si në rritjen e numrit të nxënësve, kualifikimin e mësimitdhënësve, ndërtimin e objekteve shkollore dhe përsosjen e mjeteve mësimore, duke kaluar prej mjeteve të improvizuara në mjete didaktike bashkëkohore, si në pasurimin e shkollave me kabinete mësimore, si: kabineti nga lënda e MPP (Mbrojtja e Përgjithshme Popullore), kabineti i biologjisë, kabineti i kimisë, kabineti i BAT-it (Bazat e Arsimit Politeknik), pasurimi i tyre me mjete konkretizimi, si grafoskop dhe kinoprojektor, pasurimi i klasave me mjete mësimore, si: me tabela magnetike, mjete mësimore nga lënda e matematikës (treëndësja, vizore, këndmatës, numëratore etj.), nga lënda e gjeografisë: harta, globi dhe atlase, nga lënda e gjuhës shqipe: shkronjat lëvizëse, fotografi, teli për formimin e shkronjave, tabela rrëshqitëse etj., kështu që mësimitdhënësia filloi të jetë më cilësore, duke arritur edhe rezultate më të mira tek nxënësit. Pra, shkollat shqipe në Kosovë patën fatin që të pasurohen me mjete të reja mësimore (K. Zylfiu, L. Sylaj, komunikim personal, 11 tetor, 2010).

Prej viteve '70 deri në vitet '80, vërehej një demokratizim i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet. Filluan punën edhe shkollat e mesme profesionale, por prapë nuk investohej mjaftueshëm në cilësinë e mësimitdhënies, ngase shumica e buxhetit arsimor u dedikohej vetëm pagave.

Pas vitit 1970, sistemi i arsimit depolitizohet në një masë të madhe dhe planprogramet arsimore zhvilloheshin nga ekspertët kosovarë. Por, fatkeqësisht, e gjithë kjo zgjati deri në vitin 1989, kur Serbia i mori me dhunë të gjitha të drejtat e hartimit të ligjeve të arsimit të Kosovës ([https://sq.wikibooks.org/wiki/Kolonizimi\\_Serb\\_i\\_Kosov%C3%ABs/13](https://sq.wikibooks.org/wiki/Kolonizimi_Serb_i_Kosov%C3%ABs/13)).

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1989, Serbia krijoi kushte juridike dhe policore në Kosovë për rrënimin total të sistemit të arsimit në gjuhën shqipe. Masat e

ndërmarrja ishin të ndryshme, si heqja e drejtorëve shqiptarë dhe zëvendësimi i tyre me drejtorë serbë; futja e masave të dhunshme administrative në institucionet e arsimit dhe dëbimi i nxënësve shqiptarë nga objektet shkollore në mjediset serbe apo të përziera (Shatri, 2006: 109).

Në mars të vitit 1989, fillon helmimi i nxënësve shqiptarë të shkollave të mesme, ndërsa propaganda serbe këtë akt para ndërkombëtarëve e quajti aktrim, kurse në anën tjetër vazhdonte pandërprerë me helmimin e nxënësve shqiptarë, me qëllim të frikësimit të tyre për t'i larguar nga shkollat (Shatri, 2006: 136).

Kjo ishte një periudhë shumë e vështirë për popullin shqiptar të regjionit të Anamoravës dhe tërë Kosovës. Sikurse drejtorët, po edhe mësimdhënësit shqiptarë, filluan të merreshin në “biseda informative”, ndaj të cilëve zbatoheshin dhunë psikofizike, me qëllim që në shkollat shqipe të zbatoheshin plani dhe programi mësimor serb. Këtë vendim, shqiptarët nuk mund ta pranonin dhe u detyruan që, krahas institucioneve të dhunshme serbe, të krijonin institucionet e tyre të pavarura të arsimit.

Viti 1990 ishte fillimi i ndarjes dhe i pavarësisht të Arsimit të Kosovës, vit ky kur për herë të parë në historinë e arsimit, planet dhe programet mësimore u hartuan nga ekspertët shqiptarë dhe definitivisht shkollat u ndanë sipas përkatësisë kombëtare, pra shkollat shqipe u ndanë nga ato serbe (Shatri, 2006: 139).

Në komunën e Gjilanit, gjendja e mësimit shqip nuk ishte aspak më e mirë sesa në pjesët e tjera të Kosovës. Në Gjilan dhe rrethinë drejtorët shqiptarë të shkollave shqipe filluan të zëvendësoheshin me drejtorë të dhunshëm serbë, duke filluar në Zhegër, Cernicë e kështu vazhdoi pothuajse në shumicën e shkollave shqipe të Gjilanit (Shatri, 2006: 139).

Në komunën e Kamenicës vetëm në dy shkolla u aplikuan masat e dhunshme, në Kamenicë dhe Strezovc, por mësimdhënësit dhe nxënësit shqiptarë nuk e ndërprejnë aktivitetin e tyre mësimor, pa marrë parasysh dhunën që ushtrohej ndaj tyre për ta vazhduar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies deri në momentin kur ishte gjendje lufte (Shatri, 2006: 123). Rrjedhën e vërtetë të kësaj periudhe në fushë të arsimit, shumë mirë e vërtetojnë edhe mësuesit e komunës së Kamenicës, siç janë: Xhemush Mujaj, Maksut Zylfiu, Kadrush Zylfiu, Sylejmon Ahmeti, Xhemush Sermaxhaj, Hisen Kërçeli etj.

Edhe në komunën e Vitisë ishte e njëjta gjendje për shkollat shqipe, edhe aty u zbatuan masa të dhunshme në shkollat fillore dhe të mesme, si në: Viti, Pozhoran, Goshicë, Verbovc dhe Tërpezë.

Shkollat e boshatisura nga nxënësit dhe mësimdhënësit shqiptarë, pothuajse ishin në një gjendje tmerruese, ato ishin plaçkitur dhe ishin shkatërruar nga serbët. Kurse, shtëpitë-shkolla, ku ishin detyruar të bartohej nxënësit dhe mësimdhënësit shqiptarë, pothuajse nuk kishin as kushte elementare për mësimdhënie, duke u munguar gjithçka e nevojshme, si: tabelat, shkumësat, bankat, karriget e, në disa shtëpi, kishte raste kur nxënësit uleshin edhe në dyshe. Në këtë periudhë mungonin edhe tekstet shkollore, kështu që nxënësit ishin të detyruar të merrnin shënime nga mësimdhënësit. Ato pak mjete që ishin, nxënësit i sillnin nga shtëpitë e tyre, ndërsa mësimdhënësit, kur donin të praktikonin ndonjë veprimtari mësimore, bënin improvizime, përderisa të ardhurat mësimdhënësve shqiptarë u ishin ndaluar krejtësisht, bashkë me gjitha shpenzimet e tjera materiale për nevoja të shkollave.

Kështu zgjati deri në kohën kur Kosova formoi qeverinë e saj në ekzil (jashtë Kosovës) dhe nga një kontribut prej 3% të pagave mujore të bashkatdhetarëve tanë, që

jetonin dhe punonin jashtë Kosovës, si dhe të atyre që jetonin në Kosovë, filloi të ndihmohej shkolla shqipe në Kosovë, duke u siguruar mësimdhënësve nga një pagë minimale dhe duke sjellë nga jashtë edhe mjete didaktike për disa shkolla.

Rikthimi i ndikimit të politikës në arsim, humbja e orientimit arsimor të institucioneve, ndjekja dhe përjashtimi nga puna i ekspertëve dhe mësimdhënësve, zbatimi i politikës antiarsimore dhe antinjerëzore të pushtetit serb, fatkeqësisht shënon një periudhë shumë të vështirë kohore për arsimin shqiptar të regjionit të Anamoravës së Kosovës, por mësimdhënësit shqiptarë, pa marrë parasysh dhunën që ushtrohej ndaj tyre, ata asnjëherë nuk u dorëzuan dhe në vazhdimësi dhanë kontributin e tyre për shkollën shqipe.

## **2.10. Gjendja aktuale e mësimdhënies në shkollat fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës**

Shkollat e Kosovës, të sapodala nga lufta e fundit, në vitin 2000 ballafaqoheshin me vështirësi e sfida të ndryshme. Autoritetet vendore dhe IAK-të (Institucionet e Arsimit Kosovar) shtruan nevojën e reformimit të plotë të sistemit arsimor parauniversitar. Në periudhën e pasçlirimit, kërkesat e tregut të punës dhe vetë synimet e shoqërisë për demokratizimin dhe ndryshimin e shkollës, shtruan nevojën për edukimin dhe formimin e cilësive të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Ideja dhe synimi i shoqërisë kosovare ishte që përmes reformimit të sistemit arsimor, të rritet efikasiteti i mësimdhënies dhe, si rrjedhojë, të rriteshin rezultatet dhe cilësia e mësimnxënies.

MASHT-i (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë), për reformimin e arsimit parauniversitar ka bërë ndryshime të shumta, duke hartuar infrastrukturë ligjore që mbështet zhvillimin e një arsimit bashkëkohor e demokratik, të cilat në Regjionin e Anamoravës së Kosovës, vëreheshin dita-ditës, si në ndërtimin e objekteve shkollore, pasurimin e tyre me mjete mësimore, hartimin e teksteve shkollore me standarde bashkëkohore, trajnimin e mësimitdhënësve për t'iu përshtatur mësimitdhënies bashkëkohore në funksion të reformimit e demokratizimit të arsimit parauniversitar me qëllim të zbatimit të programeve e projekteve inovatore.

Arsimi kosovar tani merr frymë më ndryshe, në krahasim me të kaluarën. Gjendja e tanishme e shkollave shqipe në Kosovë, në krahasim me të kaluarën, është shumë më e mirë.

Pas luftës së fundit, apo në fillim të shekullit XXI, u siguroa një numër mjaft i madh i mjeteve mësimore për organizimin dhe realizimin e veprimtarisë edukativo-arsimore në shkolla dhe në institucione të tjera që merren me edukimin dhe arsimin e të rinjve. Karakteristikë e përgjithshme e këtij grupi të mjeteve mësimore është demonstrimi fare i thjeshtë dhe ilustrimi që dëshirojmë t'ua bëjmë objekteve, dukurive dhe ligjshmërive që ekzistojnë në natyrë dhe shoqëri, me qëllim që mësimitdhënësia ta rrisë cilësinë e saj, ndërsa nxënësit të arrijnë rezultate më të mira në shkollë

Në disa shkolla të regjionit të Anamoravës, mësimitdhënësit e trajnuar kanë gjetur një mjedis e klimë të përshtatshme për punë dhe kanë përmirësuar dukshëm mësimitdhënien e tyre. Në këto mjedise shkollore, fryma e reformës ndihet në të gjitha aspektet e funksionimit (Q. Neziri, komunikim personal, 12 shkurt 2016).

Mjetet mësimore, që u siguruan kohët e fundit, kanë qenë të orientuara që të kapërcehet rigoroziteti i sistemit të vjetër të arsimit, të modernizohet sistemi i tanishëm i



arsimit me inovacione mësimore dhe të përparohet në format dhe metodat e punës me qëllim për t'iu përshtatur interesave të nxënësve (Xh. Lulleci, komunikim personal, 9 shkurt 2016).

Sipas informacioneve të këshilltarëve pedagogjikë të regjionit të Gjilanit, aktualisht shumica e shkollave fillore të kësaj zone, për vitin 2015-2016, janë mjaft të pasura me inovacione mësimore, si me teknikë dhe teknologji të re të mësimore, por, fatkeqësisht, ato përdoren pak dhe zbatohen në mënyrë jo të organizuar sa duhet. Është e sigurt se disa prej mësimdhënësve nuk e njohin mirë funksionin dhe fuqinë pedagogjike të mjeteve inovative, andaj për këtë arsye, disa prej tyre bëjnë rezistencë ndaj tyre dhe vështirë vendosin t'i zbatojnë ato në procesin e mësimdhënies, edhe pse inovacionet mësimore ndihmojnë në rrjedhat dhe rezultatet e veprimtarisë mësimore, zgjerojnë burimet e njohurive dhe imponojnë forma të reja të mësimdhënies e mësimnxënies (Komunikim personal me disa mësues të komunës së Kamenicës, 13 prill 2016).

*“Mesazhi është që shkollat tona të japin mësim në proceset e të nxënësve, që i përshtaten më mirë mënyrës se si po zhvillohet puna. Para se gjithash, kjo do të thotë të japësh mësim me aftësitë dhe shprehjet e mendjes, që janë thelbësore për zgjidhjen e problemeve, sidomos aty ku shumë mendje ndërveprojnë me njëra-tjetrën” (Fullan, 2010: 21).*

### **2.11. Demokratizimi i mëtejshëm i mësimdhënësve dhe mësimdhënies**

Shumë ekspertë të edukimit, të njohur në këtë fushë, e qendërzuan vëmendjen në demokratizimin e shkollës. Në këtë rast do ta veçojmë Rudolf Dreikursin, i cili njihet si autor i filozofisë për një të mësuar demokratik, ku qëllimi i tij ishte të ndërtohej një klasë demokratike, e së bashku me të, një stil demokratik në mësimdhënie (Krasniqi & Deva-Zuna: 2012: 248).

Zhvillimi, ndryshimi dhe përparimi i mësimdhënësve dhe mësimdhënies, asnjëherë nuk ka pasur të ndalur, nuk ka dhe kurrë nuk do të ndalet së kërkuari gjetjen e metodave dhe formave të përshtatshme dhe më të avancuara të përsosjes së mësimdhënies, në mënyrë që rezultatet tek nxënësit të jenë gjithnjë e më të mira.

Demokratizim në arsim nënkupton kapërcimin e të gjitha pengesave në realizimin e të drejtave në arsim, duke qenë kundër diskriminimit si në gjuhë, kulturë, racë, nacionalitet etj. (Rexhepagiq, 2008: 55). “Pikërisht barazia ndërmjet qenieve njerëzore e pamundëson diskriminimin në çfarëdo baze qoftë” (Mazreku, 2015: 130). Kjo do të thotë se të drejtat e fëmijëve në shkollë për të nxënë dije, çdoherë duhet të jenë të barabarta për të gjithë fëmijët e botës, pa dallime nacionale, gjuhësore, kulturore, racore, fetare, gjinore, sociale etj.

Lidhur me këtë dëshmon edhe Konventa Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës, që garanton shanse të barabarta për edukim të të gjithë fëmijëve. Kjo është e saktësuar në nenin 28, në të cilin thuhet: “Çdo fëmijë ka të drejtë të shkojë në shkollë dhe të edukohet. Të gjithë fëmijët të kenë mundësi të barabarta për t`u shkolluar” (UNICEF, 2007: 23).

Thelbi i klasës demokratike qëndron në respektimin e diversitetit midis nxënësve dhe respektimin e karakteristikave individuale (Krasniqi & Deva-Zuna, 2012: 248).

Demokratizim i mësimdhënësve dhe mësimdhënies, nuk do të thotë vetëm të respektosh të drejtat e nxënësve në shkollë, por demokratizim i mëtejshëm është edhe përfshirja aktive e nxënësit në planifikimin e mësimi apo në organizimin e veprimtarive të ndryshme gjatë mësimi, duke e bërë mësimin më interesant, duke lehtësuar ndërtimin e dijeve të nxënësve dhe duke i shtyrë ata të reflektojnë për nevojat e tyre (Rosen & et al, 2010).

Demokratizimi i arsimit është një ndër parimet themelore në arsim, me qëllim për t'i respektuar njëjtë të drejtat e fëmijëve në shkollë, duke llogaritur si element kryesor në zhvillimin e shoqërisë demokratike. Por, fatkeqësisht, "Demokracia ende nuk është plotësisht e përhapur në tërë planetin, sepse ende ekzistojnë diktaturat dhe mbeturinat e totalitarizmit të shekullit XX, ose madje nga farat e totalitarizmave të rinj, demokracia do të jetë e rrezikuar edhe në shekullin e XXI, ngase demokracitë ekzistuese nuk janë të përsosura dhe janë të pakryera (Edgar, 2002: 122).

Arsimi, si instrument i veçantë i demokracisë, nga një institucion që vazhdimisht priten ndryshime më të mira për një të ardhme më të mirë, është që "të përgatitë njeriun e lirë" (Federiko, 1991: 101). Autori Federiko (1991) demokracinë në mënyrë direkte e lidh me arsimin dhe kulturën, duke shtuar: "Demokracia në arsim dhe në kulturë ka dy mbështetje themelore dhe kushte për realizim" (f: 149). Nga kjo mund të kuptojmë se edhe në të kaluarën, edhe tani, po edhe në të ardhmen, barrën kryesore për demokratizimin e një shoqërie e ka pasur dhe do ta ketë arsimi.

Demokratizimi i mësimdhënies, ka ndikim në përparimin e shpejtë të shoqërisë, të shkencës, teknikës dhe teknologjisë, si faktorë kryesorë që arsimi të jetë më i plotë, më i përshtatshëm dhe më i përsosur si në mësimdhënie ashtu edhe në mësimnxënie. Demokracia, sikurse në shkollë, ashtu edhe jashtë saj, "nuk e pranon stilin unik të jetës

së njerëzve, ajo lejon që secili njeri të afirmojë veten sipas prirjeve, ndjenjave dhe nevojave të veta (Mazreku, 2015: 130).

Mësimdhënia demokratike nuk bën dallime në klasë gjatë vlerësimit, të pyeturit, apo njërit nxënës t'i jepet përparësi e tjetrit jo. Fjala është për një mësimdhënie demokratike, e cila i mëson njëjtë të gjithë nxënësit, pa asnjë formë diskriminimi.

Përpos shumë faktorësh që dëshmojnë se mësimdhënësi do t'i respektojë të drejtat e fëmijëve në shkollë, ai duhet të krijojë metoda dhe forma demokratike në klasë, me qëllim që “mësimi të bëhet interesant për nxënësit e çdo moshe” (Kraja, 2012: 189). Ai duhet të flasë bukur dhe njëjtë për të gjithë, t'i motivojë ata dhe t'i vlerësojë për punën e tyre, e jo t'i diskriminojë ata, ngase nxënësit mund të krijojnë bindje për mësimdhënësin si njeri jo i mirë, joreal dhe i rrezikshëm.

Mësuesi i tipit demokrat, është drejtues, monitorues dhe lehtësues i punës së nxënësve në klasë (Krasniqi & Deva, 2012: 86).

Mësimdhënësi është një tip demokrat, duke qenë organizator i mirë, nxit nxënësit për punë, i përkrah ata dhe i respekton njëkohësisht. Krijon mjedis të ngrohtë në klasë, ka humor, nxit bashkëpunim, ndien vetë përgjegjësinë për gjendjen në klasë (Kraja, 2012: 21).

Pos shumë elementeve demokratike që posedon mësimdhënësi demokrat, ai mund të demokratizojë edhe përmbajtjet edukativo-arsimore, planet dhe programet mësimore, procesin e mësimdhënies etj., edhe pse demokracia ka qenë kërkesë e të gjithë mësimdhënësve dhe pedagogëve përparimtarë (Kraja, Qela, Mustafa, Kraja E., 2013: 42).

Mësimdhënësi demokrat di shumë mirë të përgatisë njeriun e nesërm të shoqërisë demokratike. Ndikon në formimin e personalitetit të njeriut demokratik për krijimin koncepteve të reja dhe vetëdijes demokratike (Kraja, Qela, Mustafa, Kraja E., 2013: 43).

## **KAPITULLI III: ROLET E MËSIMDHËNËSVE INOVATORË - MODELE TË SUKSESEVE NË MËSIMDHËNIE**

### **3.1. Rolet i mësimdhënësve inovatorë dhe ndikimi i tyre në organizimin e mësimdhënies**

Mësimdhënësit e mirë, në të shumtën e rasteve, kanë arritur që punën e tyre ta fillojnë me një përmbledhje të ideve, që lidh konceptet e reja me njohuritë e mëparshme, duke qenë të sigurt që nxënësit të kuptojnë çdo risi që u nevojitet, me një renditje të përgatitur me kujdes dhe në mënyrë logjike.

Shpeshherë nxënësit shprehin nevojë të zbulojnë vetë diçka të re përmes pamjeve, filmave, fotografive etj., të diskutojnë me njëri-tjetrin dhe të paraqesin edhe probleme me karakter krijues. Andaj, dëshira e mësimdhënësve, po edhe e nxënësve, është që t'u përshtaten nevojave që imponon koha, me qëllim që ky përparim të gjejë vend të posaçëm në fushën e arsimit (Vojka-Ismajli, 2012: 112).

Ideja që të zbatohen metoda të reja, forma dhe mjete bashkëkohore në mësim, gradualisht bën të mundshëm ndryshimin e procesit mësimor, me qëllim që të rritet efikasiteti i mësimin dhe të nxitet të menduarit kritik gjatë përvetësimit të njohurive të reja (po aty: 114).

Për nxënësit, inovacionet mësimore paraqiten jo vetëm si burim i ri i fitimit të njohurive, por edhe përfitim më i lehtë i njohurive të reja. Andaj, mësimdhënësi i mirë,

në këto raste luan gjitha rolet e mundshme në klasë, me qëllim që nxënësit të qëndrojnë aty me humor sa më të mirë. Të gjitha këto ndikojnë që mësimdhënia të ndryshojë sipas nevojës dhe kërkesës së nxënësve, duke shtuar vazhdimisht gatishmërinë e nxënësve për mësimnxënie.

Roli i mësimdhënësit në shkollat fillore është vështirë të ndryshohet, nëse nuk shfrytëzohen nga ai të gjitha strategjitë mësimore. Kur e themi këtë, jemi të sigurt se tanimë nuk jemi në kohën e shkollës tradicionale, kur si mjete të vetme kanë qenë tabela dhe shkumësi. Tani, ndërkaq, kemi një duzinë teknikash dhe teknologjish të reja mësimore, të cilave pothuajse nuk u dihet fundi.

Kur diskutohet për kurrikulën shkollore, rolin kryesor e ka mësuesi, kur flasim për programet mësimore, përsëri parësor del roli i mësuesit, kur diskutojmë për tekstin, përsëri forcë dhe jetë i jep fjala e mësuesit, po ashtu, mësuesi është ai që i zgjedh edhe metodat mësimore, për edukimin vetë mësuesi është edukator, për marrëdhëniet mësues-nxënës pikërisht mësuesi është ai që u jep tonin pozitiv atyre... Pra, mësuesi është një figurë e pazëvendësueshme, personaliteti i të cilit është i lidhur me tërë problemet mësimore edukative në shkollë (Kraja, 2012: 18).

Roli i mësimdhënësit në shkollë është shumë i madh, duke u nisur nga ndryshimet në plane dhe programe mësimore, deri tek sistemi i përgjithshëm i organizimit të punës mësimore në klasë dhe në shkollë, duke bërë që fëmijët tanë sot të jenë më të suksesshëm.

“Modeli i strukturës së mësimin ka zanafillën në strukturimin e orës mësimore nëpër etapa zhvillimore, që nga Komenski, Pestaloci, Herbarti, Hugo, Gaudigu etj. (Brada, 2010: 87), çka do të thotë se këta e shumë të tjerë ishin pedagogët e parë që

punuan në këtë drejtim, duke qenë edhe si model bazë i mësuesve të tjerë që erdhën pas tyre.

Si modele të të mësuarit tek nxënësit ndeshet modeli përmes imitimit, përmes roleve, vrojtimit, njohjes, ushtrimit, përsëritjes, audiovizualizimit, prekjes, nuhatjes etj. Këto janë disa prej modeleve për mësimnxënie të suksesshme. Kohët e fundit, këto modele mjaft mirë zbatohen nga mësimdhënësit. Ata vazhdimisht janë në kërkim të strategjive të reja mësimore, me qëllim për të përshtatur mësimdhënien moshës dhe aftësive psikofizike të nxënësve, që më pas ata të dinë ta praktikojnë drejt dhe lehtë në jetën e përditshme.

Profesioni i mësuesit është një profesion kompleks dhe me një përfshirje më të gjerë sesa vetëm klasa dhe ora e tij (Gjokaj R., Vavla, D. L. 2014: 130). Edhe nëse përqendrimi është vetëm në këtë kuadër, vetë mësimdhënia është më përfshirëse se kaq.

Aftësitë profesionale të mësimdhënësit mund të shtrihen në formim të tij, në trajtimin e njohurive dhe përçimin e ideve tek nxënësit në mënyrë sa më të butë dhe të natyrshme (Gjokaj R., Vavla, D. L. 2014: 136).

Mësuesi është i thelluar në lëndën e tij, duke ndjekur dijet bashkëkohore, informacionin e ri, që sjellin shndërrimet e vrullshme, duke zgjuar dhe duke aktualizuar në mënyrë të pandërprerë dijet në disiplinën e tij shkencore (Kraja, 2009: 257). Kjo do të thotë se mësimdhënësi inovator di të ndjekë ndryshimet inovative, që janë duke ndodhur dhe do të ndodhin vazhdimisht.

Shpesh në shkollat tona dëgjohen zëra të shumtë nga ana e disa mësimdhënësve: “Unë nuk njoh risi të tjera mësimore për t’i zbatuar në mësimdhënie”, apo “Shkolla jonë nuk është e pajisur me mjete inovative”, apo ankesat e drejtorëve: “Mësimdhënësit nuk i shfrytëzojnë mjaftueshëm mjetet mësimore”, ndërsa nga ana e prindërve shpesh

dëgjoen fjalët: “Rrallë ndodh që fëmijët tanë të sjellin në shtëpi ndonjë risi të fituar nga shkolla”. Këto e ankesa të tjera, shpesh dëgjoen në biseda të lira, po edhe përmes mjeteve të informimit publik, çka do të thotë se mësuesi novator edhe në këto raste di të bëjë zgjidhjen më të mirë të nxënësve.

Bagley, C. dhe Hunter, theksojnë se “Mësuesi është burimi kryesor i njohurive dhe i mençurisë e cila transferohet nga ai tek nxënësit” (1992: 17).

“Për punën dhe suksesin e nxënësve, sot janë të interesuar jo vetëm nxënësit, prindërit dhe arsimtarët e tyre, por edhe e tërë shoqëria, e cila në mënyrë të organizuar kujdeset për gjeneratat e ardhshme të vendit tonë” (Dërvodeli, 2010: 9). Kjo është e kuptueshme dhe e arsyeshme, kur dihet se ata janë jo vetëm ardhmëria e familjes sonë, por edhe ardhmëria e popullit dhe e atdheut tonë, e cila varet shumë nga cilësia dhe shkalla e edukimit dhe e arsimimit të tyre (Po aty: 9).

Mësimdhënësit, me aftësitë e tyre profesionale, kanë ditur dhe dinë të krijojnë klasa të gjalla e dinamike, duke shfrytëzuar dhe duke zhvilluar gjithë potencialin e tyre, duke dhënë mendim të ri në shkollë, duke respektuar dhe duke zbatuar programet mësimore dhe rregulloret e shkollës etj. “Mësuesi është hallka kryesore e veprimtarisë në shkollë. Ai është drejtues, organizues i procesit mësimor, interpretues i dokumentacionit shkollor, nga puna e të cilit varet veprimtaria e tërë hallkave që veprojnë në shkollë (Kraja, 2012: 19).

Mësimdhënësi bashkëkohorë di:

- Të drejtojë dhe të vlerësojë dijet e nxënësve;
- Të dallojë aftësitë dhe vështirësitë e çdo nxënësi;
- Të masë efikasitetin e mësimdhënies së tij;
- Të zbatojë metoda, forma, teknika dhe teknologji të reja mësimore;



- T'i bëjë nxënësit aktivë gjatë gjithë orës së mësimit etj.

Mësimdhënësit inovatorë kanë arritur të kuptojnë se çdo nxënës që e mësojnë është botë më vete. Pikërisht për këtë, mësimdhënësi, duke i marrë parasysh disa faktorë të ndryshueshëm, ndihmon që çdo nxënës të arrijë zhvillimin e mundshëm të tij të plotë.

Mësimdhënësit inovatorë respektojnë moshën e fëmijëve dhe dinë si t'i nxisin nxënësit për aktivitete pune në klasë, duke pasur parasysh zgjidhjen sa më të lehtë të problemeve në klasë, duke vënë veten në pozitën e nxënësve, me qëllim për të nxitur mësimnxënien, ngase më lehtë mund të kuptojnë se çfarë dëshirojnë të dinë ata dhe si mund t'i përvetësojnë njohuritë e reja.

### *3.1.1. Mësimdhënësit inovatorë ekspertë për gjetjen e inovacioneve mësimore*

Mësimdhënësit inovatorë janë artistë, ekspertë, hulumtues dhe projektues jo vetëm të shkollave, por edhe më gjerë. Ata dinë t'i udhëheqin drejt nxënësit, të projektojnë plane dhe programe mësimore, të menaxhojnë mirë dhe drejt teknikat dhe teknologjitë mësimore dhe vazhdimisht dinë të ndjekin trendin e përparimeve dhe të zhvillimeve bashkëkohore.

Mësimdhënësit inovatorë kanë krijuar klasa të gjalla dhe dinamike, duke shfrytëzuar dhe duke zhvilluar gjithë potencialin e vet profesional e moral. Ata çdoherë shfaqin mendimin e ri në shkollë dhe zbatojnë programet mësimore bashkë me rregulloren e shkollës.

Mësimdhënësi inovator:

- Shërbehet me metoda e ligjërime inovative;
- Është i aftë ta bëjë nxënësin aktiv gjatë gjithë orës së mësimit;

- Jep informata tërheqëse për nxënësit;
- Ka respekt për nxënësit dhe kolegët;
- Përdor teknikë dhe teknologji të re mësimore;
- Përcakton metoda dhe është i aftë t'i zbatojë ato;
- Dallon aftësitë dhe vështirësitë e çdo nxënësi;
- Motivon nxënësit për aktivitete pune në klasë;
- Krijon bindje tek nxënësit për ta dashur më shumë shkollën;
- Drejton dhe vlerëson dijet e fituara nga nxënësit;
- Ndjek vazhdimisht rritjen mësimore;
- Nxit dhe pranon iniciativat e nxënësve;
- Stimulon nxënësit përmes lëvdatave;
- Sjell burime e informacione të reja në çdo kohë të punës;
- Nxit nxënësit të bëjnë pyetje dhe të përfshihen në diskutim;
- Ndjek dëshirat e nxënësve, duke sugjeruar fushat më me interes;
- Vë nxënësin në qendër të vëmendjes;
- Përcakton kërkesat për çdo nxënësi dhe i përshtat ato, varësisht nga kapacitetet dhe mundësitë që kanë.

Natyra e vërtetë e mësimdhënies ndryshon vazhdimisht. Ajo bëhet më emocionale, më e kënaqshme dhe në nivel më të lartë intelektual, sidomos atëherë kur sigurohet pjesëmarrje e gjerë aktive e nxënësve në mësim.

Mësimdhënësi inovator ka partneritet të mirë mes nxënësve dhe vazhdimisht janë në një shkallë të lartë të angazhimit të ndërsjellë (Handscomb et al., 2014; McLaughlin & Black Hawkins, 2007).

Mësimdhënësi inovator, sipas nevojës, përshtat sjelljen, dialogun, vlerësimin, mimikën..., me qëllim që nxënësit në klasë të ndihen të lumtur dhe të sigurt. Mësimdhënësi inovator i kupton këto ndryshime dhe vepron me hapa të sigurt, sidomos në rastet kur nxënësi ka nevojë për ndihmën e mësimdhënësit në zgjidhjen e problemeve. “Arsimtari i mirë dallohet me kulturën e tij profesionale dhe pedagogjike” (Brada, 2010: 157). Ai njeft aftësitë psikofizike të nxënësve, dallimet moshore, gjinore, nevojat, prirjet, dëshirat etj. (Po aty: 157).

Një mësues i mirë shërben si *“një ndërmjetës midis nxënësit dhe programit mësimor, gjithmonë i gatshëm për protetikën edukuese – tekste, filma, programe kompjuterike, të cilat mund të ndihmojnë në shpjegimin e përmbajtjes, në një mënyrë sa më të efektshme për nxënësit që shfaqin karakteristika për këtë formë të të mësuarit”* (Gardner, 2003: 214).

Mësimdhënësi bashkëkohor është edhe bashkëpunëtor i mirë me prindërit e nxënësve (Brada, 2010: 157). Ky bashkëpunim është edhe me kolegët e punës, duke shqyrtuar edhe ndonjë problem shkollor. Është bashkëpunëtor i mirë edhe me komunitetin, duke komunikuar me ta për probleme të ndryshme të shkollës.

E gjithë kjo tregon se mësimdhënësit bashkëkohorë dinë dhe ia dalin të ecin drejt kërkesave dhe ndryshimeve të kohës. Ata kanë besim të madh në vetvete dhe atë besim e bartin edhe tek nxënësit, duke qenë çdoherë “të sinqertë dhe të ngrohtë” (Carnegie, 2005: 186).

Mësimdhënësit inovatorë pa dyshim janë një nga arsyet më të mëdha për arritjen e rezultateve më të larta në mësim (Niemi, 2012).

Mësimdhënësi i mirë arrin të jetë edhe motivues i mirë, sepse realizon motivimin e nxënësve për mësim aktiv. Ai arrin të jetë edhe këshilltar i mirë, ngase vazhdimisht i

këshillon nxënësit për problemet që e preokupojnë. Mësimdhënësi është model, ngase shpeshherë shndërrohet në model për nxënësit, si: për veshjen, për të folurit, për njohuritë, për pikëpamjet..., e çka nuk është tjetër për shkollën dhe nxënësit.

Mësimdhënësi i mirë arrinë të krijojë një klasë të gjallë me plot aktivitete pune, me qëllim që ta bëjë nxënësin një krijesë aktive përgjatë gjithë orës mësimore.

Mësimdhënësit kanë arritur të bëhen edhe ekspertë të mirë, të cilët, me një takt pedagogjik, pjesën teorike të orës mësimore, mjaft lehtë e lidhin me pjesën tjetër të veprimtarisë praktike, duke u ndeshur nxënësit drejtpërdrejt me veprimin e kërkuar.

Një profesor i Göteborgut Lars Åke Kernel (2000), pas shumë studimeve të tij, ka arritur në përfundim që mësimdhënësi i mirë patjetër “do të gjejë balancën” (Rukiqi, 2002: 34). Kjo do të thotë se çdo mësimdhënës mund të ketë aftësi të mjaftueshme për lëndët që përfaqëson dhe hapat që ndërmerr.

Mësimdhënësi ekspert, është i përgatitur mjaft mirë edhe në përdorimin e teknikave të përshtatshme në klasë, duke qenë i sigurt që ato sjellin rezultate pozitive tek nxënësit. Mësimdhënësi ekspert vazhdimisht shtron kërkesa për çdo nxënës dhe i pranon e i kupton ata, varësisht nga aftësitë e tyre psikofizike. Ai e di se nxënësit mes vete dallojnë shumë për sa u përket aftësive të tyre. Mësimdhënësi ekspert di të kujdeset mirë për nxënësit, e në raste të veçanta ka sjellje të individualizuar ndaj tyre.

“Mësuesi si ekspert mësimor: merr vendime të rëndësishme, si teksti që mund të përdoret dhe materialet mësimore, puna me nxënësit: individuale apo në grupe, metoda që mund të zgjidhet për zhvillimin e mësimin” (Kraja, 2012: 29).

Mësimdhënësi ekspert e di shumë mirë se çdo nxënës është një individ më vete, që ndryshon nga tjetri, si në sjellje, në aktivitete mësimore etj., që këto tipare asnjëherë tek fëmijët nuk mund të jenë stabile dhe me kalim të kohës tek ata shumëçka mund të

ndryshojë. Këta faktorë ndryshimi pothuajse mund të shihen dhe të vërtetohen në mënyrën e paraqitjes dhe sjelljes së fëmijëve në shkollë, në shtëpi, në rrugë etj., duke ndryshuar njëri nga tjetri, edhe pse janë të së njëjtës moshë, por, prapë se prapë, moshë e nxënësit është koha në të cilën nxënësi më së shumti pëson ndryshime. Mësimdhënësi i mirë dhe ekspert, këto ndryshime çdoherë i ka parasysh dhe shumë mirë di të menaxhojë punën me nxënës të moshave të ndryshme, duke e ndihmuar çdo nxënës për të arritur zhvillimin e tij të plotë.

Mësimdhënësit e kuptojnë realitetin shpirtëror të fëmijëve dhe dinë të sillen mirë me ta, pa i lënduar dhe pa i nënçmuar asnjëherë. Këta janë mësimdhënësit e së ardhmes dhe ekspertët që më së miri dinë të bëjnë më të mirën në klasë. Dinë të krijojnë klimë të ngrohtë me nxënës dhe dinë të krijojnë bindje të fortë tek nxënësit, se shkolla është shtëpia e tyre e dytë.

Mësimdhënësi, po kush tjetër pos tij, është eksperti dhe timoni i drejtimit të shkollës. Ai di të bëjë ndryshime jo vetëm në shkollë po edhe në takime të tjera sociale, si në takimet e vazhdueshme me prindër për mbarëvajtjen e punëve edukativo-arsimore, në takimet me komunitetin lidhur me nevojat dhe problemet që e rrethojnë shkollën, me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare etj.

Për t'i hulumtuar dhe për t'i kuptuar dëshirat dhe kërkesat e nxënësve, mësimdhënësit janë të vetmit ekspertë që më së miri dinë të sillen me nxënës, e sidomos atëherë kur ata e vënë veten në pozitën e nxënësve gjatë aktiviteteve mësimore në klasë. Pikërisht atëherë ata e shohin dhe e vërtetojnë se cilat janë nevojat dhe kërkesat e nxënësve që duhen plotësuar.

Mësimdhënësi ekspert, para se të fillojë shtjellimin e përmbajtjeve mësimore, i shtron pyetje vetes për hyrje më të lehtë dhe profesionale në problematikën e mësimi.

Kjo u mundëson nxënësve që nëpërmjet pyetjeve t'i përvetësojnë këto njohuri e koncepte që përmban tema.

Ekspert është ai që di të hyjë më lehtë në proces, di të sillet mirë me nxënës, di të krijojë rregulla në klasë, di t'i stimulojë nxënësit për ta dashur më shumë shkollën, di të menaxhojë klasën mirë dhe drejt, di të ndryshojë sjelljen sipas nevojës, di të krijojë klimë të ngrohtë me nxënës, di..., po çfarë nuk di, ai është mjeshtri, disenjatori dhe arkitekti kryesor i ndryshimeve në klasë dhe në shkollë.

### *3.1.2. Mësimdhënësit inovatorë - menaxhues aktivë të klasës*

Menaxhimi i drejtë i klasës është një nga shqetësimet kryesore të shumicës së mësimdhënësve, sidomos të mësimdhënësve fillestarë, ngase një menaxhimi i mirë i klasës është faktor kryesor për arritjen e rezultateve në mësim, ngaqë “për të përmbushur këto qëllime, kërkojnë që mësuesit të vendosin një atmosferë të mirë pune” (Musai, 1999: 226).

Mësimdhënësit menaxhojnë drejt mësimdhënien, sepse dinë të zbatojnë drejt teknikat mësimore dhe njohin mirë rregulla të shumta për sigurimin e mbarëvajtjes së drejtë të mësimit. Për një menaxhim të suksesshëm të klasës, ata shumë lehtë zbatojnë dhe përshtatin teknika adekuate, nëpërmjet të cilave mësimdhënien e bëjnë më atraktive për nxënës.

*“Mësuesi drejtues dhe udhëheqës: i përket mësuesit të organizojë, të drejtojë dhe të udhëheqë tërë punën mësimore edukative në klasë për të bërë zgjedhjen e atyre procedurave, të cilat sigurojnë rregull gjatë zhvillimit të mësimit, për një punë me nxënësit në tërësi dhe me çdo individ njëkohësisht” (Kraja, 2012: 30). Lidhur me*

menaxhimin e klasës, Kraja për mësimdhënësit ka thënë: “Menaxhimin e klasës, si problem themelor, fillojeni nga dashuria për nxënësin. Nxënësi mund të shohë jo nervozizëm, por dashuri në sytë e mësuesit të tij” (2009: 349).

Mësuesit kanë kapacitete dhe aftësi të ndryshojnë qëllimshmërinë e menaxhimit të rendit të tyre në shkollë (Moolenaar et al., 2014).

Shumë vjet më parë, do të mjaftonte vetëm një vështrim i ashpër i mësimdhënësit për të vendosur rregullin, qetësinë dhe disiplinën në klasë. Mirëpo, në ditët e sotme menaxhimi i klasës përbën një nga çështjet më shqetësuese të mësimdhënies, me të cilat mësimdhënësit ballafaqohen (Lekli, 2012: 166). Kjo është arsyeja që metodistët gjithnjë e më shumë po i kushtojnë rëndësi kësaj problematike, duke u munduar të gjejnë teknika të cilat do të ishin sa më të suksesshme.

Sot, kur me të madhe flitet për rolin që ka mendimi kritik dhe për rolin e përforcimit në ngritjen e suksesit dhe formimin e sjelljes pozitive, organizimi dhe menaxhimi i mirë i orës mësimore nuk ngel vetëm si obligim i thjeshtë rutinor, por gjithnjë e më shumë ky po bëhet domosdoshmëri me përgjegjësi të lartë profesionale dhe etike (Ismaili, 2013: 114).

Organizimi dhe menaxhimi i punëve të pavarura hulumtuese, karakterizohen nga veprimtari që nxitin të nxënit aktiv, nxitin vendimmarrjen e nxënësit dhe fuqizojnë kapacitetin mendor të nxënësit për të ndërtuar strategji dhe për të zgjidhur probleme (Kumari & Kushlesrtha, 2013).

Të menaxhuarit e klasës ka lidhje të drejtpërdrejtë edhe me sjelljen dhe emocionet e mësimdhënësit në zotërimin e mirë të lëndës dhe në ndjekjen e ecurisë së punës së nxënësve. Pikërisht në këto momente shfaqet aftësia e menaxhimit të klasës nga ana e mësimdhënësit, aftësi e cila karakterizohet nga vëzhgimi i kujdesshëm,

vlerësimi i sjelljeve në klasë dhe gatishmëria për t'iu përgjigjur në kohë sjelljeve të papërshtatshme.

Menaxhimi i klasës nuk është gjë tjetër, veçse zbatim i rregullave dhe procedurave, për sigurimin e disiplinës dhe mbarëvajtjen e mësimit në klasë.

Mësimdhënësi menaxhon klasën mirë kur:

- Nxënësit ngarkohen me veprimtari të qëllimshme, duke mos u lënë hapësirë bosh gjatë orës mësimore;

- Nxënësve u jep mundësi dhe kohë për të shfaqur mendimin e tyre;

- Nxënësve u jep informacione të drejta lidhur me të mësuarit, si të përdorin pajisjet dhe si t'i bëjnë detyrat e shtëpisë;

- Mësimi bëhet interesant dhe i vlefshëm për nxënësit;

- Nxënësve u sqarohen mirë detyrat që u jepen etj. (Tamo, Rapti, Karaj, 2005: 247).

Mësimdhënësit menaxhues janë të aftë dhe të gatshëm që të merren me shumë gjëra në të njëjtën kohë, sepse “menaxhimi përfshin vëzhgimin e veprimtarive në klasë, organizimin e mësimeve, përgatitjen e detyrave me shkrim dhe testeve, vlerësimin e detyrave, ndihmën që u jepet nxënësve që e kërkojnë” (Musai, 1999: 26).

Një orë mësimore e menaxhuar mirë, me shfrytëzimin maksimal të kohës në mësimdhënie, me ndjenjën e sigurisë dhe me një klimë të përshtatshme për punë, është një orë produktive dhe rezultatet e të nxënësve në realizimin e qëllimit të orës mësimore, do të jenë të suksesshme.



### *3.1.3. Mësimdhënësit inovator, këshilltarë të denjë për të ardhmen e gjeneratave*

“Mësuesi si këshilltar: gjen mjetin e përshtatshëm në mënyrë konstruktive, kur emocionet e nxënësve ndikojnë në mënyrën e të mësuarit” (Kraja, 2012: 30). Nga kjo mund të kuptojmë se mësimdhënësi për çdo pjesë të orës mësimore është këshilltar, por paraprakisht duke kuptuar shpirtin e nxënësve dhe duke qenë i sigurt se në drejtim të cilit nxënës jepen këshilla. Një këshillë e gabuar apo edhe e dyshuar, ka shumë efekte negative për nxënësit.

Mësimdhënësi me formim të drejtë pedagogjik, kupton dhe njeh mirë botën e re të fëmijëve, duke njohur veçoritë e moshës, veçoritë individuale dhe emocionale, duke mos dyshuar që edhe këshillat t'i bëjë në drejtim të pagabuar.

Mësimdhënësi i mirë, këshillat nuk i orienton vetëm në drejtim të nxënësve, por ato i drejton edhe në adresë të prindërve, duke u ofruar këshillime në drejtim të kërkimit të zgjidhjeve të problemeve të fëmijëve të tyre.

Mësimdhënësi njeh probleme të shumta që e preokupojnë nxënësin, andaj ai hyn në brendinë e tyre për t'i këshilluar edhe bashkëpunëtorët e tij (Kraja, 2012: 30).

Mësimdhënësit largpamës, përpos që angazhohen në dhënie të këshillave lidhur me çështje dhe probleme të mësimi, ata angazhohen edhe me preokupimet shpirtërore të nxënësve. Mësimdhënësit janë në gjendje të identifikojnë fuqitë dhe dobësitë e nxënësve, me qëllim që të zbulojnë potencialet e pazbuluara të nxënësve të tyre.

Mësimdhënësit, si këshilltarë të mirë që janë, dinë t'i udhëheqin nxënësit gjatë zhvillimit të procesit edukativo-arsimor, duke u përpjekur që vazhdimisht t'i këshillojnë dhe t'i ndihmojnë ata për ta zhvilluar plotësisht potencialin e tyre.

“Mësuesi të jetë vëzhgues i ndjeshëm i sjelljes njerëzore. Ai të përgjigjet në mënyrë konstruktive kur emocionet e nxënësve drejtohen në rrugën e të nxënësit” (Musai, 1999: 26).

Nxënësit bëjnë edhe gabime apo probleme të natyrave të ndryshme në klasë, shkollë... Por, mësuesi në këto raste është i qetë dhe i matur në veprimet e tij si dhe është i saktë dhe i sigurt në dhënien e këshillave që ato tek nxënësit ndikojnë pozitivisht dhe krijojnë bindje se gabimet e tilla nuk bën të përsëritën më. Shpesh ndodh që nxënësit të kërkojnë këshilla nga mësuesi për zgjidhjen e ndonjë problemi në klasë, ndërsa mësuesi çdoherë është i gatshëm për të dhënë këshilla në çdo kohë dhe në çdo vend. Në këto raste, një mësues i mirë tregohet i butë ndaj nxënësve për veprimet e bëra, duke i dëgjuar me vëmendje për problemin e bërë, e më pas krijon bindje tek ta, duke kuptuar që sjelljet e tilla nuk shkojnë në interesin e tyre.

Në të shumtën e rasteve, këshillat bindëse të mësuesve ndaj nxënësve, kanë efekt aq të madh, saqë, sikur të dilnin të gjitha forcat e tjera në një anë, vështirë që do të mund ta vinin në dyshim mendjen e fëmijës se mund të jetë diçka ndryshe nga ajo që thotë mësuesi i tij. Për këtë arsye dhe arsye të tjera, mësuesi është shumë i matur në fjalën e tij, ngase fjalët e tij për nxënësit janë bindëse dhe pa dyshim të pranueshme.

Roli i mësuesit këshilltar, sidomos gjatë takimeve me prindër, në rend të parë është edhe të interpretojë rezultatet e mësimit dhe disiplinës së nxënësve brenda objektit shkollor, duke qenë në dijeni për rezultatet e arritura, gjendjen sociale të tyre, vijimin e rregullt dhe me kohë në shkollë, ngecjet në mësim etj. dhe për gjitha këto mësuesi u jep këshilla prindërve për mënyrën e evitimit të dukurive negative dhe për rrugët e përmirësimit të gjendjes së tyre.

Mësimdhënësi i mirë di të këshillojë mirë dhe drejt, duke dëshmuar para nxënësve se është njeriu më i besueshëm dhe po ashtu duke dëshmuar edhe tek prindërit se në fakt është ai që ka ditur dhe di të arrijë rezultate të mira dhe sjellje të drejtë për fëmijët e tyre, sikurse brenda ashtu dhe jashtë objektit shkollor.

#### *3.1.4. Mësimdhënësit krijues, organizatorë kyç në përparim të shkollës*

Mësimdhënësi është personi kyç i shkollës, i cili di për gjithçka që shkon mirë dhe nuk shkon si duhet. Ai është shumëçka dhe gjithçka për shkollën. Ai di ku mund të bëhen ndryshimet, ku mund të bëhen dhe sa duhet të bëhen. Ai di se sa dhe si "merr frymë" shkolla. Andaj, kush tjetër mund të jetë organizatori kryesor dhe më i mirë për shkollën?

Mësimdhënësit krijues janë organizatorë të mirë dhe vizionarë të ndryshimeve në shkollë. Sipas Vujit (2015), jeta e vizionarëve është sa e vështirë aq edhe tërheqëse dhe nxitëse për të bërë kërkime për ndryshime të reja. Ata, duke luftuar hap pas hapi me vështirësitë e zhvillimit apo të natyrave të tjera, formohen si forca të reja krijuese dhe nxiten për të vepruar nga motive të brendshme shpirtërore (f: 280).

Për një mësimdhënie të suksesshme vizionare dhe cilësore, është shumë i rëndësishëm zhvillimi i mendimit krijues. Për një zhvillim të tillë, mësimdhënësi është ai që ndihmon nxënësit për t'i përvetësuar njohuritë e reja, nëpërmjet një pune krijuese, duke mos u mbështetur vetëm në përgatitjen profesionale, por vazhdimisht duke nxitur nxënësit për t'i zbuluar aftësitë e tyre. Lidhur me këtë, me plot të drejtë thotë Zajazi (2003) se "Mendja krijuese është një nga aspektet e të menduarit, e shikuar si një tërësi" (f: 474).

Krijueshmëria ka të bëjë me aftësinë e një individi apo të një grupi, për të vënë në jetë një rregull, ide apo për të zgjidhur mirë dhe drejt një problem. Lidhur me këtë, fëmijët janë shumë të prirur për të krijuar ide, ngase dëshira e tyre e madhe është për ta zhvilluar imagjinatën e tyre sa më shumë që është e mundur. Andaj, mësuesit vazhdimisht shfaqin qasje të reja të krijimtarisë mësimore, me qëllim për të arritur rezultate më të mira tek nxënësit e tyre (Drapeau & Sparking, 2014).

Mësimdhënësit krijues, vazhdimisht i bëjnë pyetje vetes se si mund të gjejnë forma, metoda dhe teknika të reja mësimore me qëllim për të arritur më lehtë dhe më shpejt rezultatet e pritshme më të mira të nxënësve. Për arritjen e një gjëje të tillë, mësimdhënësi krijon kushte të favorshme në klasë, me qëllim për të nxitur nxënësit që të krijojnë ide të reja, duke lidhur pjesën teorike me veprimtaritë e tyre praktike si një gjë shumë e kërkuar nga vetë nxënësit, që me dëshirën dhe vullnetin e tyre të japin ide me qëllim për të krijuar një klasë të vërtetë pune.

Të mësuarit krijues kërkon përpjekje të konsiderueshme nga mësuesit, në mënyrë për të arritur rezultate pozitive (Wastiau, Kearney dhe Vanderberghe, 2009).

Mësimdhënësi krijues bën kërkim të ndryshimeve inovative, të cilat në të shumtën e rasteve tek nxënësit sjellin gjendje të mirë shpirtërore, kënaqësi, bashkëpunim, harmonizim të dyanshëm, socializim dhe kureshtje për të ditur më tepër. Në këto raste mund të kuptojmë se nxënësit lirshëm shprehin talentin e tyre, duke dhënë ide lidhur me ndryshimet që mund të ndodhin brenda mureve të shkollës, me qëllim që tek ta të krijohet mundësia e shprehjes së lirë ([http://www.arsimi.gov.al/files/news\\_files/revista\\_mesuesi\\_tetor\\_2.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/news_files/revista_mesuesi_tetor_2.pdf)).

Mësimdhënësit krijues, nxënësve të tyre u krijojnë mundësi që në veprimtaritë praktike të jenë ideorët, inovatorët dhe projektuesit e projekteve.

Për të arritur një krijimtari të tillë në klasë, *së pari*, mësuesi sjell materialin e nevojshëm. *Së dyti*, paraqet përvoja të ndryshme rreth objektit mësimor. *Së treti*, nxënësve u kërkohet të shkojnë përtej të dhënave. *Së katërti*, nxiten nxënësit për ide të reja ([http://www.arsimi.gov.al/files/news\\_files/revista\\_mesuesi\\_tetor\\_2.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/news_files/revista_mesuesi_tetor_2.pdf)).

*“Një nga mjetet e rëndësishme që mundëson dhe tërheq nxënësit për të qenë efektivë dhe krijues në orën e mësimit është kompjuteri, si dhe aksesori të tillë, si: CD, DVD, videoprojektori, etj. Duke ndërlidhur teorinë me praktikën, nxënësi motivohet dhe nxitet për një pjesëmarrje aktive. Ora e mësimit bëhet më e bukur e zor se mund të ketë nxënës indiferentë”* ([http://www.arsimi.gov.al/files/news\\_files/revista\\_mesuesi\\_tetor\\_2.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/news_files/revista_mesuesi_tetor_2.pdf)).

Mësimdhënësi krijues, gjatë shtjellimit të përmbajtjeve mësimore, nuk mbështetet vetëm në fjalët e tij të thata, por shfrytëzon gjithë potencialin e mundshëm të një inovatori të vërtetë për ta bërë nxënësin të ndihet i relaksuar dhe në fund të orës mësimore të jetë fitues i njohurive të reja. Në këtë kontekst, mësimdhënësi, për të nxitur veprimtari kreative, që idetë e tij të jenë impuls për nxënësit, në klasë krijon dhe zbulon kreativitetin e tyre (Vojka-Ismajl 2012: 49).

Një rast kur mësimdhënësi i lëndës së historisë së klasës së pestë nga SHFMU “Skënderbeu” në Hogosht, bën zhvillimin e një njësie të re mësimore me titull “Skënderbeu”, ai, përpos librit, shfrytëzon mjaft mirë edhe mjete të tjera përkatëse, të cilat nxënësin e bëjnë të ndihet i sigurt në angazhimin e tij në klasë. Mësimdhënësi këtë njësi mësimore e zhvillon me ndihmën e videoprojektorit, përmes të cilit shfaq filmin e Skënderbeut. Në pjesën përfundimtare të orës mësimore, apo në orën tjetër të lëndës së historisë, mësimdhënësi krijoi një rrjet diskutimesh me nxënës për gjithë atë që kishin parë ata, si: për luftërat e Skënderbeut, për armët që ishin përdorur në atë kohë, për

gjuhën që e kanë folur, për zonat që është luftuar, për bashkimin e fiseve, për familjen e Skënderbeut etj. Në këtë rast, nxënësit, përmes pamjeve vizuale, ishin në gjendje të mbanin mend më shumë dhe të jepnin përgjigje më të sakta, ngase pamjet vizuale i ngacmonin dhe i nxitnin nxënësit për shprehje të lirë. Një pohim i tillë është hulumtuar dhe është vërtetuar edhe nga shumë mësimdhënës dhe studiues.

Në këtë mënyrë mund të punohet edhe në orët e tjera mësimore, si, për shembull, nga lënda e edukatës muzikore, nxënësit, përmes videoprojektorit, dëgjojnë këngën dhe mund ta mësojnë më lehtë për ta kënduar si dhe në të njëjtën kohë mund edhe të vallëzojnë, duke mësuar lëvizjet e hapave që shihen nga projektori. Në këto raste, mësimdhënësit tek nxënësit krijojnë mundësi dhe liri për të qenë krijues të së ardhmes. Fatmirësisht, disa prej mësimdhënësve të moshuar dhe disa prej tyre, që nuk kanë njohuri të mjaftueshme për vallëzim, mësimdhënëset që janë me barrë, mësimdhënësit që kanë probleme të tjera fizike e shëndetësore etj., kanë mundësinë e zbatimit të mjeteve audiovizuale pa angazhimin e tyre fizik, kur nxënësit, me aftësitë dhe vullnetin e tyre, marrin përsipër angazhimin e orës mësimore dhe klasës i japin një pamje të gjallë pune.

Vëmendje të veçantë kërkojnë fëmijët që fshehin brenda tyre talente të ndryshme. Kjo kategori nxënësish shfaqin një potencial të fuqishëm nëpërmjet motivimit të vazhdueshëm të tyre, me qëllim që ata të mos lihen pas dore ([http://www.arsimi.gov.al/files/news\\_files/revista\\_mesuesi\\_tetor\\_2.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/news_files/revista_mesuesi_tetor_2.pdf)).

Nëse nxënësit do të përfshihen seriozisht në procesin krijues, patjetër do të prodhojnë diçka. Kjo sjell edhe kënaqësi për ta, sepse “gëzimi i vërtetë qëndron në aktivitetin e vërtetë” (From, 2006: 3).

### *3.1.5. Mësimdhënësit inovatorë në rolin e aktorit në klasë*

Në disa situata, mësimdhënësi inovator është edhe aktor i mirë në klasë, me qëllim të krijimit të një klase të gjallë pune dhe me qëllim të stimulimit dhe motivimit të nxënësve, duke demonstruar qëndrimin, humorin dhe gjeste të tjera në favor të arritjes së rezultateve më të kënaqshme në klasë. Por, nuk do të thotë që i gjithë procesi mësimor i epokës së digjitalizimit të ri të kalojë në metaforë (Paavola & Hakkarainen, 2014).

Për ta kthyer vëmendjen e plotë të nxënësve dhe për ta bërë më tërheqëse orën mësimore, mësimdhënësi ndërron rolin e tij, ngase i njëjti rol për nxënësit është i mërzitshëm. Mësimdhënësi, me rolin e tij pozitiv në klasë, nxënësit i bënë më aktivë, duke i bërë ata që shikimin dhe mendjen ta mbajnë në të shumtën e kohës në drejtim të mësimdhënësit. Për t'i kthjellur nxënësit nga gjumi, mësimdhënësi bën ndryshimin e rolit të tij brendapërbrenda orës mësimore, duke ndryshuar mënyrën e të shpjeguarit, si: futjen e humorit, demonstrimin e përmbajtjeve mësimore, biseda të ngrohta për të zgjuar kureshtjen e nxënësve, futjen e teknikave të reja mësimore etj., me qëllim që në këto raste të rrisë përqendrimin dhe interesimin e nxënësve për punë efektive në klasë.

Mësimdhënësi inovator, për të pasur situatën e klasës nën kontroll, jo vetëm që aktron, por ai luan edhe shumë role të tjera të mundshme, duke shfrytëzuar gjithë potencialin e tij, bashkë me shkathtësitë dhe aftësitë profesionale që ka në dispozicion, me qëllim që tek nxënësit të krijojë bindje, vullnet dhe dashuri për punë.

Mësimdhënësi mund të jetë aktor i mirë në rolin e tij, ngase ai është personazhi kryesor në mesin e shumë personazheve të tjera me role të ndryshme. Nëse ai si personazh kryesor di “të aktrojë” mirë rolin e tij në klasë, të pranishmit (nxënësit) i bën

që të ndihen aktivë në punën e tyre të palodhshme. Ai është personi më meritor që, me rolin e tij të besueshëm në klasë, krijon edhe shumë aktorë të tjerë pozitivë, të cilët pa dyshim që do të jenë e ardhmja e një shoqërie me role pozitive.

Mësimdhënia inovative, çdoherë është në kërkim të formave, metodave, mjeteve, teknikave dhe teknologjive të reja mësimore. Mësimdhënësi është aktori kryesor i gjitha organizimeve të spektakleve mësimore. Ai është dirigjenti dhe instrumentisti që më së miri di të luajë me këto "instrumente", duke ia gjetur vendin secilit instrument, në përshtatje të secilit nxënës, varësisht nga mosha, aftësia dhe gjendja shpirtërore që ka.

Mësimdhënësi në rolin e aktorit, shkollën e bën më tërheqëse dhe më interesante për nxënësit. Sidomos atëherë kur gjatë orëve të lëndëve mësimore zë vend demonstrimi, si: në lëndën e edukatës muzikore, në lëndën e edukatës fizike dhe sportive, në lëndën e punëdores, në lëndën e edukatës figurative etj. Ai i bën nxënësit më të sigurt në interpretimin e përmbajtjeve mësimore. Ai së pari demonstroi vetë për të krijuar mundësinë që veprimet e tilla t'i demonstrojnë edhe nxënësit. Në këto raste nxënësit do ta ndiejnë veten më të sigurt për të mësuar dhe do ta kenë shumë më të lehtë interpretimin e përmbajtjeve mësimore.

Kur mësimdhënësi flet bukur, kur mobilizon nxënësit gjatë aktiviteteve në klasë, kur përmbajtja mësimore zhvillohet në bashkëpunim me ta, kur ata motivohen, vlerësohen, janë në vëmendjen e vazhdueshme të mësimit, edhe ora e mësimit është interesante, e gëzuar dhe me efektivitet të plotë (Kraja, 2009: 208).

Kur mësimdhënësi rrit humorin e mirë të nxënësve gjatë aktiviteteve mësimore në klasë, ora mësimore bëhet më interesante dhe më tërheqëse për nxënës dhe patjetër që do të japë rezultate më të mira në të gjitha lëndët mësimore.



### *3.1.6. Mësimdhënësit hulumtues të inovacioneve mësimore*

“Hulumtimi është një pjesë përbërëse e jetës” (Zajazi, 2003: 101). Hulumtimi është pjesë përbërëse e njerëzve të mençur, të cilët pothuajse asnjëherë nuk pushojnë së hulumtuari dhe së shkruari për të bërë një jetë më të mirë dhe më të lehtë për vete dhe për të tjerët. Hulumtimi, si një segment i veprimtarisë së mësuesit, është një punë edhe kureshtarë, që ia bën atij të mundur të shoqërohet me rezultatet e punës së vet (Po aty: 101).

Modeli i punës së pavarur, që motivon më shumë nxënësit, është modeli i punëve të pavarura me karakter hulumtues (Rooney, 2012).

Për të bërë diçka të re dhe të suksesshme nga ana e mësimdhënësit, ai vazhdimisht është në hulumtim për të zbuluar diçka më të mirë se e sotmja. Sipas Berishajt (2016) “sikurse nxënësit që kanë nevojë për të mësuar, ashtu edhe mësimdhënësit të bëhen nxënës të suksesshëm” (f: 104).

Hulumtimi, si një segment i veprimtarisë së mësimdhënësit, është një punë edhe kureshtarë, që ia bën të mundur të shoqërohet me rezultatet e punës së vet (Lidershipi në arsim, 2014). Kjo do të thotë se shumica e mësimdhënësve janë kureshtarë për të ditur për punën dhe rezultatet e tyre. Sikurse prindërit që janë kureshtarë për t'u njohur me rezultatet e fëmijëve të tyre, ashtu edhe komuniteti dhe shoqëria janë kureshtarë për të ditur për punën dhe kontributin e shkollës.

Bashkëpunimet dhe takimet e shtuara mes mësimdhënësve dhe prindërve bëjnë që mësimdhënësit të përkrahen, të ndihmohen dhe të këshillohen për punë të mëtutjeshme, me qëllim për të arritur rezultate më të mira në shkollë. Takimet e tilla,

mësimdhënësin e bëjnë moralisht më të fortë dhe profesionalisht më të ngritur, me qëllim për t'u thelluar në hulumtime të mëtutjeshme profesionale.

Roli i mësimdhënësit në të mësuarit hulumtues, është udhëheqja e tij dhe drejtimi apo diktimi në procesin e mësimit (Tamo A., Rapti E., Karaj Th. 2005: 154). Kjo do të thotë se mësimdhënësi, gjatë realizimit të një ore mësimore me karakter hulumtues, nuk merret me shpjegime lidhur me zgjidhjen e një problemi të caktuar, por në realitet ai u bën pyetje nxënësve për zgjidhjen e problemeve, duke përzgjedhur tematika dhe koncepte të ndryshme, për t'ua hapur rrugën nxënësve që të gjejnë më lehtë rrugën e zgjidhjes së problemit. Merr shembuj abstraktë dhe konkretë lidhur me përmbajtjen mësimore dhe, në mungesë të mjeteve konkretizuese, përdor mjete improvizuese duke i bindur nxënësit se hulumtimet duhet të burojnë, sikurse nga brenda ashtu edhe nga jashtë, dhe, nëse kanë ide lidhur me ndonjë risi, i merr për bazë dhe i shqyrton bashkërisht.

Në realitetin e zgjerimit të hapësirës së komunikimit të mundësisë së shfrytëzimit të burimeve të informacionit dhe përdorimit të teknologjive të avancuara, të nxënësve e bazuar në hulumtim po trajtohet me përparësi në vende të hapësirës evropiane (EU, PRIMAS, 2013).

Duke iu referuar raportit të projektit PRIMAS, mbi mësimdhënien dhe të nxënësve e bazuar në hulumtim për vendet e Evropës, theksohet se motivimi i nxënësve ka marrëdhënie të forta me mësimin e bazuar në hulumtim. Si rrjedhojë, punët e pavarura hulumtuese nxitin motivimin e nxënësve për t'u përfshirë në mënyrë interaktive në procesin e të nxënësve (PRIMAS, 2013).

Përfshirja e nxënësve në veprimtaritë hulumtuese, është një sfidë e mësimdhënies bashkëkohore dhe një model që po gjen gjithnjë e më shumë mbështetje nga politikat arsimore të vendeve të zhvilluara (PRIMAS, 2013).

Mësimdhënësit inovatorë, asnjëherë nuk ndalen së hulumtuari për të gjetur metoda, teknika, teknologji dhe forma të reja të mësimdhënies. Ata vazhdimisht janë në hulumtim të burimeve të reja, në shkëmbim të përvojave mes kolegëve, në ndjekje të trajnimeve dhe seminareve me karakter edukativ etj. Me këtë, mësimdhënësit arrijnë të përsosin shkathtësitë profesionale të tyre, me qëllim që nxënësit në shkollë të jenë sa më të suksesshëm.

Mësimdhënësit janë hulumtues të vazhdueshëm gjatë tërë jetës së tyre, me qëllim për të mbajtur vullnetin dhe dëshirën e tyre lidhur me çështjen se si t'i edukojnë më mirë gjeneratat e reja.

Shumica e teknikave mësimore që kanë zënë vend në shkollat tona dhe në vende të ndryshme të botës bashkëkohore, pothuajse janë hulumtuar, janë vërtetuar dhe janë praktikuar nga vetë mësimdhënësit. Andaj, nuk thuhet rastësisht se mësuesit janë artistët, ekspertët, hulumtuesit dhe projektuesit jo vetëm të shkollave inovative, por edhe më gjerë, ngase ata vetë e përgatisin “brumin” prej të cilit do të varet ”shija e bukës”, nga e cila bukë do të hanë popujt dhe do të zhvillohen e do të përparojnë as më shumë e as më pak, por vetëm aq sa mësuesi ka ditur t'i japë shije asaj.

Sipas Tamo A., Rapti E., Karaj Th. (2005), metodat e të mësuarit hulumtues tek mësimdhënia, ndikojnë në përvetësimin aktiv të informacionit, duke shfaqur përparësi kundrejt metodave shpjeguese tradicionale të mësimdhënies dhe ofrojnë realizimin e veprimtarive motivuese, duke u dhënë mundësi nxënësve:

- të mësojnë dhe të praktikojnë aftësitë intelektuale;

- të mësojnë si të mendojnë në mënyrë logjike;
- të kuptojnë proceset që ndodhin në mendjen e tyre gjatë të mësuarit (f: 151).

Mësimdhënësi me qëndrim të një hulumtuesi të vërtetë, është në lëvizje me tërë arsenalin e veprimtarisë së tij. Ai dallon nga mësimdhënësit e tjerë, që vazhdimisht përsërisin të njëjtat informata, pa ndryshuar asgjë në të mirë të nxënësit dhe pa pasur parasysh efektet që mund prodhojnë një lloj tjetër të të mësuarit (Zajazi, 2003: 103). Mësimdhënësi i mirë vazhdimisht është në hulumtim të gjetjeve të formave më të mira të mësimdhënies, duke provuar metoda më efektive me nxënës në klasë, teknika të vlerësimit, krahasime të rezultateve të klasave dhe shkollave të ndryshme etj. (Po aty: 103).

### *3.1.7. Mësimdhënësit inovatorë, pjesëmarrës të përpunimit të kurrikulës shkollore*

“Në terminologjinë e pedagogjisë sonë, kurrikula përbën një term relativisht të ri. Si koncept e ka prejardhjen nga latinishtja, që do të thotë ecuri, vrapim drejt objektit” (Kraja, 2009: 179). Programi i kurrikulës përmbledh në vetvete një sistem të tërë njohurish e praktikash të planifikimit e programimit të të mësuarit (Po aty, f: 179).

Si karakteristikë e radhës, konsiderohet “Gatishmëria për ndryshim”, e cila në kontekstin organizativ, ka të bëjë me shqyrtimin e përshtatshmërisë së mësimdhënies, me motivimin dhe me vullnetin për të ndryshuar procesin e mësimdhënies (Ingersoll, Kirsch, Merk & Lightfoot, 2000).

Është një e mirë që kurrikula e re mësimdhënësve u lejon që t’i qasen në mënyrë krijuese planifikimit të veprimtarive mësimore. Lidhur me këtë, në dispozicionin e tyre tani kanë literaturë të re, që, për ndonjë rast ndërhyrjeje në të, mund të diskutojnë edhe

me kolegët e tyre, me prindërit e me nxënësit, si për objektivat e mësimit, përmbajtjen e saj, metodat dhe procedura e të vlerësuarit etj., në mënyrë që dispozitat e mësimit të përshtaten nevojave të nxënësve.

Mësuesit janë personat më aktivë rreth ndryshimeve apo përpunimeve të planifikimit të organizimit të veprimtarive të përcaktuara nga shkolla lidhur me temat e reja jashtëkurrikulare dhe ekstrakurrikulare, me qëllim përshtatjeje të planit dhe programit mësimor për nxënësit.

“Mësuesit janë pjesëmarrës në konceptimin e kurrikulës dhe kanë vendin kryesor në zbatimin e saj” (Kraja, 2012: 168). Pjesëmarrja e mësuesit në hartimin e kurrikulës e bën më të suksesshëm procesin e zhvillimit dhe të zbatimit të kurrikulës (Po aty: 169).

Në botën bashkëkohore, procesi i rishikimit dhe i hartimit të kurrikulës, gjithnjë e më shumë po demokratizohet dhe po decentralizohet, duke përfshirë në këtë proces edhe përgjegjësinë për ndryshimet, rezultatet dhe cilësinë e kurrikulës si nga institucionet shkollore, ashtu dhe nga subjektet e tjera.

Kurrikula u lejon mësuesit që t`u qasen formave krijuese të planifikimit të veprimtarive mësimore në klasat e tyre për të arritur kompetencat nga ana e nxënësve si në nivel shkollor - kompetenca të përgjithshme, që mund t`i arrijë nxënësi gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në nivel fushe - kompetenca që mund të arrijë nxënësi në nivelin e lëndës (MASHT, 2013, Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe kurrikula bërthamë).

Përpos mësuesit, të cilit i takon qasja në kurrikulë, ajo i takon edhe personelit tjetër, si: drejtorit, prindërve, specialistëve të universitetit, përfaqësuesve nga biznesi dhe grupeve të bashkësisë, agjencive qeveritare, politikave, kompanive botuese të teksteve etj. (Marsh, 2009: 10). Përveç faktorëve të lartpërmendur, pjesë e kurrikulës

mund të jenë edhe të gjithë ata faktorë që së paku kanë ndikim pozitiv në bërjen e kurrikulës.

Mësimdhënësit, sipas kurrikulës, janë të lirë të vendosin në realizimin (shpërndarjen) e numrit të orëve për fushë, brenda një viti shkollor. Fondi i përcaktuar vjetor, që vendoset nga vetë mësimdhënësi, shpërndahet sipas synimeve dhe qëllimeve të tij të planifikimit, brenda periudhave kohore apo GJV (gjysmëvjetorëve) mësimorë. Kështu, p.sh., nëse në klasën e parë është vendosur të merren 16 orë nga fusha Gjuhët dhe komunikimi, ato orë mund të shpërndahen sipas qëllimeve të mësimdhënies, 10 orë në gjysmëvjetorin e parë dhe 6 orë në gjysmëvjetorin e dytë apo e kundërta (MASHT, 2012, Kurrikula bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor).

Mësimdhënësit, sikurse në përpunimin e planit dhe programit mësimor, ashtu edhe në përcaktimin e orëve mësimore sipas periudhave apo gjysmëvjetorëve, janë të lirë të veprojnë në ndarjen e orëve mësimore.

Në fushën e arsimit, ndryshim do të thotë një ndërhyrje për të zëvendësuar një program ekzistues me një risi. Si në fushat e tjera, edhe në fushën e arsimit lejohen ndryshimet, ngase një strategji e mësimdhënies, që është zbatuar para më shumë se 10 vjetësh, tani vështirë që do të gjejë vendin e merituar. Kjo do të thotë se ato ndryshojnë sipas zhvillimit ekonomik të një vendi dhe rrethanave të kohës. Dhe, krejt normale është kur thotë Cuban (1988): “Të pakta janë ato risi arsimore që arrijnë të futen në derën e shkollës e të mos dalin më prej saj” (f: 126).

Varësisht prej rrethanave dhe interesave të asaj zone, përpos mësimdhënësve, që u lejohej të ndërhyjnë në kurrikulë, këtë të drejtë e kanë edhe njerëzit e bashkësisë dhe këshilli i prindërve, duke propozuar ide lidhur me ndryshimin dhe përshtatjen e një pjese të kurrikulës me interesat e zonës e caktuar.

Kurrikula është një akt politik, ku marrin pjesë shumë aktorë, duke përfshirë edhe prindërit (Williamson & Payton, 2009).

Sipas Krajës (2012), “Edhe nxënësit të japin mendimin e tyre, për përmirësimin e kurrikulës, sidomos në procese reformash për çështje të caktuara” (f: 169).

Kurrikula shkollore, shpeshherë zgjerohet nga vetë mësimitdhënësit. Një mësimitdhënësi i suksesshëm kujdeset në veçanti për nxënësit e vet, duke hartuar e duke zbatuar një plan të veçantë pune në përshtatje me nivelin dhe dëshirat e tyre për të mësuar dhe, në këtë rast, asgjë nuk ka diçka të keqe nëse rezultatet janë të dukshme.

Zgjedhja se çfarë mund të përfshijë në programin mësimor, përpos që do të jetë në dobinë e nxënësit, ajo do të plotësojë edhe kërkesën për një shoqëri të dijes (Williamson & Payton, 2009).

### *3.1.8. Mësimitdhënësit vendimmarrës në gjetjen e inovacioneve mësimore*

Me inovacion në mësimitdhënie, kuptojmë mënyrën e re ose mënyrën e përsosur të mësimitdhënies. Me mësimitdhënie inovatore kuptohet mësimi ndryshe nga ai që është ndjekur deri më tani. Kohët e fundit, inovacionet mësimore janë bërë nevojë dhe domosdoshmëri e mësimitdhënësit, duke krijuar vazhdimisht diçka të re për nxënësit. Me fjalë të tjera, inovacionet në mësim paraqesin rregulla apo qasje të reja të zbatimit të teknikave mësimore, me të cilat mësimi bëhet më tërheqës për nxënësit.

Inovacion mësimor është futja e njohurive të reja në mësim, me të cilat nxënësit takohen për herë të parë, apo nuk janë përdorur më parë në procesin mësimor.

Mësimdhënësit janë njerëz me përgjegjësi të lartë në qasjen e metodave të reja të mësimdhënies, përmes të cilave tek nxënësit krijojnë bindje dhe besim të fortë lidhur me aktivitetet mësimore në shkollë.

Inovacionet mësimore mund të paraqiten në forma të ndryshme, si:

- Përmes fjalës së gjallë të mësimdhënësit;
- Përmes planeve dhe programeve mësimore;
- Përmes përmbajtjeve mësimore;
- Përmes fjalës së shkruar;
- Përmes vlerësimit dhe kontrollimit të njohurive të nxënësve;
- Përmes objektivave të mësimit;
- Përmes organizimit të procesit të mësimdhënies dhe nxënies;
- Përmes teknikave të mësimdhënies;
- Përmes teknologjisë së mësimit;
- Përmes metodave dhe formave të punës mësimore;
- Përmes mjeteve të mësimit;
- Përmes mjeteve të improvizuara etj.

Nga rezultatet e studimeve për fushën e marrjes së vendimeve, Philip Jackson, (1968) dhe Paul V. Grump, (1967), është vërtetuar se një mësimdhënës gjatë një dite të punës, në procedimin e mësimdhënies, merr 1000 deri në 1300 vendime për veprime të mëdha e të vogla, merr vendim për definimin e përmbajtjes së mësimit, përcaktimin e qëllimit, të objektivave, mjeteve, metodave, modelit, strategjisë, teknikës, teknologjisë, të detyrave për nxënësit, vendime për zbatimin e formës së punës si ligjërime, film, grupe të vogla, debate, diskutime, vendime për reagime në situata të shpejta në klasë gjatë udhëheqjes së mësimit etj. (Zajazi, 2003: 136). Mësimdhënësi merr vendime sipas



situatës së paraqitur aty për aty, por ai çdoherë është i përgatitur të reagojë në mënyrë të drejtë dhe demokratike për të gjitha rastet dhe për të gjithë nxënësit.

Mësimdhënësit me përvojë, asnjëherë nuk marrin vendime të ngutshme në klasë pa marrë pëlqimin e nxënësve. Ata asnjëherë nuk e shkelin të drejtën e palës tjetër, të cilën edhe janë të obliguar ta respektojnë. Mësimdhënësi inovator nuk merr vendime të njëanshme, të cilat shkelin të drejtat e palës tjetër, pa marrë parasysh moshën dhe aftësitë që ka, përndryshe “ai bie ndesh me motivet, interesat dhe nevojat e nxënësve” (Zajazi, 2003: 137). Pra, mësimdhënësi, bashkërisht me nxënësit, merr vendime në për zgjidhjen e problemeve të mundshme në klasë-shkollë.

Si profesionistë, mësimdhënësit nuk mund të jenë vetëm zbatues të vendimeve, por edhe partnerë në zhvillimin e tyre. Mësimdhënësit priren të jenë në gjendje të marrin rolin aktiv në vlerësimin dhe përmirësimin e mësimin në mjediset shkollore (Niemi, 2011).

Mësimdhënësit e dinë shumë mirë se vendimet e njëanshme nuk sjellin rezultate të favorshme për nxënësit, andaj ata, para se të marrin një vendim të tillë, e ndiejnë si detyrë morale dhe profesionale për të bashkëpunuar me nxënës, duke pasur parasysh edhe nga jeta e përditshme se çdo marrëveshje e ndërsjellë sjell rezultate më të mira në punë. Për këtë edhe profesori Kraja (2012) shumë mirë e cek, kur thotë se: “Mësuesi dhe nxënësi janë dy bashkëpunëtorë të ngushtë gjatë gjithë viteve të shkollimit” (f: 244). Andaj, përpos vendimeve të qasjeve të reja në mësimdhënie, që i takojnë mësimdhënësit, gjithsesi që për një vendim të tillë, merren edhe mendimet e nxënësve dhe palëve të tjera të interesuara.

### *3.1.9. Mësimdhënësit inovatorë në përshtatje të veçorive individuale të nxënësve*

“Vizionarët, duke punuar për harmonizimin e vizionit personal me ato kolektive, me bazë familjeje, klase e shkolle, forcojnë shpirtin e tyre novator e perspektiv, që i hap rrugën zbulimit të ndryshimeve të reja në tërë veprimtarinë e tyre shkollore e sociale” (Vuji, 2015: 280).

Parimi i përshtatshmërisë dhe i individualitetit konsiston në akomodimin e procesit edukativ, qëllimeve, objektivave, parimeve, metodave, mjeteve, formave dhe të tjerave, me zhvillimin dhe mundësitë psikofizike të nxënësve si gjeneratë dhe të nxënësve si individualitet (Krasniqi, Deva-Zuna, 2012: 115).

Përmbajtjet mësimore t`i përshtaten nivelit të zhvillimit të përgjithshëm të nxënësve, duke shprehur kërkesën e domosdoshme që përmbajtja dhe metodat të jenë në përputhje me forcat mendore të nxënësve dhe me aftësitë perceptuese dhe asimiluese të tyre (Kraja, 2009: 204). Mësimi që zhvillohet në shkolla, për të qenë më afër realitetit të nxënësit, u përshtatet aftësive fizike dhe psikike të tij. Përpos kësaj, Kraja (2012) thotë: “Klasa përbëhet vetëm prej një grumbulli individësh të njëjtë, por brenda tyre ka edhe një kompleks cilësish të veçanta” (f: 186). Lidhur me këtë, mësimdhënësi është personi më i përshtatshëm, që di më së miri të gjejë teknika, metoda, forma, mjete dhe fjalë me qëllim për t`ua përshtatur ato nevojave, aftësive, mundësive dhe kërkesave të nxënësve.

Lidhur me individualizimin e mësimin në përshtatje të aftësive dhe mundësive të zhvillimit të nxënësit, kemi të bëjmë me përshtatjen e përmbajtjeve, teknikës e teknologjisë mësimore, tempit dhe ritmit të përparimit të nxënësve, varësisht nga vetitë dhe mundësitë psikofizike në zhvillim të personalitetit të tij (Brada, 2010: 53).

Përvojat pedagogjike, si dhe arritjet e psikologjisë zhvillimore, dëshmojnë se nxënësit dallohen ndërmjet vete aq, saqë nuk mund të gjenden dy sish me aftësi dhe veti të njëjta fizike dhe shpirtërore (Brada, 2010: 245). Ata dallohen edhe nga funksioni i shqisave, nga zhvillimi psikosocial, nga mënyra e të nxënësve etj., kështu që me gjithë dëshirën për socializëm intensiv dhe trajtim të barabartë të nxënësve, prapë atyre mund t'u bëhet padrejtësi e madhe nëse vërtet trajtohen në mënyrë të barabartë në procesin mësimor (Po aty: 245).

Mësimi i individualizuar ka të bëjë me përshtatjen e punës mësimore sipas nxënësit konkret (Zylfiu, 2011: 64). Për t'iu përshtatur sa më mirë veçorive individuale të nxënësve gjatë mësimdhënies, mësimdhënësi ka parasysh angazhimin e tij për njohjen sa më të plotë dhe të gjithanshme të çdo nxënësi.

Lidhur me përshtatjet e mësimdhënies ndaj veçorive individuale të nxënësve, gjatë përvojës sonë shumëvjeçare në mësimdhënie, jemi ballafaquar me nxënës të ndryshëm, si për nga aftësitë psikofizike, psikosociale etj. dhe çdoherë jemi munduar që pranë tyre të jem njeriu që më së miri dhe më së lehti i kupton nevojat, kërkesat dhe aftësitë e tyre individuale. Për të qenë më i qartë, gjatë përvojës sime, kam pasur nxënës me aftësi të ndryshme psikofizike dhe psikosociale. Në mesin e klasës kam pasur një nxënëse me problem në të parë dhe një nxënëse me probleme psikosociale. Nxënësen, e cila ka pasur probleme në të parë, vazhdimisht e kam ulur në bankën e parë apo në grupin që ka qenë më afër tabelës dhe më afër dritës apo dritareve. Në këtë rast, vazhdimisht kam qenë i vëmendshëm edhe kur shkruaja në tabelë, duke i theksuar vijat me shkumës si dhe duke e përdorur ngjyrën e kaltër, ngase këtë ngjyrë e dallonte më mirë.

Me nxënësen tjetër, si rast psikosocial, në fillim kam pasur pak vështirësi lidhur me vlerësimin e sjelljes së saj, përderisa gjyshja e saj më shpjegoi shkaqet, shkurorëzimi i prindërve të mbesës së saj, si pasojë e problemeve sociale. Pasi mora informacionin e duhur dhe kuptova për gjendjen psikosociale të fëmijës, atëherë e kisha shumë më lehtë për t'iu përshtatur kërkesave sociale dhe veçorive individuale të saj, duke e vënë atë në situata të lakmueshme, duke e ledhatuar, duke e lavdëruar dhe duke e vlerësuar sipas situatave. Me një angazhim të palodhshëm dhe me një përshtatje të veçorive dhe kërkesave individuale të nxënëses në fjalë dhe me një bashkëpunim të mirëfilltë me familjen e saj, pas një viti shkollor, kam arritur që tek ajo të krijoj një sjellje normale, sikurse në shkollë ashtu edhe në shtëpi, ndaj për këtë kam marrë falënderime edhe nga prindërit e saj të shkurorëzuar.

Mësimdhënësi i mirë, dallohet me kulturën dhe aftësitë profesionale e pedagogjike të tij, njeh dhe respekton aftësitë psikofizike të nxënësve, ndryshimet dhe dallimet moshore, gjinore, nevojat, prirjet, dëshirat etj., duke përshtatur dhe duke përdorur drejt teknikën dhe teknologjinë mësimore (Brada, 2010: 157).

### *3.1.10. Mësimdhënësit e shekullit XXI kreativë dhe nxitës të të nxënësve*

Nevoja për ndryshime të shumta në shekullin XXI është shumë e madhe, siç ka qenë edhe më parë dhe do të jetë edhe në të ardhmen, e sidomos kur është fjala për ndryshimet në arsim.

Të pajisësh nxënësit me aftësi dhe kompetenca të nevojshme në shekullin XXI, është një barrë e rëndë e mësuesve të mbarë botës, të cilët vazhdimisht përdorin një

shumëllojshmëri të praktikave të mësimdhënies, për të arritur atë më të mirën (Nie, 2013).

Mësimdhënësit inovatorë, gjithëherë kanë tendencë për të karakterizuar atributet e mësuesve efektivë dhe, në veçanti, zhvillimin e vlerave, njohurive dhe aftësive për të mbështetur reflektimin në praktikë (Frick, Karl, & Beets, 2010: 422).

Shkollat në shekullin XXI dinë të përshtatin programin edukativo–arsimor për t’i plotësuar nevojat e nxënësve, të zhvillimit dhe interesave të tyre, që do të ndikojë shumë mbi atë se çfarë do të ligjërohet dhe çfarë do të mësohet. Përmbajtja bazohet mbi interesat e tyre dhe është balancuar sipas njohjes së nxënësve dhe sipas hulumtimeve shkencore për zhvillimin e nxënësit

([http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Krijimi\\_i\\_mjedisit\\_p%C3%ABr\\_t%C3%AB\\_nx%C3%ABnit\\_p%C3%ABr\\_shekullin\\_XXI.pdf](http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Krijimi_i_mjedisit_p%C3%ABr_t%C3%AB_nx%C3%ABnit_p%C3%ABr_shekullin_XXI.pdf)).

Në shekullin XXI, kemi nevojë për mësimdhënës, të cilët mund të zgjidhin probleme komplekse, siç është hulumtimi i teknikave efektive për kryerje më të mirë të procesit të mësimdhënies. Këtë duhet ta kuptojnë të gjitha palët e përfshira në procesin edukativo-arsimor, sikurse ata që e krijojnë politikën e arsimit, ashtu dhe ata të cilët janë të inkuadruar në mësim, si: mësuesit, nxënësit dhe prindërit.

([http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Krijimi\\_i\\_mjedisit\\_p%C3%ABr\\_t%C3%AB\\_nx%C3%ABnit\\_p%C3%ABr\\_shekullin\\_XXI.pdf](http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Krijimi_i_mjedisit_p%C3%ABr_t%C3%AB_nx%C3%ABnit_p%C3%ABr_shekullin_XXI.pdf)).

Mësimdhënia e shekullit XXI përfaqëson idenë për mësim të individualizuar, i cili i respekton aftësitë dhe përpyjekjet e secilit fëmijë, duke kuptuar më drejt, më qartë dhe më mirë atë që mësohet. Mësimdhënia inovative e shekullit XXI është e drejtuar nga e ardhmja e fëmijës dhe shoqërisë.

“Mësimdhënia u përshtatet gradualisht ndryshimeve të pashmangshme që vijnë si rezultat i zhvillimit të shkencës, teknikës dhe shoqërisë” (Mailaret, 1997: 61). Kjo përshtatje duhet parë në tërësinë e përbërësve aktivë, që do të thotë se përshtatja do të jetë e mbështetur tek zbulimi teknik e teknologjik në shërbim të individit dhe shoqërisë.

Përmbajtjet mësimore të shekullit XXI i bëjnë fëmijët aktivë, që të bashkëpunojnë mes vete për të zgjidhur probleme gjatë aktiviteteve mësimore, duke u varur nga dëshirat dhe interesat e nxënësve se sa janë të interesuar dhe sa është tërheqëse ajo për ta.

Mësimdhënësit inovatorë të shekullit XXI nuk janë ligjërues që ua marrin kohën nxënësve, por ata janë fasilitatorë (lehtësues) dhe udhëheqës të mirë në procesin e të nxënësve. Ndërkaq, për t'i socializuar nxënësve gjatë aktiviteteve mësimore në klasë, ata krijojnë grupe të vogla punuese, përmes të cilave nxënësve ia dalin më mirë dhe më sigurt në zgjidhjen e problemeve.

Në përkrahje të sfidave të ndryshme, mësimdhënia funksionon si mundësi e cila mund të jetë në favor të nevojave dhe kërkesave të nxënësve, duke ofruar eksperiencë më të ndryshme, me anë të të cilave do t'u ndihmohet në zhvillimin e tyre social, intelektual, fizik dhe emocional në mënyrë të përshtatshme për nivelin e zhvillimit të tyre.

Mësimdhënësit inovatorë të shekullit XXI:

- Aftësojnë nxënësve për të mësuar gjatë gjithë jetës së tyre;
- Sigurojnë kushte për zhvillimin e aktiviteteve praktike në klasë dhe jashtë saj;
- Krijojnë mjedis demokratik në klasë;
- Krijojnë kushte të përshtatshme për secilin nxënës për përfitimin e aftësive individuale teorike dhe praktike;

- Krijojnë klasë ku në qendër të vëmendjes është nxënësi;
- Motivojnë nxënësit për të nxitur metoda aktive të të nxënit;
- Krijojnë bashkëpunim të ngrohtë me prindërit, komunitetin e më gjerë;
- U ofrojnë nxënësve burime të ndryshme diturie nga brenda dhe nga jashtë;
- Mbështesin nxënësit në mendimet e tyre individuale;
- Krijojnë dosje për secilin nxënës;
- Stimulojnë fëmijët të marrin iniciativë për organizime individuale dhe grupore;
- Krijojnë kushte të atilla që çdo fëmijë do të ndihet i lumtur në shkollë;
- Krijojnë kushte në të cilat çdo fëmijë mund të shprehet lirshëm dhe pa frikë.

Në klasën e shekullit XXI, do të jetë mëlehtë edhe për nxënësit edhe për mësuesin, ngase kanë mundësi për të zgjedhur më shumë opsione, si: mjete, metoda, forma, teknikë dhe teknologji mësimore.

Për më tepër, jo të gjithë jemi të qartë se në ç`mënyrë shkollat do t`u përgjigjen realisht kërkesave të ndryshimeve të kohës. Por, për dy gjëra të gjithë biem dakord: shkollat të ofrojnë shanse të barabarta për të gjithë dhe të jenë cilësore (Nathanaili, 2013: 44). Vetëm në këtë mënyrë mund të mbështetemi në shkollën e cila do të krijojë cilësi në mësimdhënie, stimulim të nxënësve për nxënie dhe besim të plotë tek prindërit dhe komuniteti.

Si përfundim mund të themi se: “Të gjithë mësuesit dhe prindërit të punojnë me përkushtim që të vetëbëhen edukatorë të pandalshëm të nivelit më të lartë të shekullit 21” (Vuji, 2015: 156).

Mësimdhënësi i së ardhmes, u krijon mundësinë nxënësve për t`u integruar sa më shpejt dhe në kushte sa më të mira, si synim kryesor për t`iu përshtatur ndryshimeve sociale.

Sot nga mësimdhënësi nuk kërkohet më vetëm zotërim të orës mësimore, por ai ka për mision të përgatitë gjeneratat e reja me shprehitë për ta kërkuar informacionin e ri, për të operuar me të, në kushtet e mosnjohjes së tij, për ta analizuar, e në mënyrë kritike edhe për të aftësuar nxënësit që të jenë në gjendje vetë të zgjidhin probleme (Musai, 2003: 12).

Puna e mësimdhënësit është e vështirë, por përpara se të jetë e tillë “atij i duhet të jetë në radhë të parë njeri dhe mësuesi të arrijë ta bëjë nxënësin nxënës, se, pa e realizuar këtë, ai nuk është në misionin e tij” (Kraja, 2009: 261). Nga puna e mësuesit në kompleks varet gjendja e çdo shkolle, sidomos cilësia e punës mësimore edukative (Po aty: 261).

Karakteristikë thelbësore e mësimdhënësit është se i ndihmon nxënësit në vërtetësinë e brendshme pozitive, nëpërmjet të nxënit, që të mësojnë dhe të punojnë si një familje e përbashkët. Ky bashkëpunim ofron përvoja unike të të nxënit për nxënësit dhe pa ashtu u ofron nxënësve që të mësojnë nëpërmjet proceseve të të folurit dhe të dëgjuarit, si dhe nëpërmjet proceseve të të lexuarit dhe të të shkruarit (Musai, 2003: 130).

Mësimdhënësi kreativ, di se disiplina e ndërgjegjshme në orët e mësimimit nuk vendoset me ndëshkime, as me frikën e notës e as me kërcënime, por vetëm me nxitje dhe bindje. Andaj, karakteri i vetëdijshëm dhe metoda e bindjes, shprehin orientimin e gjithë punës dhe të marrëdhënieve mësimdhënësi-nxënës, për një bashkëpunim të lirë në zbatimin e detyrave dhe të të drejtave të të dy palëve.

Sot bota po ndryshon gjithnjë e më shpejt. Njerëzit vazhdimisht flasin se arsimi mund të ndryshojë për t'iu përgjigjur nevojave të tregut ndërkombëtar. Më saktë, me



këtë ndryshim, kuptojmë se, ashtu siç ndryshon bota, ashtu duhet të ndryshojë mësimdhënësi, planprogrami mësimor dhe shkolla (<http://toolbox.pep.org.mk/Files/>).

Roli i mësimdhënësit inovator është kryesisht që t'i orientojë, t'u ndihmojë dhe të mbështetë përpjekjet e nxënësve për fitimin e diturive dhe shkathtësive të reja mësimore.

“Mësuesi dhe nxënësi janë dy bashkëpunëtorë të ngushtë gjatë gjithë viteve të shkollimit. I pari është drejtuesi; i dyti, duke punuar nën drejtimin e mësuesit, do të përvetësojë njohuritë, shkathtësitë, shprehitë që përcaktojnë programet mësimore” (Kraja, 2012: 244). Patjetër që si qëllim parësor i mësimdhënësit inovator, është kreativiteti dhe nxitja e nxënësve për aktivitete pune në klasë dhe jashtë saj.

Mësimdhënësi kreativ, kupton se si nxënësit u përgjigjen aktiviteteve mësimore, obligimeve shkollore dhe shtëpiake, si zhvillohen dhe si zgjidhin problemet në momente kur ata ballafaqohen me to. Mësuesi, si njeriu i dytë pas prindit, mbështet dhe ndihmon zhvillimin psikofizik, personal, moral, social dhe intelektual të fëmijëve. Mësimdhënësi kreativ, në momentet kyç të thyerjes së monotonisë së nxënësve në klasë, pa dyshim përdor strategji të ndryshme të mësimdhënies, duke ditur t'i stimulojë ata për t'i inkurajuar në zgjidhjen e problemeve në klasë.

Përpos mësimdhënësit, që ndikon pozitivisht në nxitjen nxënësve për mësim, ka edhe shumë faktorë të tjerë që nxisin nxënësin për të mësuar dhe për ta dashur shkollën. Një ndër ta mund të jetë edhe libri me përgatitjen e tij grafike dhe teknike, i shkruar me stil të gjallë, të lehtë dhe tërheqës, i mbushur me shembuj të ndryshëm e interesantë, me ilustrime, fotografi etj. Nxitje tjetër për nxënësit në arritjen e rezultateve më të mira në mësim, është edhe pasurimi i shkollës dhe klasës me mjete didaktike, me qëllim që të

zgjohje dëshirën e fëmijëve për vijueshmëri të rregullt në shkollë dhe për nxënie të suksesshme.

Marrë në përgjithësi, nxënësit kanë nevojë për punë individuale dhe të individualizuar, për t'iu përshtatur më lehtë përmbajtjeve mësimore, detyrave, teknikave dhe teknologjive mësimore sipas nevojave, interesave, prirjeve dhe mundësive psikofizike të tyre (Brada, 2010: 397).

Për t'u arritur më lehtë dhe më shpejt një përshtatshmëri e tillë, shumëçka varet prej qëndrimit të mësimit dhe nxënësve. I gjithë rezultati rrjedh në formë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga qëndrimi i të dyja palëve. Por, çdoherë si palë e parë për të nxitur aktivitete pune në klasë, është mësimit, sepse timoni është në duart e tij dhe ai është personi kryesor që di të bëjë zgjedhjen e rrugës më të mirë për t'u arritur më lehtë dhe më shpejt rezultatet e pritshme.

Mësimit kreativë asnjëherë nuk e teprjnë me ligjërata të stërzgjatura dhe monotone në klasë. Ata vazhdimisht krijojnë një laramani pune në klasë, duke përshtatur teknika tërheqëse dhe stimuluese për nxënës. Sipas nevojës, ata përdorin edhe humor të lehtë që e bën nxënien më atraktive, krijojnë hapësirë edhe për lojë me karakter edukativ, bashkëpunojnë me nxënës në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në klasë dhe shpeshherë kalojnë edhe në rolin e fëmijëve, duke u socializuar me ta.

Mësimit kreativë vazhdimisht i nxisin nxënësit për punë me oratori të mbushur me ilustrime dhe shembuj të ndryshëm, si formë e adhuruar nga nxënësit, me qëllim që ora mësimore të bëhet më interesante dhe bindëse për nxënësit. Mësimit kreatorë, për ta bërë tërheqëse orën mësimore, shtojnë edhe mjetet ndihmëse vizuale. Këtë e pohon edhe shkencëtarë, kur thotë: “Njerëzit shqisave të të parit u

kushtojnë vëmendje njëzet e pesë herë më shumë sesa atyre të të dëgjuarit” (Carnegie, 2005: 132).

Mësimdhënësit janë njerëzit që më së shumti ndikojnë drejtpërdrejt tek nxënësi, si në mënyrën e të mësuarit, disiplinën dhe suksesin e arritur. Të gjitha këto mund të shihen me një sy sa kritik aq edhe mbështetës dhe dashamirës, në mënyrë që nxënësit tanë ta kenë shkollën një nga ambientet më të dashura të periudhës në të cilën e ndjekin (Skinner, & Belmont, 1993: 27).

### *3.1.11. Mësimdhënësit inovatorë motivues dhe model për nxënie të suksesshme*

Rëndësia e motivimit, si një ndikim pozitiv në të mësuarit, është e njohur si faktor shumë i rëndësishëm, që ndikon dukshëm në angazhimin e nxënësve gjatë procesit të të mësuarit (DeLong, Winter, dhe Yackel, 2004; Mayer, 2001).

“Detyra e mësuesit është t`i tërheqë nxënësit në veprimtari të tilla, që, në njëfarë mënyre, t`i çojë ata tek dëshira për të mësuar” (Musai, 2003: 215).

Një ndër mundësitë për motivimin e nxënësve për aktivitete pune në klasë, sipas Aleksandër Xhuvanit, “Mësimi duhet zhvilluar në mënyrë të atillë që të jetë interesant për nxënësit e çdo moshe” (Kraja, 2012: 189).

Mësimdhënësi është motivuesi dhe eksperti më i mirë në shkollë. Ai, me aftësitë profesionale që ka, vazhdimisht motivon nxënësit gjatë aktiviteteve mësimore, me qëllim për të korrur rezultate më të mira gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies.

Fëmijët më së shumti kanë nevojë të marrin vlerësime pozitive nga ata njerëz që janë të rëndësishëm për ta (Tamo, Karaj, Rapti, 2005: 296). Andaj, gjithsesi që mësimdhënësi është motivuesi kryesor i fëmijëve.

“Çdo veprimtari e njeriut reflekton një sjellje të motivuar drejt një qëllimi” (Zajazi, 2003: 750). Edhe vetë jeta e njeriut, për të jetuar, ka një motiv, e motivi i saj është puna, sikurse që motivuesi i nxënësit për të nxënë është mësimitdhënësi. Nëse nxënësi ka nxitës të marrë një sjellje që është e drejtuar në qëllim të nxënies, njëherësh ai është i prirur të marrë qëndrim pozitiv dhe gatishmëri për të marrë edhe përgjegjësi ndaj obligimeve të saj, sikurse që ndien nevojë për dije, ka interes ndaj mësimit, i bën detyrat, e do leximin, merr iniciativa, bën përpjekje të asimilojë gjithçka që i ofron shkolla (Po aty: 749).

“Zakonisht, motivimi paraqitet si diçka që i jep nxitje, energji dhe drejtim sjelljes së njeriut. Motivimi është gjithçka që i shtyn njerëzit të veprojnë” (Musai, 2003: 215). Motivimi i nxënësve për të nxënë është një aftësi që duhet të posedojë secili mësimitdhënësi, pasi që kjo i nxit nxënësit të veprojnë dhe të jenë më aktivë gjatë aktiviteteve mësimore.

Në disa raste nxënësit janë mjaft aktivë, por në disa raste të tjera, pasiviteti i tyre bëhet mjaft shqetësues. Për t`i mbajtur nxënësit aktivë, mësimitdhënësi zbaton teknika të reja, tërheqëse dhe të larmishme, por jo tek të gjithë nxënësit ndikon i njëjti motiv, andaj mësimitdhënësi di t`i motivojë nxënësit sipas asaj që është më e arsyeshme dhe më e nevojshme për të ditur. Si mjete të nxitjes mund të jenë edhe mirënjohja, premtimi, lëvdata, shpërblimi, garat, vlerësimi numerik etj. (Krasniqi & Deva-Zuna, 2012: 165).

Lidhur me motivimin e nxënësve për të nxënë, mësimitdhënësi zbaton forma e metoda inovatore të shumëllojta. Njëra ndër ato forma është edhe forma e të vlerësuarit të nxënësit, duke pasur parasysh se një formë e gabuar e të vlerësuarit mund ta shkatërrojë përjetësisht nxënësin, ndërsa forma e drejtë e të vlerësuarit të nxënësve, ndikon që tek ta të krijojë besim, dashuri dhe respekt ndaj shkollës (Musai, 1999: 25).

“Për ta inkuadruar një fëmijë që të ndizet vetë, ndoshta do ta shpërbleni apo t’i ofroni ndonjë shpërblim, paralel me një dozë të shëndetshme lavdërimesh dhe inkurajimi” (Sears, 2011: 209). Për të shtuar vëmendjen e nxënësve për aktivitete pune në klasë, fëmijët lavdërohen deri në atë masë sa janë në gjendje ta kuptojnë se me të vërtetë atë e kanë merituar, mirëpo asnjëherë nuk bën ta teprojmë me lëvdata, sepse mund të kalojnë në jobesueshmëri.

Për një mësimdhënie të suksesshme, faktori më i rëndësishëm është të sigurohet mësimdhënësi se nxënësit mbështeten dhe nxiten për të nxënë duke u transmetuar shpresa pozitive (Musai, 2003: 218). Me këtë mund të kuptojmë se ndihma dhe shpresa e mësimdhënësit, gjithnjë duhet të tingëllojnë pozitivisht tek nxënësit.

Një ndër metodat e tjera shpresëdhënëse, që nxisin nxënësin në mësim, është edhe futja e risive dhe krijimi i laramanive gjatë procesit të mësimdhënies, sigurimi i informatave të shpejta kthyese, nxitja e kureshtjes, lidhshmëria e asaj që mësohet me përvojën dhe jetën personale të nxënësit etj. (Ismaili, 2013: 157).

Motivimi është një shkas kryesor për kreativitet (Williamson, 2003 & Payton, 2009).

Sfidat e mësimdhënësve të ardhshëm, në dukje janë të ngjashme me sfidat e mësimdhënësve të sotëm, ose janë sfidat me të cilat brezat janë ndeshur gjithmonë. (Deci, E. L., & Ryan, R. M., 1985: 33).

Mësimdhënësi është model, ngase shpeshherë shndërrohet në model për nxënësit, si për veshjen, për të folurit, për njohuritë, për pikëpamjet etj., andaj, të gjitha këto mbeten si shembull apo model tek ta për një kohë të gjatë (Kraja, 2012: 30).

Është e nevojshme dhe e moralshme që mësimdhënësi tek nxënësit gjithherë t’i bartë vetitë pozitive, nga të cilat mund të marrin dhe t’i zbatojnë gjatë jetës së tyre të

përditshme. Është mirë të dihet se mësimdhënësit e së sotmes dhe të së ardhmes, asnjëherë nuk duhet të bëjnë veprime jo të mira, të cilat shumë lehtë mund t'i kapë nxënësi dhe t'i zbatojë ato si veti normale. Mësimdhënësit e së ardhmes jo vetëm në shkollë, por kudoqofshin ata, janë modele për një shoqëri bashkëkohore.

“Shumë shpesh ndodh që mësuesit të habiten, kur dëgjojnë fjalët e tyre që përsëriten nga nxënësit” (Zhitija, 2011: 77). Kjo ndodh, sepse mësimdhënësit, nëpërmjet pyetjeve, komenteve, organizimit të aktiviteteve mësimore dhe stilit të punës, vazhdimisht janë në rolin e modelit për nxënësit e tyre dhe shpesh ndodh që nxënësit t'i bartin vetitë pozitive të mësimdhënësve, por ndodh që nganjëherë t'i bartin edhe vetitë negative, nëse ato i ka mësimdhënësi i tyre.

### **3.2. Dallimet mes mësimdhënësve tradicionalë dhe mësimdhënësve inovatorë**

Karakteri dhe funksioni i shkollës gjithnjë ka ndryshuar, duke ecur në hap me kohën dhe në raport me nevojat e shoqërisë. Kështu, siç ndryshonte shoqëria, ashtu ndryshonte edhe shkolla.

Vigotski ishte shumë i interesuar për të nxënë nën drejtimin e mësuesit dhe për çdo përvojë strukturoese të mbështetë të nxënit e një personi tjetër (Woolfolk, 2011: 49).

Sikurse çdo profesion tjetër, që ka pasur ndryshime të kohëpaskohshme, po ashtu edhe ushtrimi i veprimtarisë së mësimdhënësve ka pësuar ndryshime, është duke ndryshuar dhe gjithmonë do të ndryshojë. Mësimdhënia nuk është thjesht një profesion, por ajo është art, në të cilin mësimdhënësi me pasionin e tij për dijen dhe përgatitjen e

tij profesionale, arrin t'i frymëzojë nxënësit e vet në arritjen e qëllimit për t'u ballafaquar më drejt dhe më lehtë me veprimtaritë praktike mësimore.

Mësimdhënësi tradicional dhe ai novator, me gjithë avancimet e mëdha shkencore, në esencë janë të njëjtë, por funksionimi, metodologjia dhe infrastruktura shkollore kanë ndryshuar shumë.

Në pajtueshmëri me zhvillimin e hovshëm dhe të shpejtë tekniko-teknologjik dhe zhvillimin shkencor të shoqërisë, gjithnjë po gjurmohen modele dhe forma të reja, të cilat do t'i kundërvihen modelit arsimor tradicional dhe do të kontribuojnë për të mirën e gjeneratave të reja.

Në raportin e Komisionit të Komunitetit Evropian (2005), (Parimet e përbashkëta evropiane për kompetencat dhe kualifikimet e mësimdhënësve), theksohet se “Mësuesi nuk mund të jetë zbatues mekanik, por duhet të angazhohet në veprime që janë rrjedhojë e shqyrtimit të kujdesshëm të natyrës së detyrës mësimore”.

Për realizimin e detyrës mësimore, mësuesi nxitet që të zbatojë metoda mësimore bashkëkohore, të cilat integrojnë dhe balancojnë rrishtë dhe hulumtimet për gjetjen e strategjive të reja mësimore, teknologjive të të nxënësve dhe burimeve të botës reale (Komisioni i Komunitetit Evropian, 2005).

Futja e mjeteve të reja dhe zbatimi i teknikave bashkëkohore në mësimdhënie, është një mundësi kalimi prej një mësimdhënieje tradicionale në një mësimdhënie bashkëkohore, duke pasur parasysh se teknologjia e arsimit mundëson aplikimin e mësimdhënies alternative, siç janë: mësimi i programuar, mësimi i punës në grupe, mësimi nga distanca, mësimi duke përdorur TV-në, mësimi duke përdorur filmin, radion, mësimi me anë të CD-ve, kompjuterët në mësim, mësimi kabinetit etj.

Në këtë kuadër, modernizimi shkencor dhe pedagogjik i procesit mësimor, është i lidhur edhe me luftën kundër të mësuarit mekanik dhe pasiv (Kraja, 2012: 210).

Mësuesit bashkëkohorë vazhdimisht mendojnë dhe kontribuojnë për të ardhmen e shoqërisë së dijes. Sipas John Dway: Është e pamundur të profetizohet në mënyrë kategorike se si do të jetë qytetërimi njëzet vjet më vonë (Kraja, 2012: 294). Është e vështirë për t'u përcaktuar për një gjë të tillë, por së paku politikbërësit dhe mësuesit, e kanë për obligim moral, qytetar dhe profesional të kontribuojnë në reformimin e arsimit.

Ndryshimet mes mësimit tradicional dhe inovator:

*Mësimdhënia tradicionale:*

- Mjeti i ligjërimit është zëri i mësimit;
- Bankat janë të palëvizshme;
- Nxënësit çdoherë flasin me lejen e mësimit;
- Mësimdhënësi ligjëron, përderisa nxënësit dëgjojnë me vëmendje;
- Mbështetet në logjikën e të rriturve;
- Mësimdhënësi autoritar;
- Mësimdhënia frontale;
- Shpesh zbatohet edhe mësimi mekanik;
- Ndëshkimi fizik i nxënësve;
- Nxënësit ngrihen në këmbë kur përgjigjen;
- Shpesh injorohet qëndrimi kritik i nxënësve;
- Disiplina dhe dhuna në klasë janë të pranishme;
- Hakmarrje gjatë vlerësimit me notë etj.



*Mësimdhënia inovative:*

- Nxënës i lirë dhe aktiv në klasë;
- Formon zhvillim të lirë të fëmijës;
- Punë e paimponuar;
- Mësimdhënësi joautoritar;
- Aktivizon pothuajse të gjitha shqisat e fëmijëve;
- Krijon një klasë të vërtetë pune;
- Mësimi është i lirë dhe mjaft atraktiv;
- Nxënësit ndihen të lirë kur mësimdhënësi është në klasë;
- Bankat dhe karriget janë të lëvizshme;
- Mësimdhënia organizohet në kabinete, punëtori, në natyrë etj.;
- Mësimdhënësi bashkëpunëtor i ngrohtë dhe i afërt me nxënës;
- Mësimi krijues etj.

Për këtë dhe arsye të tjera, dallimet mes mësimdhënësve tradicionalë dhe mësimdhënësve inovatorë, janë aq të mëdha, sa sot pedagogët bashkëkohorë, që merren me studimin e problemit të mësimdhënies, nuk e përjashtojnë pyetjen se a na duhet mësimdhënësi, por, shtrohet si çështje e kohës se për çfarë profili të mësimdhënësit kemi nevojë, ndërsa sipas Mislimit: mësimdhënësi mund të jetë krijues i mësimi dhe edukimit, e jo tekst që ecën ose enciklopedi që flet (2005: 91).

Për sa u përket dallimeve ndërmjet mësimdhënësve tradicionalë dhe atyre inovatorë, mund të themi se dallimi është aq i madh dhe ata janë aq të ndryshëm nga njëri-tjetri, saqë nganjëherë mund ta pyesim veten: Vallë, a thua do të kishte fare kuptim, nëse ende do të punohej sipas stilit të vjetër tradicional, krahas gjithë këtyre

ndryshimeve që janë duke ndodhur në reformën e arsimit? Jo, assesi. Sepse, nëse i njohim mirë anët pozitive të mësimdhënies bashkëkohore, shumë lehtë është të kuptojmë se vetëm përmes saj, mund të arrijmë rezultate më të mira për nxënësit dhe shoqërinë.

Mësimi i inovuar nuk është vetëm vizion i së ardhmes, por edhe kërkesë e së tashmes dhe domosdoshmëri e kohës, andaj edhe shtrohet nevoja për risi të larmishme dhe futje të teknologjisë në mësim, e cila duhet trajtuar jo vetëm si nevojë momentale, por si detyrë e procesit mësimor (Murati, 2002: 291).

Mësimdhënësi inovator është iniciator kyç i ndryshimeve dhe risive në procesin mësimor si dhe bartës i novacioneve në mësim.

Modeli tradicional i mësimdhënies nënkupton procesin e dhënies së njohurive në mënyrën që mësimdhënësi u shpjegon nxënësve atë që ai mendon se nxënësi duhet të dijë, “kështu që mësimi në mjaft raste kthehet në një monotoni, ku nuk shfrytëzohet aktiviteti dhe përjashtohet bota plot gjallëri dhe fantazi e nxënësit” (Kraja, 2012: 209).

Sipas modelit inovator, mësimdhënia është një proces bashkëveprimi dhe bashkëmarrjeje vendimesh. Në përgjithësi, “mësimi është aktiv atëherë kur vënia përballë mësuesit, nga njëra anë, dhe e nxënësit, nga ana tjetër, zbutet, duke u transformuar në një bashkëpunim” (Po aty: 209).

Një ndër faktorët që mund të ndryshojnë procesin e mësimdhënies dhe reformën në arsim janë politikëbërësit, gjendja ekonomike e vendit, gjendja financiare e mësimdhënësve, morali i mësimdhënësve, trajnimi i mësimdhënësve, roli i tyre në klasë si pedagogë, aktorë, misionarë dhe vlerësues të mirë dhe shumë e shumë faktorë të tjerë. Ajo që mësimdhënësin e bën faktor kryesor, që mund të sjellë ndryshime pozitive në

shkollë, është vetëbesimi në aftësitë e tij profesionale, morali i lartë për të ndryshuar dhe guximi për të bërë një gjë të tillë.

Mësimdhënësi i ndodhur në midis tradicionales, së tashmes dhe së ardhmes, jeton në dilemën nga të shkojë, në mënyrë që t'u përshtatet zhvillimeve të reja, pa e harruar të kaluarën, duke punuar për të tashmen, me synim për të ardhmen.

“Dilemat janë nga më të ndryshmet, sepse jetojmë në shekullin XXI” (Ismaili, 2013: 86), në shekullin që ende në disa shkolla ndryshimet pranohen me mjaft kontradikta në mes të tradicionales dhe bashkëkohores.

Mësimdhënësit e së ardhmes krijojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e vlerave, të qëndrimeve dhe shkathtësive të nxënësve, në mënyrë që njohuritë e përvetësuara t'i shfrytëzojnë e t'i zbatojnë në situata të ndryshme të jetës së tyre, duke mbajtur parasysh gjithnjë dinjitetin e vet njerëzor dhe të tjerëve për mirëqenien vetjake dhe shoqërore, pa vënë në rrezik funksionimin demokratik të shoqërisë dhe mjedisin (Korniza e kurrikulës së re të Kosovës, 2001: 16).

Mësimdhënësit e së ardhmes janë inteligjentë, ekspertë të përsosur, organizatorë, arkitektë, projektues dhe realizues të suksesshëm të zbatimit të formave të reja mësimore. Janë promotorë dhe iniciatorë të reformave shkollore si dhe janë bartës kryesorë të zhvillimit dhe përparimit të gjeneratave të reja.

Përderisa mësimdhënësit tradicionalë, nxënësit i angazhonin dhe i mundonin me ligjërata të gjata dhe monotone, mësimdhënësit e së ardhmes angazhohen t'i aktivizojnë nxënësit me punë efektive në klasë.

Për ta bërë shkollën më tërheqëse për nxënësit, mësimdhënësit e së ardhmes dinë të ndryshojnë sjelljet e tyre ndaj nxënësve në zbatimin e metodave, formave, mjeteve

dhe teknikave të ndryshme dhe interesante, që ato të ndikojnë në stimulimin e fëmijëve për ta dashur më shumë shkollën.

Mësimdhënësit inovatorë:

- Vlerësojnë mënyrën e të vlerësuarit;
- Inkurajojnë nxënësit të bëjnë pyetje rreth problemeve;
- Kanë raporte pozitive me nxënësit dhe anasjelltas;
- Përdorin metoda, teknika dhe forma të reja të punës;
- Janë të qartë, realë dhe të qetë gjatë zgjidhjes së konflikteve në klasë;
- Dramatizojnë shpjegimet përmes dialogut;
- Gjallërojnë shpjegimet në kombinim të mjeteve audiovizuale etj.

Nga kjo mund të kuptojmë se ”njeriu të edukohet i lirë, me edukatë dhe kulturë demokratike” (Kraja M., Çela, Mustafa, Kraja E. 2013: 42), që do të thotë se mësimdhënësi i së ardhmes fëmijëve u jep aq sa ata janë në gjendje të pranojnë, e që më pas të jenë të aftë ta praktikojnë atë.

Mësimdhënësit bashkëkohorë janë mësimdhënës globalë, të aftë të konceptojnë botën në dinamizmin e saj dialektik shumëdimensional, të aftë ta ndiejnë veten si pjesëtarë të barabartë dhe të shqetësohen për problemet e saj, të aftë të veprojnë për ta bërë atë një botë më të mirë e më të drejtë (Musai, 2012: 295). Për ta bërë një gjë të tillë, mësimdhënësi është personi kryesor që më së miri di të bëjë një ndërhyrje të nevojshme, duke i orientuar nxënësit drejt një të ardhmeje më të sigurt, nga e cila varet shumë edhe zhvillimi dhe përparimi i një vendi.

Mësimdhënësit inovatorë, vëmendjen e drejtojnë në rrjedhën e mësimin të mirë, që gjithmonë ka nevojë për t'u marrë me çështjet e qëllimit të përmbajtjes (Biesta, 2012).

### **3.3. Modele dhe teknika inovative në mësimdhënie**

Për sa u përket modeleve inovative të mësimdhënies, në përgjithësi, mësimdhënësit pothuajse kanë filluar të lëvizin në drejtim të mbarë.

Në shkollat tona tanimë po ndodhin ndryshime, si në mësimdhënie, vlerësim, teknologji, hulumtim, eksperimentim, infrastrukturë etj.

Përmes modeleve të reja të mësimdhënies, nxënësit nxiten të fitojnë njohuri të qëndrueshme dhe të zbatueshme, ngase disa nga modelet e reja të mësimdhënies, janë interesante, konkrete dhe tërheqëse për nxënësit.

Përmes modeleve dhe teknikave të reja të mësimdhënies, nxënësit jo vetëm që i mësojnë dhe i kuptojnë më lehtë e më shpejt përmbajtjet mësimore, por ata gjithsesi janë të përgatitur më mirë edhe për sfidat që i presin.

Mësimdhënësit shpesh nxiten nga IT-të (Institucionet e Arsimit) për të zbatuar forma të reja të mësimdhënies, për të garantuar se u përgjigjen interesave dhe aftësive të ndryshme të nxënësve, edhe pse mësimdhënësit janë të kufizuar në mënyrat që mund të përdorin për shkak të aftësive dhe interesave të kufizuara të nxënësve, numrit të madh të nxënësve në klasë, kufizimeve të hapësirës në klasë, njohurive të pamjaftueshme paraprake për mënyra të reja të mësimdhënies, llojit të mjeteve të teknologjive në dispozicion etj. (Marsh, 2009: 63).

Mësimdhënësi di të menaxhojë klasën drejt, duke zbatuar mënyrën apo modelin e mësimdhënies më të mirë të mundshme, por “për mësuesit sfida qëndron në aftësinë për të ndërtuar një model hipotetik të botëve konceptuale të nxënësve, edhe pse këto botë mund të jenë shumë më të ndryshme nga ajo që nënkupton mësuesi” (Fosnot, 1996: 26).

Mësimdhënësit inovatorë, në të shumtën e rasteve dinë shumë mirë të ballafaqohen me sfidat e shumta që paraqiten në klasë. Madje, ata shumë mirë e dinë se çfarë lloj strategjish duhet zbatuar për të arritur qëllimin që nxënësit të përfitojnë apo të marrin njohuri adekuate.

Përmes modeleve dhe teknikave të shumta që ka në dispozicion mësimdhënësi, patjetër që duhet të prijë një model të cilit edhe i bie që ta mbajë timonin në zbatimin dhe organizimin e drejtë të orës mësimore.

Ndryshimi i shpejtë dhe i vullshëm i shoqërisë, sot paraqet një sfidë inkurajuese për mësimdhënësit që përgatisin gjeneratat e reja, që nga hartuesit e kurrikulës dhe politikave arsimore, e deri tek mësimdhënësit në klasë, ata duhet t'i bëjnë pyetje vetes: Si t'i përgatisim sa më mirë fëmijët për një jetë të suksesshme në të ardhmen të cilën ende nuk po mund ta shohim (Musai, 2001: 7).

Edhe pse shoqëritë bashkëkohore vazhdimisht janë në hulumtim të gjetjeve të teknikave apo modeleve të reja mësimore, prapëseprapë, ende jemi në hulumtim të asaj më të mirës, me qëllim që nxënësit më lehtë t'i thithin njohuritë e reja që i mësojnë në shkollë.

Lidhur me modelet apo teknikat inovative të mësimdhënies, kemi zgjedhur një model sikur ky më poshtë, p.sh.:

Lënda:

1. Njeriu dhe natyra – Vetitë e ujit (ora e parë);
2. Matematikë – Matja e lëngjeve (litri) (ora e dytë);
3. Gjuhë shqipe – Përpunimi i tekstit “Pika e ujit” (ora e tretë);
4. Art figurativ – Tekst i ilustruar (ora e katërt).

Kohëzgjatja: katër orë mësimore.

Qëllimi mësimdhënës lidhur me këtë model të mësimdhënies është që nxënësit t'i aftësojë të dinë vetitë e përgjithshme të ujit, duke mësuar rresht për katër orë mësimi.

Nga lënda: *Njeriu dhe natyra*, mësimdhënësi nxit nxënësit të shfaqin supozime të ndryshme lidhur me vetitë e ujit, duke sqaruar për ndryshimet e tij që mund të ndodhin në natyrë. Gjatë kësaj ore, mësimdhënësi përdor mjete konkretizuese, si: ujë, gota, shishe, qese letre, sheqer, kripë, ngjyrë, akull, letër etj., nëpërmjet të cilave bëhet konkretizimi i mëtutjeshëm i vetive të ujit.

Nga lënda e *matematikës*, aftësohen nxënësit për matjen e lëngjeve, duke u njohur me masën për matjen e ujit – litrin, dhe duke krahasuar sasinë e lëngjeve përmes gotave dhe shisheve.

Nga lënda e *gjuhës shqipe*, aftësohen nxënësit të lexojnë rrjedhshëm tekstin “Pika e ujit”, gjejnë emra që kanë të bëjnë me ujin dhe nga ata emra krijojnë fjali si dhe mësojnë edhe për qarkullimin e ujit në natyrë.

Nga lënda e *edukatës figurative*, angazhohen nxënësit në grupe pune, u jepet nga një hamer për ta ilustruar tekstin “Pika e ujit”. Vizatimet e krijuara nga grupet e nxënësve, prezantohen para klasës dhe zgjidhen punimet më të mira. Praktika bashkëkohore të mësimdhënies

([http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Praktika\\_bashk%C3%ABkohore\\_%C3%AB\\_m%C3%ABsimdh%C3%ABnies\\_2.pdf](http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Praktika_bashk%C3%ABkohore_%C3%AB_m%C3%ABsimdh%C3%ABnies_2.pdf)).

Me këtë model të të mësuarit, për katër orë rresht, nxënësit janë në gjendje që pareshtur të mësojnë më gjerësisht për veçoritë e një problemi, duke e trajtuar atë për secilën orë mësimore. Si rrjedhojë, nxënësit, në krahasim me disa modele tjera, janë në gjendje të mësojnë dhe të kuptojnë më shumë dhe të njëjtin problem ta zbatojnë më lehtë në praktikë. Ky është vetëm një nga shumë modele të mundshme, prej të cilave më

së miri do të zgjedhë mësimdhënësi, ngase ai është arkitekti dhe moderatori i zgjedhjeve të modeleve më të përshtatshme.

### *3.3.1. Mësimi alternativ - nevojë e interesit të nxënësit dhe shoqërisë*

Mësimi alternativ ndryshe quhet edhe mësim zgjedhor, sepse nxënësit e zgjedhin atë sipas dëshirës, nevojës apo interesit, ndërsa veprimtaria për mësimin zgjedhor mund të sugjerohet nga MASHT-i, ose në bazë të kërkesave dhe nevojave të rrethit ku jetojnë nxënësit.

Zhvillimi i planit dhe programit të mësimit zgjedhor mbështetet mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënit, mjeteve mësimore, metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Andaj, gjithçka që zgjidhet për herë të parë, për nxënësit është interesante, tërheqëse, e re dhe dallon nga lëndët e tjera.

Mësimi zgjedhor mund të organizohet për lëndë apo për kurse të reja (p.sh., edukimi qytetarë, etika, kurse shëndetësore, të drejtat dhe liritë e njeriut, edukimi për ndërmarrës, teknologjia e informimit dhe e komunikimit, mbrojtja e mjedisit jetësor, shkathtësitë jetësore, edukimi rural, apo çfarëdo tjetër që është joshëse për nxënësit dhe me interes për komunitetin (MASHT, Udhëzime administrative, nr. 1/2005).

Në zgjedhjen e lëndës së re mësimore, si në përmbajtjet tematike të lëndëve ekzistuese, kryesisht nxënësit vendosin vetë, duke u konsultuar me prindërit e tyre, këshillin e shkollës, drejtorinë komunale të arsimit dhe mësimdhënësin e lëndës, me qëllim të përmbushjeve të kërkesave shkollore për zhvillimin e shkathtësive.



Realizimi i qëllimit të këtij plani dhe programi mësimor, varet shumë nga puna e përkushtuar e mësimitdhënësve, të cilëve edhe u kushtohet ky planprogram mësimor. Plani dhe programi mësimor për mësim zgjedhor, ka për qëllim vazhdimin e ndërtimit të vlerave shpirtërore të nxënësve dhe orientimin e prirjeve dhe shkathtësive në ndërtimin e së ardhmes së tyre.

Mësimi zgjedhor nuk ka për qëllim të bëjë diferencimin e nxënësve në mësim, por mësimin dhe përmbajtjet mësimore nxënësve ua bën më të afërta, me qëllim të zhvillimit të aftësive të tyre vetjake. Ky modalitet i organizimit të punës mësimore, kryesisht përdoret në punë mësimore të organizimit ballor, por mund të zbatohet edhe në forma të tjera të punës. Në këto raste “shprehen interesat, aftësitë dhe kureshtjet vetjake, me qëllim të zhvillimit të personalitetit të nxënësit, informimit dhe orientimit profesional të tij” (Zylfiu, 2004: 251).

Mësimi alternativ i viteve të para të shekullit XXI, pothuajse ishte diçka e re për shkollat tona, por tani po shihet si diçka shumë e rëndësishme dhe domosdoshmëri e kohës për avancimin e nxënësit në jetën e përditshme.

Lidhur me nevojat e zgjedhjes së mësimin për ta përshtatur me jetën, mjaft mirë e kishte cekur edhe Shimlesha (1998), kur kishte thënë: “Lidhja e mësimin me jetën mund të vështrohet në aspekte të ndryshme, duke krijuar lidhshmëri të përmbajtjeve mësimore me të (f: 441).

### *3.3.2. Mësimi ekipor, model për mësimdhënie bashkëkohore*

Mësimi ekipor është sistem i ri i organizimit të punës mësimore, me të cilin është synuar të tejkalohen të metat e shkollës tradicionale me qëllim të thyerjes së monotonisë nga ligjëratat e vetëm të një mësimdhënësi.

Në punën ekipore të organizimit të veprimtarisë së mësimdhënies, zakonisht bëhet angazhimi i dy ose më shumë mësimdhënësve ose ekspertëve-profesionistëve të lëmenjve të caktuar, të cilët, së bashku me bashkëpunëtorët e tyre, planifikojnë dhe organizojnë punën mësimore në mënyrë ekipore të fushave të ndryshme mësimore-lëndore. Me këtë kuptojmë realizimin e procesit të të mësuarit nga dy e më tepër mësimdhënës në të njëjtën klasë, me lëndë të ndryshme.

Ky lloj mësimi planifikohet, organizohet dhe realizohet sipas kërkesave tjetërfare dhe vlerësohet nga ekipi bartës, ku secili mësimdhënës, individualisht, realizon dhe bart aspekte të veçanta të mësimin, por me një qëllim të përbashkët, duke transmetuar njohuri, duke zhvilluar shkathtësitë dhe shprehjet tek nxënësit në nivel më të lartë e më cilësor (Xheladin, 2002: 307). Kështu mund të realizohen përmbajtje mësimore nga lëndë e fusha të ndryshme të shkencës, si: nga natyra e shoqëria, nga biologjia e kimia, nga fizika e matematika, nga historia, gjeografia dhe letërsia, nga muzika e arti figurativ etj.

Ekipi përfshin mësuesit me përvoja të ndryshme dhe në këtë mënyrë nxënësit mund të ndjekin dhe të përfitojnë nga mësuesit me përvojë në ngritjen e cilësisë së mësimin dhe të nxënies në përgjithësi (Ismajli, 2012: 316).

Në praktikën mësimore, zbatimi i kësaj qasjeje të re të mësimin, mund të bëhet në dy forma: masive dhe grupore.

- *Me formën masive* të mësimit ekipor, kuptohet realizimi i mësimit tërësisht ekipor, në një klasë ose në një lëndë mësimore. Kjo do të thotë se dy deri në tre mësime mësimdhënës pajtohen që lëndët mësimore t'i zhvillojnë në formë ekipore, duke u pajtuar që disa përmbajtje mësimore t'i realizojnë në formë ekipore në një klasë (Xheladin, 2002: 307)

- *Forma grupore* e mësimit ekipor, realizohet në rastet kur formohen grupe mbi bazën e interesave, ose kur klasa ndahet në grupe pune për përmbajtje të caktuara mësimore (Po aty: 307).

Mësimi ekipor, ndryshon në shumë aspekte nga format e tjera të organizimit të punës mësimore dhe atë e karakterizojnë këto veçori:

- Ekipi përbëhet nga dy ose më shumë mësime mësimdhënës;
- Mësime mësimdhënësit e ekipit ndajnë përgjegjësinë me nxënësit në grupe;
- Anëtarët e ekipit punues planifikojnë dhe vlerësojnë së bashku përparimin e suksesit të nxënësve;
- Mësime mësimdhënësit kanë mundësi të ndjekin punën e njëri-tjetrit dhe kanë të drejtë të prezantojnë në klasa të tjera.

Përparësitë themelore të mësimit ekipor janë:

- Cilësi e lartë dhe realizim profesional i përmbajtjeve mësimore;
- Përdorim racional i kohës dhe hapësirës;
- Aktivizim më i madh i nxënësve;
- Bashkëpunim dhe tolerancë mes anëtarëve të ekipit;
- Gatishmëri për t'i korrigjuar qëndrimet dhe ekzistimi i një atmosfere të vërtetë pune ([http:// www.aktuale.dk/387,2.2.-Puna-ekipore.html](http://www.aktuale.dk/387,2.2.-Puna-ekipore.html)).

Kur flasim për problematikën e procesit të zhvillimit të mësimin ekipo, pohojmë se mësimi ekipo është njëri nga fenomenet inovative, ngase në shkollat tona pothuajse ende nuk ka filluar të zbatohet një mësimdhënie e tillë, andaj “mësimin ekipo tek ne, e njohin një numër i vogël njerëzish, sepse nuk është përpunuar mjaft teorikisht dhe ky është një nga shkaqet serioze që arsimtarët tanë druan ta aplikojnë këtë formë të mësimin” (Nijazi, 2004: 238).

Për mësimin ekipo ka shkruar edhe Jaka (2003), kur thotë se mësimi ekipo paraqet formë specifike të organizimit të mësimin për bashkësi të caktuara nxënësish, me bashkëpunim të disa mësimdhënësve apo bashkëpunëtorëve profesional nga shkolla apo jashtë saj për të realizuar program të përbashkët pune (f: 193).

Lidhur me këtë, edhe Kraja (2012) e cek shumë mirë, kur thotë: “Të mësuarit ekipo synon që tek nxënësit të sigurojë mundësinë e dëgjimit të ligjëratave nga shumë mësimdhënës, të cilët për çështje të caktuara, kanë qëndrime të ndryshme” (f: 223).

Model mësimi: Nëse gjatë një ore mësimore duam të mësojmë për jetën dhe veprën e Naim Frashërit, atëherë në atë ekipo të mësimdhënësve mund të jenë:

- Mësimdhënësi i gjuhës shqipe, u shpjegon nxënësve për veprat e Naimin;
- Mësimdhënësi i gjeografisë, u shpjegon nxënësve për shtrirjen gjeografike të vendlindjes së Naimin;
- Mësimdhënësi i historisë, u shpjegon nxënësve për të kaluarën e familjes Frashri;
- Mësimdhënësi i kulturës figurative, jetën dhe veprimtarinë e Naimin e paraqet përmes vizatimit-pikturimit, dhe nxënësit kanë mundësinë të njihen me shtëpinë dhe fshatin ku ka jetuar Naimi.

“Të mësuarit ekipor synon të riparojë të metat organizative, por nuk ekziston model universal në organizimin e ekipeve, për arsye se ekzistojnë programe të ndryshme, zbatohen forma të ndryshme organizimi” (Kraja, 2012: 224).

### *3.3.3. Mësimi në grupe, model pune për mësimdhënie të avancuar*

Organizimi i punës në grupe ka një histori të gjatë dhe mjaft dinamike. Kjo mënyrë organizimi është zhvilluar mbi baza të kritikës, që i është drejtuar punës frontale dhe kërkesave shoqërore për afirmimin e identitetit shoqëror të nxënësit në mësim.

Pas Luftës së Parë Botërore, pedagogu i njohur francez Rozhe Kuzine dhe Peter Peterson, në Gjermani filluan, ta praktikojnë me të madhe këtë formë të organizimit të punës mësimore (Zylfiu, 2004: 257). Qëndrimet e këtyre shkencëtarëve dhe shumë të tjerëve, në atë kohë, ishin drejtuar kundër sistemit tradicional të organizimit të punës mësimore, duke menduar se me këtë risi do të kapërceheshin dobësitë e shumta të formave të punës mësimore.

Punë në grup do të thotë: “Nxënësit punojnë së bashku, si një ekip apo grup, për një qëllim të përbashkët, kur ata punojnë në një detyrë praktike, në një problem që kërkon zgjidhje ose diskutojnë mbi pikëpamjet e tyre rreth një çështje” (Baines, Blatchford, Kutnic, 2007: 3). Puna në grupe është njëra nga format e punës që organizon shkolla bashkëkohore në procesin mësimor (Krasniqi & Deva, 2012: 240).

Me punë mësimore në grupe, kuptojmë ndarjen e nxënësve nëpër grupe për realizimin e efektshëm dhe cilësor të procesit të mësimdhënies, të përvetësimit të diturive, shkathtësive dhe shprehive ose të elementeve të veçanta të përmbajtjes

mësimore. Puna mësimore në grupe është punë e pavarur e nxënësve, e cila ka karakter kërkimor në zbulimin e fakteve dhe të dhënave të reja (Xheladin, 2002: 369).

Një prej perspektivave teorike, se si nxënësit mund të mësojnë duke ndërvepruar me të tjerët është bazuar në pikëpamjet sociale konstruktiviste të Vigotskit 1978 (Gillies & Ashman, 2003).

Puna në grupe ka rol të rëndësishëm në jetën e përgjithshme shoqërore, e cila në vete nënkupton “angazhimin e pavarur të grupit të nxënësve-studentëve dhe i shërben punës mendore të të gjithë klasës, e cila kërkohet me planin mësimore” (Kryeziu, 2012: 18). Ajo ndikon edhe në socializmin e tyre, i cili “është proces që zgjat gjatë tërë jetës së individit” (Kulinxha, 2015: 50).

Gjithashtu, sipas autorit Shahini (2013), rrënjët e të mësuarit bashkëpunues i gjejmë në punën e filozofit amerikan Xhon Djuj, më 1997, i cili thekson shumë mirë natyrën sociale të të mësuarit mbi dinamikën e grupit, të mbështetur në punën e mësuesve të anglishtes.

Në shumë vende të botës, presionet dhe kërkesat për mësimin e shkathtësive të reja për punë në grup, të menduarit në nivelin më të lartë dhe përdorimin e suksesshëm të teknologjive të reja informative, kanë qenë një lloj apeli për stilet e reja të mësimdhënies, të cilat do të pranonin këto shkathtësi (Hargreaves, 2000: 151).

Zbatimi i punës mësimore në grupe ka dy përparësi:

- *Së pari*: Nxënësit i jepet e drejta të shfaqë mendimin e tij.
- *Së dyti*: Nxënësi ushtrohet dhe ndihmohet të kuptojë dhe të

interpretojë problemet mësimore.

Mësimdhënësi udhëheq grupin e punës dhe angazhimi i tij ka të bëjë me:

- zgjedhjen e nxënësve për grupin e punës;

- zgjedhjen e përmbajtjes mësimore;
- përcaktimin e formave mësimore të ecurisë së punës mësimore;
- përcaktimin e kohëzgjatjes, vendit, lëndës etj.

Për rolin dhe rëndësinë e vendosjes, V. De Feltre, para gjashtë shekujsh ka thënë: “Nëse të rinjtë kanë liri qarkullimi, lehtë do të mund të vërehej se për çka ka afinitet secili prej tyre”.

Puna mësimore në grupe, sipas karakterit të punës në kryerjen e detyrave, mund të zhvillohet:

- Me detyra të njëjta (të përbashkëta) të çdo grupi të punës;
- Me pjesë përbërëse të detyrës së përbashkët për tërë grupin dhe
- Me detyra të diferencuara, rezultati i të cilave nuk ndikon në rezultatin e përbashkët të formacionit të punës mësimore në klasë (Zylfiu, 2004: 263).

Veprimtaria e çdo grupi punues është e pavarur dhe kryesisht zhvillohet nën udhëheqjen e mësimitdhënësit që nga faza përgatitore e orës mësimore, deri te kontrollimi i rezultateve të punës. Në zhvillimin e aktiviteteve të punës në grupe, zgjidhet kryesuesi i grupit, i cili njëkohësisht është edhe bartës i përgjegjësisë lidhur me realizimin e qëllimeve dhe detyrave të grupit. Udhëheqës i grupit është ai të cilin e zgjedh grupi i punës, pra udhëheqës mund të jetë ai që më së miri u shërben kërkesave dhe nevojave të pjesës më të madhe të anëtarëve të grupit.

Për shkaqe të karakterit funksional dhe organizativ, për udhëheqës të mos imponohet nxënësi që nuk është aktiv dhe që nuk dëshiron të jetë, por edhe nëse çdoherë zgjidhet i njëjti nxënës, edhe kjo nuk është e drejtë, sepse të tjerët mund të pasivizohen në paraqitjet e tyre.

Nga qëllimi i bashkëpunimit të ndërsjellë të punës në grupe, varet edhe pozita e çdo nxënësi në grup. Për këtë, orenditë mësimore (bankat, tavolinat e punës, karriget etj.), me lëvizshmërinë e lehtë të tyre që kanë në klasë si dhe me vendosjen e drejtë të nxënësve, stimulojnë afinitetin kreativ të mësimit dhe të nxënësve për një organizim sa më të mirë të formave të punës. Përpos kësaj, edhe mjetet shpesh janë të nevojshme për udhëheqjen e punës së grupeve (Gulpinar & Yegen, 2005).

Gjatë organizimit të punës mësimore në grupe, mësuesit janë të aftë të zbatojnë teknikat e diskutimit dhe teknikat e punës në grupe, janë të aftë të përzgjedhin teknika të përshtatshme për punë në grupe. Pra, “Mësuesi angazhohet që nxënësit të aftësohen në këtë model të punës” (Rukiqi, 2012: 70).

Studiuesi Stauffer (2013), duke i dhënë përparësi të mësuarit bashkëpunues, thekson: “Nxënësit që mësojnë dhe rriten përmes mënyrave bashkëpunuese, mund të zhvillojnë ndjenjë më të fortë sesa nxënësit që mësojnë individualisht në klasë (f: 139).

Puna në grupe paraqet një pamje të krijimit të njohurive të strukturave sociale dhe proceseve që mundësojnë zhvillimin dhe përdorimin e njohurive komplekse dhe kërkon një qasje gjithëpërfshirëse (Cornelissen et al, 2012.; Hakkarainen et al., 2008).



### *3.3.4. Mësimi i individualizuar, përparësi reale në arritjen e rezultateve më të mira*

Çdo mësimdhënës maksimalisht përpiqet të ndikojë në ngritjen e efikasitetit në mësim dhe shpesh në punën e tij shtrohet pyetja: Si të sigurohet mësimdhënia e suksesshme për secilin nxënës? Shumë hulumtime janë bërë me qëllim që mësimi të përputhet në çdo kohë për të gjithë nxënësit me ndryshime individuale, si: njohëse, emocionale dhe psikomotorike (Vojka-Ismajli, 2012: 290).

“Çdo njeri, në mënyrën e vet ëndërron për një jetë më të mirë dhe fillon të punojë siç di dhe aq sa mundet për ta realizuar atë” (Vuji, 2015: 37).

Me nocionin mësim i individualizuar, nënkuptojmë organizimin e punës mësimore e cila bazohet në dallime individuale në mes të nxënësve.

Interesi individual është i bazuar në njohuritë ekzistuese në lidhje me vlerat, detyrat, objektivat dhe idetë, që është dëshira për t'u përfshirë në aktivitete të cilat lidhen me këto koncepte (Swart et al., 2012).

Mësimi i individualizuar paraqitet si reagim ndaj mësimit tradicional, ku të gjithë nxënësit nxinin në të njëjtën mënyrë. Përmes mësimit të individualizuar, mësimi orientohet drejt çdo nxënësi, duke i respektuar aftësitë dhe mundësitë individuale. Prandaj, “Mësimi i individualizuar trajtohet si një lloj mësimi që garanton efikasitet të lartë të punës mësimore” (Brada, 2010: 53). Lidhur me këtë çështje, mjaft mirë shpjegon edhe Murati (2002), kur thotë: “Puna dhe angazhimi i nxënësit është parësor dhe ai gjithnjë kërkon, zbulon, gjen dhe ushtron për të ardhur deri tek dituritë e reja” (f: 376).

Nxënësit, për arsye të ndryshme, nuk mund të mësojnë me të njëjtën shpejtësi, prandaj gjithsesi duhet bërë individualizimi i mësimi. Ky lloj mësimi, më lehtë u përshtatet mundësive dhe aftësive të nxënësit, duke zhvilluar potencialet e pazbuluara të nxënësit dhe kontribuon dukshëm në zhvillimin e mendimit kreativ të tij.

Sipas mënyrës së individualizuar të mësimdhënies, bëhet e mundshme që mësimi t'u përshtatet interesave, nevojave dhe formave të nxënies të çdo nxënësi, P.sh.:

- Nxënësit mund të kryejnë detyra të ndryshme, me qëllime të ndryshme;
- Nxënësit mund të përdorin material të ndryshëm, apo pajime të ndryshme, duke punuar në zgjidhjen e detyrave të njëjta dhe për të njëjtin qëllim; një grup nxënësish, apo një nxënës që ka prirje në lexim dhe komunikim mund ta mësojë një temë nga libri, grupi tjetër gjatë asaj kohe mund të lexojë materiale burimore, ndërsa tjetri grup, mund të shikojë filma me përmbajtje të njëjtë. Pas kësaj, organizohet diskutim i përbashkët me qëllim që të shkëmbehen mendimet dhe të harmonizohen qëndrimet (Mandiq, 1985: 91).

Mësimdhënësi, për zbatimin e kësaj forme të punës, paraprakisht do të përgatisë materiale të ndryshme mësimore, mjete, teste, detyra etj. Ai është i pranishëm tek secili nxënës dhe vazhdimisht mbikëqyr procesin, u jep ndihmë, u jep udhëzime etj.

Tek mësimi i individualizuar, *“Nxënësit dallojnë nga njëri-tjetri, për mënyrën se si duan të futen në mësim nga pika të ndryshme dhe nga rrugë që ata i mendojnë si më të përshtatshme për t'u ndjekur, sapo të jenë futur brenda. Ndërgjegjësimi i mësuesit për këto pika hyrëse mund ta ndihmojë atë në paraqitjen e materialit të ri, sipas asaj metode që mund të rrokët me lehtësi nga një numër i madh nxënësish”* (Gardner. 2003: 312).

Një nga modalitetet që zë vend të merituar në praktikën e tanishme në shkollat tona e që është në fazën e eksperimentale, është edhe mësimi *hap pas hapi*, i cili ka ngjashmëri me mësimin e individualizuar, që do të thotë se në mësonjëtove nxënësit lihen të lirë për të kryer detyrat, sepse mësonjëtove në mësimin hap pas hapi janë laboratorë - punëtorë, të cilat janë të mbushura me mjete, instrumente dhe materiale të ndryshme didaktike. Në këtë mësim dominon kërkesa për nxitjen dhe zhvillimin e bashkëveprimeve dhe të metodës aktive, lojës dhe zbavitjes. Andaj, “Qëllimi edukativo-arsimor hap pas hapi realizohet në orë, si njësi didaktike-organizative dhe kohore” (Osmani, 2010: 34).

Mësimi i individualizuar kërkon të ketë edhe këto kushte për realizimin e tij:

- Bibliotekën me tekste përkatëse mësimore;
- Materialet e programuara mësimore individuale për çdo nxënës;
- Televizorët, kasetat TV;
- Projektorin;
- Kompjuterët etj.

Mësimi i individualizuar kërkon që mësimdhënësi të jetë jo vetëm organizator dhe udhëheqës i procesit edukativo-arsimor, por edhe bashkëpunëtor, inovator, orientues, këshillëdhënës dhe ndihmës i nxënësit, ndërsa nxënësit, me punën, iniciativën dhe pavarësinë e tyre, të kontribuojnë për zhvillimin e tyre (Osmani, 2010: 97).

Mësimdhënia e individualizuar mund të zbatohet edhe në nivel të grupeve të vogla, prej tre deri në pesë nxënës, kur shanset janë më afër reales që të arrihet më shumë në individualizimin e mësimin. Mësimdhënia e individualizuar veç e veç, më tepër zbatohet në shkollat speciale për fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe për shkollat profesionale, ku çdo fëmijë siguron ushtrime individuale (Zajazi, 2003: 297).

Gjatë mësimit të individualizuar, mësimitdhënësi përcakton teknika përshtatëse për këtë lloj mësimi dhe njih mirë lëndën, me qëllim që me kohë ta analizojë mirë problemin dhe ta ndajë atë, varësisht prej aftësive individuale apo grupore të nxënësve.

### *3.3.5. Mësimi ekstrakurrikular, përparësi për thellim të mëtejshëm të njohurive të reja*

Veprimtaritë ekstrakurrikulare, që zhvillohen jashtë orëve të rregullta të mësimit, janë një vështrim i thellim i mëtejshëm i njohurive që marrin nxënësit” (Kraja, 2012: 329).

Një nga momentet më të rëndësishme të punës së mësimitdhënësit në orët e veprimtarive ekstrakurrikulare, është planifikimi semestral apo vjetor i këtyre veprimtarive shumë të nevojshme. Kjo do të thotë që në fillim të vitit shkollor, mësimitdhënësit planifikojnë objektivat që duan t'i arrijnë me nxënësit e tyre. Kjo punë e mësimitdhënësit është e thjeshtë, sepse ai ka liri të plotë për përzgjedhjen e objektivave që lidhin dhe përmbushin interesat e nxënësve. Për gjithçka të re që mund të paraqitet në jetën e përditshme dhe që kanë nevojë nxënësit, prindërit dhe komuniteti, që në fillim të vitit shkollor, u lihet hapësirë e veçantë në plane dhe programe mësimore. Kjo u ndihmon nxënësve që me kohë të njihen me organizimet dhe ndryshimet që mund të ndodhin në shkollë e më gjerë, si në njohje të traditës, përgatitja për festa, njohje me katastrofat natyrore, njohja me sëmundjet ngjitëse, epidemitë apo edhe për ndonjë problematikë tjetër për nevojat e shkollës e më gjerë.

Veprimtaritë ekstrakurrikulare, janë një thellim i mëtejshëm i njohurive të nxënësve, ndryshe nga orët e rregullta mësimore (Kraja, 2009: 356). Lidhur me këto

veprimtari mësimore, mësimdhënësi i njofton nxënësit për rëndësinë dhe rolin e tyre në jetën e përditshme, me qëllim që ata të jenë të përgatitur, si në ruajtjen e ambientit, në organizimin e ndonjë kursi të diturisë, në organizimin e garave sportive, në formimin e grupeve të gjuhëtarëve të rinj, të matematikanëve, valltarëve, recituesve etj. Mësimdhënësi i njofton nxënësit lidhur me këto veprimtari mësimore dhe vazhdimisht sjell në shkollë edhe aktivitete të tjera inovative, përmes të cilave nxënësit janë kureshtarë të mësojnë për ndryshimet dhe risitë me të cilat ndeshen ata si përbrenda objektit shkollor ashtu edhe jashtë tij.

Mësimdhënësit inovatorë, lidhur me veprimtaritë ekstrakurrikulare, vazhdimisht janë në kërkim të gjetjeve të temave të reja dhe ata asnjëherë nuk ndalen së kërkuari për të gjetur tema të rëndësishme, për të cilat nxënësit janë të hapur që t'i pranojnë ato.

Përgatitjet për festat e shkollës dhe mobilizimi i mësuesve, nxënësve, prindërve, komunitetit etj., i bën ata bashkëpunëtorë për të zgjidhur probleme të shkollës, për ta bërë gjithnjë e më të kompletuar me orëndi, me mjete didaktike, veprimtari cilësore mësimore edukative etj. (Kraja, 2012: 339).

Kurrikulat lëndore që trajtohen në klasa, mund të bëhen më efektive dhe më tërheqëse për nxënësit kur ato kanë objektiva më të gjera sesa ato lëndore. Kjo do të trajtonte çështje që lidhen ngushtë me fenomenet sociale të nxënësve. Këto çështje mund të ndërfiten në mësim përmes një veprimtarie që gërshetohet brenda një ore mësimore, e cila ka lidhje me temën dhe konceptet që trajtohen, por dhe që ofron njohuri të tjera dhe të reja, mbi të cilat është përqendruar të mësuarit.

Fushat ekstrakurrikulare rreth të cilave mund të arrihen objektiva të caktuara janë të shumta, e kjo do të thotë se edhe veprimtaritë që mund të planifikohen janë po ashtu të shumta.

Disa nga këto fusha të rëndësishme dhe aktuale në shoqërinë tonë janë:

- Edukimi ndërkulturor;
- Trafikimi i qenieve njerëzore;
- Edukimi shëndetësor;
- Edukimi për të drejtat e njeriut;
- Edukimi mjedisor;
- Edukimi për barazi gjinore;
- Edukimi global;
- Edukimi për paqe;
- Edukimi për demokraci;
- Edukimi ekonomik;
- Edukim trafiku;
- Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara etj. (<http://www.fsash-spash.com/Non-form-educ-manual.pdf>).

Këto objektiva mësimore, kryesisht kanë karakter ndërlëndor, të cilat ndërlidhen me jetën dhe punën shkollore dhe jashtëshkollore të nxënësve.

Përmbajtjet ekstrakurrikulare gjithnjë e më shumë mund të gjejnë hapësirë për t'u përfshirë në punën mësimore, në programet aktuale ose si pjesë apo përmbajtje e veçantë mësimore nga të cilat anekse, mësimdhënies i shtohet cilësia dhe pasurohet me njohuri të reja.

### *3.3.6. Mësimi hap pas hapi, kërkesë reale për individualizimin e plotë të të nxënit*

Të mësuarit hap pas hapi është një program edukativ, i cili më parë kishte filluar të zbatohet vetëm si metodologji parashkollore, mirëpo tani u qaset të gjitha niveleve shkollore. Lidhur me këtë çështje, janë themeluar disa qendra trajnimi në Kosovë për mbajtjen e seminareve të mësimdhënësve.

Të mësuarit hap pas hapi, është pjesë e përbashkët e formave dhe e përmbajtjeve të reja të modernizimit të mësimdhënies dhe nxënies. Programi hap pas hapi, mbështetjen kryesore e ka në kërkesat për individualizimin e plotë të të nxënit, në mënyrë që nxënësi me aftësitë vetjake stimulohet gjatë procesit zhvillimor të punës mësimore (Zylfiu, 2011: 251). Mësimi hap pas hapi, nxit aktivitete vetjake të nxënësve në procesin e individualizimit të angazhimit të përvojave të nxënësve, në bashkëpunim të ndërsjellë, me qëllim të ngritjes së aktiviteteve të tyre, në përshtatshmëri me aftësitë dhe përgatitjet paraprake për punën mësimore (Po aty: 252).

Hapësira e shkollës dhe e klasës në të cilat zhvillohet mësimi hap pas hapi, për arsye të lëvizjes së lirë të nxënësve, është më e madhe në krahasim me klasat e tjera normale.

Në këtë lloj mësimdhënieje, bashkëpunimi ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësit është në shkallë të lartë. Nxënësit e kanë lirinë e plotë të shprehjes dhe të aktivitetit të lirë me një zhurmë të butë, por me karakter pune. Të mësuarit hap pas hapi, sikurse te mësimi klasor edhe tek ai lëndor, ka për qëllim të krijojë një mjedis pune, të aftësojë nxënësit për mësim gjatë gjithë jetës, të aftësojë të gjithë nxënësit për punë intelektuale, artistike dhe praktike. Përmes këtij lloj mësimi, nxënësit janë të përgatitur gjatë ballafaqimit me veprimtari praktike (Zylfiu, 2011: 252).

Mësimi hap pas hapi në organizimin dhe zhvillimin e veprimeve pedagogjike, integron praktika të reja të bazuara në kërkimin e hershëm të fëmijëve, duke punuar me një përkushtim të madh me familjet dhe komunitetin, në mënyrë që të plotësohen nevojat e çdo fëmije veç e veç (Zylfiu, 2011: 253).

Mësimi hap pas hapi përkrah individualizimin në mësimdhënie, për ta arritur potencialin për zhvillim të plotë të çdo nxënësi në aspektin psikosocial, fizik dhe shoqëror, duke e respektuar mënyrën e të nxënësit, temperamentin dhe interesimet e fëmijës (Zhitija, 2011: 37).

Mësimi hap pas hapi është mjaft transparent, sikurse me nxënësit ashtu edhe me prindërit, ngase ata janë më afër realitetit lidhur me ndodhitë dhe aktivitetet e punës në shkollë dhe shpesh kanë rastin të njihen me ndryshimet dhe risitë që paraqiten brenda dhe jashtë objektit shkollor. Nxënësit në këtë rast tregojnë shumë qartë edhe për përparësitë që kanë dhe për lirinë në përzgjedhjen e lëndës që e pëlqejnë.

Mësimi hap pas hapi, nxit vetëdijen e nxënësve për t'u ballafaquar drejtpërdrejt me aktivitete pune në klasë e më gjerë, duke ndërtuar kështu një shoqëri demokratike dhe të suksesshme, e cila drejtpërdrejt kontribuon në zhvillimin e vazhdueshëm të individit dhe shoqërisë.

Mësimdhënësit i orientojnë fëmijët që të bëjnë zgjedhjen e duhur për të marrë mbi vete përgjegjësinë personale për zgjedhjen e bërë. Fëmijët nxiten t'i formulojnë dhe të shprehin mendimin personal të tyre, të parashtrojnë pyetje dhe të bisedojnë hapur lidhur me problematikën që paraqitet.

Në dizajnimin e metodologjisë “Hap pas hapi” duhen pasur parasysh katër ide themelore: komunikimi, kujdesi, përbashkësia dhe lidhja. Nëpër këto ide, programi “Hap pas hapi” për fëmijët e shkollës fillore, i pasqyron këto katër qëllime themelore:



- Krijon bindje te nxënësit që të mësojnë gjatë tërë jetës së tyre;
- Krijon ambient për të nxënit, që do të bazohet në respektin e ndërsjellë dhe parimet demokratike;
- Siguron zhvillim të praktikave të suksesshme edukativo-arsimore;
- Nxënësve u mundëson të fitojnë njohuri dhe aftësi artistike, etike dhe praktike që të marrin pjesë në një shoqëri demokratike (Përparimi\_i\_mësimdhënies\_në\_mat.\_1-3\_PEP.pdf).

### *3.3.7. Mësimi me projekte ballafaqim konkret me veprimtaritë praktike*

Krahas formave të tjera të mbështetura standarde, mësimi me projekte ka kufizime, por ka edhe vlera të veta të caktuara. Në mësimin me projekte punohet njëkohësisht dhe “mësohet duke vepruar” (Bastian & Gudjons, 1990: 79). Do të thotë: Nxënësi që të mësojë, do të veprojë apo vepron që të mësojë, sipas qëllimit mësimor të paracaktuar. Nga ana tjetër, e kemi edhe elementin kufizues që nxënësi merr ngarkesë për vetëplanifikim, vetëpërgjegjësi dhe për qasje serioze në aspektin praktik të projektit.

Që këtë model të ri të mëimit ta kuptojnë edhe më mirë, i përshkruajmë fazat e punës: (<http://www.germ-a.com/?p=2866>).

- *Së pari*, koncepti i mëimit me projekte fillon me saktësinë e një problemi të vërtetë, nga i cili nxënësit do të fitojnë një përvojë të dobishme. Në këtë rast e kemi në konsideratë interesin e nxënësve për problemin dhe nivelin në raportet sociale të tyre për bashkëveprim në klasë.

- *Së dyti*, mësime të bashkuara me nxënësit e zhvillojnë planin për zgjidhjen e problemit në përcaktimin dhe planifikimin e projektit, sepse ai është shtylla e rrjedhës së procesit.

- *Së treti*, në mësimin me projekte, është ballafaqimi i drejtpërdrejtë me problemet e parashikuara në mbledhje të fakteve, analiza të rezultateve, zgjidhje të problemeve etj.

- *Së katërti*, kontrollohen zgjidhjet e problemit të projektit. Rezultati i tillë ka vlerë praktike (p.sh., me punimet tona do të hapim një ekspozitë dhe do të informojmë shkollat e mjedisit). Këtu qëndron edhe domosdoshmëria që rezultatet e punës personale kontrollohen në mënyrë kritike dhe në rrethana reale. Mësimi me projekte është i orientuar drejt prodhimit. Prandaj edhe procesi i të menduarit, i të mësuarit dhe i prodhimit janë njëloj të rëndësishëm (<http://www.germ-a.com/?p=2866>).

Të mësuarit me projekte do të thotë “mësohet duke vepruar” (Zajazi, 2003: 70). Nxënësi mëson të veprojë apo vepron që të mësojë sipas qëllimit mësimor të paramenduar (Po aty: 70).

Të mësuarit e bazuar në projekte, është një model i veprimtarisë mësimore, i cili zhvendoset nga praktikatat e mësimit të izoluar brenda klasës, në veprimtari të nxënimit me në qendër nxënësin. Një nga çështjet kryesore të këtij mësimi, është motivimi i nxënësve nëpërmjet përfshirjes së tyre në një proces të nxënimit të pavarur (<http://www.germ-a.com/?p=2866>).

Mësimi në projekte u ofron nxënësve mundësitë e duhura për të thelluar interesat e tyre njohëse, për t’i zhvilluar e për t’i ndjekur ato, për t’u marrë me problemet dhe për të vendosur se si do të mund të gjenden përgjigjet e duhura dhe rrugët e zgjidhjes së këtyre problemeve (<http://www.germ-a.com/?p=2866>).

Mësimi në projekte lehtëson dhe ndihmon të nxënit e dobishëm nëpërmjet lidhjes së njohurive me jetën jashtëshkollore, duke iu drejtuar problemeve të botës reale dhe zhvillimit të cilësive të nevojshme për t'iu përshtatur kërkesave të punës.

Ky lloj i të mësuarit, përfaqëson një afrim të gjithanshëm drejt një të mësuarit aktiv e bashkëpunues, i cili karakterizohet nga përfshirja e vazhdueshme e nxënësve në kërkimin mësimor (Bransford & Stein, 1993: 29). Ai ndryshon nga veprimtaria e zakonshme e kërkimit, përvojë të cilën shumë prej nesh kanë pasur rastin ta hasin gjatë viteve të shkollimit.

Si karakteristika kryesore të të mësuarit në projekte janë:

- Mundësimi i kryerjes së kërkimeve nga nxënësit, të cilët aftësohen si të nxënë konceptet e reja, si të zbatojnë informacionin e fituar dhe si të paraqesin njohuritë e fituara;
- Zgjidhja e një problemi të botës reale që së paku ka të bëjë me një fushë të përmbajtjes lëndore;
- Përdorimi i mjeteve njohëse, të cilat e ndihmojnë nxënësin të paraqesë idenë e tij;
- Bashkëpunimi ndërmjet nxënësve, mësimdhënësve dhe pjesëtarëve të tjerë të komunitetit.

Liria e nxënësve për të krijuar diçka të re për herë të parë është vendimtare, sepse, përmes procesit të krijimit, nxënësit formojnë dhe forcojnë njohuritë e tyre. Kjo u mundëson që veprimtarinë praktike ta bëjnë pjesë të qenësishme të jetës së tyre shkollore, duke i zgjeruar vazhdimisht njohuritë e tyre, krahas rishikimit të punimeve që kanë bërë. Kështu, projektet mund të shërbejnë si një urë midis dukurive që hasen a ndodhin në klasë dhe përvojave të jetës së përditshme.

Zbatimi i të mësuarit me projekte, kërkon më shumë se një orë mësimi. Kërkohe të shfrytëzohet informacioni dhe njohuritë e nxënësit nga më shumë se një lëndë. Është metodë që vë në përdorim dhe shfrytëzon përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e tyre të marra nga burime joshkollore. Kërkon që shumë nga veprimtaritë e nxënësve, të kryhen jashtë orës së mësimit dhe jashtë mureve të shkollës. Kërkon përcaktimin e partnerëve pjesëmarrës në arritjen e objektivave. Partnerët mund të jenë mësimdhënës të lëndëve të tjera, prindër dhe përfaqësues të komunitetit. Për nxënësit e CU-së (<https://sq-al.facebook.com/ese.dhe.projekte/posts/1562835890660717>).

Shembull i një projekti që është zhvilluar me nxënësit e klasës V të SHFMU "Skënderbeu" Hogosht (Komuna e Kamenicës):

- Së pari mësuesi diskutoi me nxënës për të përcaktuar temën e projektit
- Tema: Ndikimi i llojeve të tokave në zhvillimin e bimës

*Synimi i projektit:*

- Të mësojnë nxënësit të kërkojnë informacione për llojet e tokave;
- Të organizohet punë në grupe sipas detyrave të përcaktuara.

*Qëllimi i projektit:*

- Aftësohen nxënësit të zbatojnë në praktikë njohuritë e fituara;
- Nxiten nxënësit për një veprimtari të tillë;
- Aftësohen nxënësit për të punuar në grupe dhe projekte.

*Objektivat e projektit:*

- Aftësohen nxënësit për punë kërkimore përmes vëzhgimit;
- Mësojnë të dallojnë llojet e ndryshme të tokave.

Pjesëmarrësit në projekt:

- Grupet e nxënësve;

- Mësimdhënësit e lëndës përkatëse.

*Mjetet e nevojshme:*

- Aparati fotografik, kamera, interneti, fletore për mbajtjen e shënimeve dhe mjete të tjera ndihmëse, që shërbejnë për paketimin, bartjen dhe mbjelljen e farave.

*Ndarja e detyrave:*

- Zgjidhet kryesuesi i grupit dhe ai cakton detyrat për çdo anëtar grupi dhe bashkërisht bëjnë një përmbledhje të përgjithshme për fillimin e punës në projekte (Vrapi, 2016: 148).

***Ecuria e punës***

***Faza e parë:*** Parapërgatitja për projektin

- Është caktuar koha gjatë së cilës do të realizohet projekti.
- Detyrat u janë bërë të qarta nxënësve që në fillim, duke u përcaktuar edhe teknikat dhe mjetet që do të përdoren gjatë punës së projektit.

***Faza e dytë:*** Puna rreth projektit

- Nxënësit janë ndarë në grupe dhe janë shpërndarë në terren për të sjellë lloje të ndryshme të tokave.
- Gotat e plastikës i kanë mbushur me lloje të ndryshme të tokave, duke i emërtuar dhe duke i ndarë ato veç e veç.
- Në secilën gotë është mbjellë nga një farë misri.
- I kanë ujitur ato dhe i kanë lënë në kushte të klasës, nën dritën e diellit.

- Secili grup i nxënësve ka mbajtur shënime lidhur me llojin e tokës për të cilën është i ngarkuar, si për datën e mbjelljes, vendin, temperaturën e klasës, fotografitë etj.

***Faza e tretë:*** Raportimi përfundimtar

- Gjatë kësaj faze, çdo grup ka dalë me një punë të veten të përgatitur me një material të plotë lidhur me mbirjen e farës dhe zhvillimit të saj brenda ditëve të caktuara, duke pasur parasysh llojin e tokës ku është mbjellë fara. Nxënësit janë ndihmuar nga mësuesit e tyre të ndahen dhe të paraqesin qëllimin, mjetet, bashkëpunëtorët, vështirësitë e kënaqësitë që kanë provuar gjatë procesit të përmbushjes së detyrës mësimore. Dhe, në fund, nxënësit, përmes të mësuarit me projekte, ishin në gjendje të kuptojnë drejtpërdrejt se cila tokë ishte më pjellore për zhvillimin e bimës e cila jo (V. Sermaxhaj, komunikim personal, 12 prill 2016).

### **3.4. Devijimet e mundshme të inovacioneve mësimore në mësuesinë**

“Politikëbërësit kanë për detyrë të caktojnë politikën, të vendosin standardet dhe të mbikëqyrin arritjet” (Fullan, 2010: 39). Nëse politikëbërësit e kryejnë mirë punën e tyre dhe nëse mësuesit bashkëpunojnë mes vete, me prindërit, me komunitetin... lidhur me gjetjen e formave, metodave, mjeteve, teknikave dhe teknologjive mësimore, besojmë që patjetër do të gjendet më e mira e mundshme e mësuesinës. Njëra ndër mundësitë që mund të prishë këtë strukturë, mund të jenë urdhrat nga lart, pa ndonjë marrëveshje me shkollat, që do të thotë se një mosmarrëveshje e tillë shpesh mund të çojë mësuesinën në një rrugë pa dalje, që mund të krijojë huti tek ta.

Faktorët pengues drejt realizimit në nivele të kënaqshme dhe të krahasueshme me përvojat bashkëkohore në procesin mësimor, ndodhin:

- ***Së pari***, për shkak të një centralizmi të fortë të trashëguar nga e kaluara, duke mos funksionuar lidhja e shkollës me komunitetin demokratik për të siguruar një arsim të mirë për të gjithë. Kjo mangësi mënjanon rolin që duhet të luajë fuqia e familjes dhe karakteri social i komunitetit për të përmbushur plotësisht përpjekjet për mësimdhënie bashkëkohore.

Devijimet në mësimdhënie, mund të ndodhin edhe në ato raste kur mësimdhënësit nuk i lejohet të dalë jashtë planit dhe programit mësimor, e sidomos atëherë kur disa prej mësimdhënësve janë të interesuar të bëjnë ndryshime në të mirë të shkollës, por, në anën tjetër, fatkeqësisht, disa prej tyre nuk kanë njohuri të mjaftueshme lidhur me zbatimin e atyre risive mësimore, ngase një numër mësimdhënësish ende nuk janë të trajnuar mjaftueshëm lidhur me aplikimin e mjeteve mësimore, të cilat po thuajse për çdo ditë sa vijnë e shtohen, edhe pse kërkesat e komunitetit janë të pandërprera për mbështetjen dhe nxitjen e mësimdhënies bashkëkohore.

- ***Së dyti***, mungesa e një bashkëpunimi, bazuar mbi një strategji afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë mes pushtetit lokal dhe njësive të dekoncetruara të arsimit që janë drejtoritë komunale të arsimit dhe drejtoritë rajonale.

Shtrohet pyetja: Ç'duhet të bëjmë për të arritur cilësi në objektivat e mësimdhënies? Mos, vallë, nxënësit nuk punojnë mjaftueshëm?! Apo ne nuk e kryejmë punën tonë të shenjtë?! Përgjigjja më e sigurt është se fëmijët asnjëherë nuk janë fajtorë për devijimet e mundshme që mund të ndodhin në shkollë dhe jashtë saj. Andaj, te kush mbetet fajti? Fajti është tek mësimdhënësit apo diku tjetër?

Mësimdhënësit shpesh ankohen, duke thënë se nuk kemi ide inovative, ndërsa, në anën tjetër, sipas Fullanit (2010), “Në gjithë botën ka një bollëk të ideve novatore” (f: 41). Mjetet dhe idetë inovative çdoherë janë të mjaftueshme dhe ekzistojnë gjithkrah rreth nesh e pranë nesh, andaj vetëm duhet të dimë se si t'i përdorim dhe, në mungesë të tyre, çfarë të përdorim.

Shkollat tona dhe rrethi ku jetojmë, tani janë të mbushura me plot e përplot inovacione mësimore, sepse tani jemi duke jetuar në kohën e ndryshimeve të mëdha, të cilat vazhdimisht burojnë nga të gjitha anët.

Mangësia e inovacioneve mësimore në mësimdhënie nuk duhet të ndodhë, sepse shkolla do të ishte një institucion regresiv, e cila, në vend të sjelljes së cilësisë dhe rrisë në mësim, në kokat e nxënësve do të mbjellë mbetjet e së kaluarës.

Pothuajse në gjithë botën ka një rritje të inovacioneve mësimore, por nuk do të thotë se duhet t'i zbatojmë të gjitha ato risi në mësimdhënie, pa e ditur rolin dhe rëndësinë e tyre dhe pa pasur njohuri të mjaftueshme lidhur me to. Andaj, shpesh ndodh që nxënësit “të bëhen viktimë e tyre”, pa e ditur se ku do të çojnë ato (Fullan, 2010: 41).

Pos anëve pozitive që kanë inovacionet në mësimdhënie, ato nuk japin çdoherë rezultate të kënaqshme, sepse në disa raste ndodh që ato të zbatohen në mënyrë mekanike dhe të njëanshme. Edhe pse mbajmë shumë shpresë se përmes tyre mund të kemi rezultate të mira në shkollë, nuk përjashtohet mundësia që këto të ndikojnë negativisht në organizimin e procesit edukativo-arsimor (Mandiq, 1985: 87).

Inovacioni mësimor, kohët e fundit, është një term i përdorur aq shpesh, sa që nganjëherë të duket se është duke u degraduar nga ajo që përcaktojnë ato (<https://www.nfer.ac.uk/publications/FUTL61/FUTL61.pdf>).



Duke ditur faktin se mësime të reja shpeshherë sillen në atë mënyrë sikurse nuk janë edhe aq të sigurt në menaxhimin e mjeteve të reja mësimore, atëherë “në shkollë krijohen mjedise të përshtatshme për shfrytëzimin e mjeteve të reja mësimore” (Vojka, 2012: 160).

Është inkurajuese të dimë se inovacioni nuk është gjithmonë i përsosur dhe se disa mjete inovuese mund të jenë edhe dështime. Por, është e rëndësishme të gjejmë inovacione mësimore të përshtatshme, pa të cilat shkolla nuk do të jetë në hap me kohën (<http://www.edutopia.org/blog/what-you-need-innovative-educator-terry-heick>).

Ne jetojmë në një kohë kur në çdo moment dhe në çdo sferë të jetës ndodhin zbulime të ideve dhe teknikave të reja shkencore. Për fat të keq, në disa raste, mësime të reja është i vendosur në një pozicion para betejave të humbura, ngase inovacionet mësimore janë kërkesë e patjetërsueshme e kohës dhe që patjetër ata duhet të ballafaqohen me to. Me kalimin e kohës, mësime të reja patjetër që do të fillojnë të relativizohen, sepse ato inovacione mësimore që sot janë risi, nesër nuk do të jenë, apo ajo që në një mjedis shkollor është e braktisur kohë më parë, në një tjetër është ende e re.

Risi në mësime të reja, gjithashtu, nuk është një kërkesë e kohës për të përgatitur nxënës për jetën në të cilën vazhdimisht ndodhin risi. Shkolla, nga natyra e saj institucionale, përfshin një vonesë të caktuar dhe distancë nga inovacionet absolute, për shkak se në fakt në mesin e mësime të reja ka mësime tradicionale, të cilët kanë vështirësi të inkuadrohen në një sistem krejt ndryshe nga ai më parë. Të njëjtën vështirësi e kanë edhe ata mësime të reja të cilët nuk kanë ndjekur trajnime të mjaftueshme për t'u ballafaquar më lehtë me ndryshimet në mësime të reja.

Lidhur me këtë, mund të lindin edhe pakënaqësi mes mësimitdhënësve, drejtuesve të shkollave, nxënësve dhe prindërve, duke kërkuar që mësimitdhënësit e tyre të jenë të aftë në zotërimin e mjeteve të reja mësimore.

Edhe pse mësimitdhënësit mundohen që të përdorin forma të reja dhe të ndryshme të mësimitdhënies, në disa raste, prapë nuk mundën, sepse para tyre vazhdimisht dalin pengesa të ndryshme, të cilat nuk e lënë të lirë mësimitdhënësin për të zgjedhur mënyrën më të mirë të mësimitdhënies (Marsh, 2009: 63).

Detyra e mësimitdhënësit nuk mund të jetë monitorimi i të gjitha inovacioneve, duke shkaktuar vështirësi edhe më të mëdha tek mësimitdhënia. Për të shmangur mësimitdhënësit një pjesë të vështirësive që u kanosen lidhur me paraqitjen e inovacioneve mësimore, detyrë e tyre është përputhja me mundësitë e shkollave, me interesat e nxënësve, me planet dhe programet e reja mësimore, me kërkesat e prindërve, me ndërhyrjet e institucioneve të arsimit etj.

Nëse mësimitdhënësit në shkollat ku punojnë, janë të interesuar të sjellin risi mësimore, ata duhet të mos lejojnë që të ndodhë një gjë e tillë pa qenë të përgatitur që:

- Të kenë përkrahjen e subjekteve të brendshme dhe të jashtme;
- Të dinë për qëllimin e inovacioneve;
- Të bëjnë projektin për ndryshim;
- Të zbatojnë metodologji të re në mësimitdhënie;
- Të mësojnë për burimet e reja mësimore;
- Të bëjnë ndjekjen dhe vlerësimin e ndryshimeve në procesin e

mësimitdhënies etj.

Nëse një mësues vendos që ta zgjidhë problemin e mësimit duke ndryshuar metodën e punës gjatë mësimit, atëherë ai do të ketë ndryshime edhe në të gjitha elementet e tjera të procesit mësues.

Kur një mësues përdor strategji të reja mësuese për të ndryshuar vetëm për hir të ndryshimit, ose për kënaqësinë e nxënësve, ai natyrisht bën gabim dhe do të shkaktojë vetes vështirësi në menaxhimin e procesit mësues ku "gjërat do t'i bëjë edhe më keq sesa janë" (Fullan, 2010: 61).

Kur mësuesit nuk kanë njohuri të mjaftueshme lidhur me manipulimin e teknikave të reja mësuese, apo për ndonjë arsye tjetër, "Në praktikën shkollëre ndodh që mësuesi të sillet si antiinovator, e kjo paraqet një ndër faktorët negativë të suksesit të çdo reforme dhe inovacioni" (Vojka, 2012: 159).

Pothuajse të gjithë mësuesit gjatë procesit të mësimit e dinë shumë mirë se diçka duhet të ndryshohet, si në infrastrukturën shkollëre, në përmbajtjet mësuese, në teknika, në forma dhe metoda të punës etj., ku, për fat të keq, ata kanë frikë nga zbatimi i tyre, duke mos qenë të sigurt në rezultatet e pritshme nga to. Andaj, në të shumtën e rasteve ata mundohen të shmangin ndryshimet inovative në shkollë dhe klasë (Mandiq, 1985: 82). Lidhur me këtë, mësuesit kanë edhe tjetër vështirësi, duke menduar se çdo inovacion kërkon angazhim shtesë për ta dhe orientim krejt tjetër në krahasim me të tanishmin, dhe, përpos kësaj, do edhe investime në mjete mësuese.

Për ta njohur plotësisht problemin e mbingarkimit të nxënësve me inovacione mësuese, do të ishte mirë të hulumtoheshin dhe të studioheshin shkaktoarët që rrjedhin nga ngarkesa e tepërt me inovacione mësuese, për t'u njohur më mirë me efektet e tyre gjatë procesit të mësimit. Pasojat nuk mund të shihen aty për aty, por ato mund të

hetohen e të kuptohen duke parë ulje të rezultateve të mësimi. Për këtë shumë mirë shkruajnë Manno, Finn dhe Vanourek (2000).

Ne nuk mund të vetëkënaqemi nëse në klasën tonë kemi risi mësimore me bollëk, përderisa rezultatet mungojnë. Sipas Fullan (2010), “Në terren ka një bollëk idesh dhe që, patjetër, ato do të vazhdojnë të zgjerohen më tej” (f: 49).

Kënaqësi për mësimdhënësin është atëherë kur ai di të menaxhojë drejt inovacionet mësimore; di t'i përshtatë ato krahas veprimtarive mësimore; di të kthejë vëmendjen e nxënësve në klasë; di të krijojë një klasë të gjallë dhe aktive; di të zotërojë mirë dhe drejt inovacionet mësimore; di të korrë rezultate të kënaqshme etj., e jo të krenohet duke lavdëruar veten para të tjerëve, e cila ndodh më tepër për t'u vetëkënaqur.

Lidhur me ngarkimin e shkollave me inovacione të pakkontrolluara, politikëbërësit mendojnë se përmes kësaj po i bëjnë shkollat më cilësore, përderisa ato janë të imponuara në mënyra të shumëfishta dhe të palidhura (Fullan, 2010: 49). Por, edhe nëse ekziston mundësia e zgjedhjes së risive mësimore nga vetë shkollat, ato nuk kanë kapacitet të dallojnë se cilat programe duhet t'i ndjekin dhe as aftësinë të thonë jo në momentet kur ballafaqohen me ngarkesën e risive (Po aty: 49). Në këto raste ndodh mbingarkesa e organizimit të mësimi me metodologji të papërshtatshme mësimore (Krasniqi & Deva, 2012: 313).

Një bollëk teknologjik i kohëve të fundit, megjithatë, nganjëherë të çon në spote verbale në lidhje me atë se teknologjitë inovative janë në të vërtetë të efektshme për t'i ndihmuar nxënësit të mësojnë apo jo (Cho & Wayman, 2015).

Puna edukativo-arsimore që i ngarkon nxënësit, nuk ndikon pozitivisht në zhvillimin e gjithanshëm psikofizik të personalitetit të tyre. Andaj, ngarkimi i tepërt i nxënësve me materiale shtesë, ka efekt të kundërt nga ajo që ata dëshirojnë.

Çfarëdo ngarkese qoftë ajo, nëse mësimdhënësi i ngarkon nxënësit më tepër sesa ata mund ta përballojnë atë, atëherë tek ta shfaqet “plogështia, lodhja dhe rraskapitja, si simptoma themelore dhe më të shpeshta të mbingarkimit të nxënësve në mësim” (Bekteshi, 2009: 149).

Çështja e ngarkimit me inovacione mësimore gjatë procesit të mësimdhënies, është çështje e edukimit dhe e arsimit të nxënësve, duke kuptuar se qëllimi i fundit nuk është vetëm ta njohin botën dhe mjedisin përmes inovacioneve mësimore, por ta njohin me qëllim që ta ndryshojnë atë.

Në anën tjetër, “qëllimi i gjithë kësaj, nuk është që të arrijmë në përfundimin se nuk po ndodh asgjë e mirë” (Fullan, 2010: 46). Përkundrazi, zbatimi i drejtë i inovacioneve mësimore në procesin e mësimdhënies, në të shumtën e rasteve, sjell rezultate të mira mësimore, por duhet pasur parasysh se kur, ku, sa dhe çfarë inovacionesh të zbatojmë.

Dukuria e mbingarkimit me risi gjatë procesit të mësimdhënies, ndikon dukshëm edhe në aftësimin dhe tjetërsimin e nxënësit, sepse ai, krahas moshës së re dhe aftësive psikofizike që ka, e ka mjaft vështirë të ecë në hap me ndryshimet që po ndodhin, andaj, me ta duhet vepruar vetëm me ato risi të cilat nuk kalojnë kufirin e monotonisë.

Inovacionet mësimore në shkollë, mund të zbatohen në një shkallë të caktuar për aq sa është e nevojshme dhe e kapshme për moshën dhe aftësitë e nxënësit.

Në bazë të një hulumtimi nga UNESCO, vitet e fundit, edhe pse teknologjia mësimore ka përparuar mjaft shumë, pikërisht në këtë kohë shfaqet dukshëm fenomeni i nxënësve të pasuksesshëm në arsim (UNESCO, 2007/2008, EFA Global monitorin report 2008).

Kohët e fundit jemi mësuar kaq shumë me risitë, saqë rrallë ndalemi të mendojmë se çfarë kuptimi kanë këto, çka është e rëndësishme dhe çka nuk është e rëndësishme.

Si rezultat i kësaj, disa prej mësimeve ende nuk arrijnë ta kuptojnë drejt reformën në arsim dhe kështu mbizotëron gjithnjë e më shumë reforma sipërfaqësore, që i bën gjërat edhe më keq sesa janë. “Në të vërtetë, shumë inovacione arsimore mjaft premtuese, janë krijuar dhe janë shuar për shkak të mosmenaxhimit të tyre” (Simo, 2000: 21).

Një përshtypje e përgjithshme e disa mësimeve, me të cilët kemi komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhur me zbatimin e inovacioneve mësimore, ishte se disa prej mjeteve mësimore, të reklamuar kohëve të fundit, i zbatonim vetëm pjesërisht. Ato mjete shpesh mbylleshin me çelës nga drejtorët e shkollave për t'u ruajtur nga zhdukja e tyre, e në realitet, kur kishim nevojë për to, ishte vështirë për t'i gjetur, dhe në këtë mënyrë e humbim durimin gjatë përpjekjes për t'i futur ato mjete mësimore në hapësirat shkollore (N. Sadiku, Sh. Biçku. Komunikim personal, 23 shtator 2016).

Nxënësit, kur vijnë nga jashtë në shkollë, bartin me vete një bagazh të mirë të njohurive të fituara nga mjete të ndryshme të informimit masiv, siç janë: interneti, televizori, radioja, gazetatat, rrethi, prindërit etj., andaj, në disa raste, mësimeve nuk i marrin për bazë njohuritë e tyre fillestare që posedojnë, prandaj ata mund të mos arrijnë të kapin konceptet dhe informacionin e ri që u mësohet dhe shpesh ndodh që njohuritë e fituara më parë të ngatërrohen me njohuritë e reja që i mësojnë në shkollë. Së këndejmi, nxënësit ato i mësojnë vetëm për qëllim të një note numerike, dhe më pas përsëri mund t'u kthehen koncepteve të tyre paraprake.

Disa nga mësimdhënësit që janë të luhatsëm në zbatimin e inovacioneve mësimore, por që i kanë provuar ato në procesin e mësimdhënies, e që nuk kanë arritur të zhvillojnë potencialin e tyre në menaxhimin e drejtë të mësimdhënies, vazhdimisht sillen sikur ato nuk qenkan të suksesshme në organizimin e orës mësimore.

Inovacioni është një burim i pashtershëm, i cili, sapo të vjetrohet njëri, zëvendësohet nga tjetri, është aspekti më i dukshëm i ndryshimit dhe më i lehtë për t'u përdorur vetëm me fjalë. Andaj, ndryshimet në qasjen e mësimdhënies bashkëkohore, paraqesin vështirësi të mëdha, sidomos atëherë kur duhet të mësohen aftësi të reja dhe atëherë kur duhet të vendosen mënyra të reja për kryerjen e veprimtarive mësimore (Fullan, 2010: 74).

Në të shumtën e rasteve ndodh që mësimdhënësit, para se të dalin para nxënësve, bien në dilema se çfarë mjetesh mësimore mund të përdorin gjatë mësimdhënies, në mënyrë që t'u përshtaten sa më mirë përmbajtjeve mësimore, me qëllim që ato të jenë sa më të pranueshme nga ana e nxënësve. Thënë të drejtën, deri diku është arritur të nivelizohet përshtatja e inovacioneve mësimore me përmbajtjet mësimore, por asnjëherë nuk bën të themi se një gjë e tillë është arritur plotësisht.

Ndryshimi i metodave mësimore kërkon përvetësimin e drejtë të tyre (Nuredini, 2012: 2).

Fatkeqësisht, jo vetëm tek mësimdhënësit e shkollave tona, po edhe në vendet më të zhvilluara, brenga e mësimdhënësve rreth përshtatjeve të inovacioneve me përmbajtjet mësimore, pothuajse është e pranishme për çdo orë mësimi. Ata pothuajse çdoherë janë të thelluar në mendime, duke u munduar që në mesin e shumë inovacioneve mësimore, ta përzgjedhin dhe ta zbatojnë atë më të mirin. Por, në disa raste tek mësimdhënësit mund të ndodhë e kundërta e kësaj, duke menduar se kanë bërë

një përzgjedhje të mirë, por në momentet kur ballafaqohen me inovacionet mësimore, shohin se nuk shkon puna mirë ashtu qysh e kishin planifikuar në fillim të orës mësimore.

Në disa raste, mësimdhënësit më tepër u japin përparësi teknologjive inovative në shkollë sesa ndikimit që kanë ato për edukimin (Macaro et al 2012: 2).

Për shfaqjen e problemeve të mosfunksionimit të drejtë të orës mësimore në momentet kur zbatohen inovacionet mësimore, mund të jenë disa shkaktarë, si:

- Mospërshtatja e inovacioneve mësimore me përmbajtjet mësimore;
- Mësimdhënësi i pasigurt në zbatimin e inovacioneve mësimore;
- Ngarkesa e tepërt dhe e pakontrolluar me inovacione mësimore;
- Kushtet jo të mira në klasë dhe në shkollë;
- Mungesa e internetit në shkollë;
- Zbatimi i inovacioneve në rastet kur nuk janë të nevojshme;
- Organizimi i orëve të tilla nga mësimdhënësit vetëm sa për t'u treguar para të tjerëve se janë inovatorë;
- Mospërshtatja e inovacioneve me moshën e nxënësve;
- Mospërshtatja e inovacioneve me aftësitë psikofizike të nxënësve etj.

Nga të gjitha këto mangësi që mund të shfaqen gjatë procesit të mësimdhënies, mund të ndodhë të dështojë pjesërisht apo plotësisht ora mësimore. Andaj, mësimdhënësi inovator, për të mos ndodhur një devijim i tillë i orës mësimore, i përshtat ato sipas nevojave dhe kërkesave të nxënësve. “Ndërrimi i aktiviteteve dhe i kaheve të informimit e të komunikimit gjatë orës mësimore mban në nivel të duhur aktivitetet e nxënësve në mësim” (Brada, 2012: 266).



## KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E STUDIMIT

### 4.1. Dizajnimi i hulumtimit

Hulumtimin tonë e kemi realizuar në gjashtë shkolla fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës lidhur me raportet e zbatimit dhe ndikimit të inovacioneve mësimore në mësimdhënie. Metodologjia e përcaktuar na ka ndihmuar që më lehtë të bëjmë krahasimin e variablave për të testuar hipotezat e parashtruara.

Kemi anketuar tri lloje subjektsh përmes pyetësorëve të formuluar. Kampionët apo grupet përfaqësuese janë të përbërë nga mësimdhënësit, nxënësit dhe drejtorët e shkollave fillore ( I – IX ) të regjionit të Anamoravës së Kosovës.

Tema e punimit tonë doktoral, shfaq nevojën për aplikimin e metodave hulumtuese përkatëse me një qasje cilësore dhe sasiore midis dy lloje subjektsh, të formuluar nga grupet e kampionëve me 240 mësimdhënës dhe 480 nxënës të gjashtë shkollave fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës.

Në këtë studim, nga komuna e Gjilanit kemi bërë hulumtimin në dy shkolla fillore, duke anketuar 40 mësimdhënës dhe 80 nxënës në SHFMU "Thimi Mitko" në Gjilan dhe me numër të njëjtë të të anketuarve edhe në SHFMU "Skënderbeu" në Përlepnice.

Të njëjtin hulumtim e kemi bërë edhe në dy shkolla fillore të komunës së Kamenicës, duke anketuar 40 mësime dhe 80 nxënës në SHFMU “Fan S. Noli” në Kamenicë dhe me të njëjtin numër të të anketuarve edhe në SHFMU “Skënderbeu” në Hogosht.

Të njëjtin hulumtim e kemi bërë edhe në dy shkolla fillore të komunës së Vitisë, duke i anketuar 40 mësime dhe 80 nxënës në SHFMU “Dëshmorët e Vitisë” në Viti dhe me të njëjtin numër të të anketuarve edhe në SHFMU “Njazi Rexhepi” në Sllatinë.

Përmes metodave cilësore kemi intervistuar drejtorët (drejtuesit) e gjashtë shkollave të lartpërmendura të regjionit të Anamoravës së Kosovës, dy nga komuna e Gjilanit, dy nga komuna e Kamenicës dhe dy nga komuna e Vitisë.

Për t'u siguruar dhe për të realizuar të dhënat të cilat i kemi paraparë, kemi përdorur pyetësin me nxënës dhe mësime dhe intervistën e standardizuar me drejtues të shkollave.

Ky studim është fokusuar në perceptimet e mësimeve, të nxënësve dhe parimet e përcaktuara nga udhëheqësit e shkollave respektive, me një interes specifik për komponentin “zbatim dhe ndikim” i inovacioneve mësimore në mësimdhënie.

Në këtë studim, variabël e varur është “performanca mësimore” si rrjedhojë e “zbatimit dhe ndikimit të inovacioneve në mësimdhënie”. Ky studim përfshin përkufizimet ligjore të shkollave, të cilat janë marrë në studim nga rajoni i Anamoravës së Kosovës, në të cilat zhvillohet procesi mësimor në nivelin fillor nëntëvjeçar. Me “performancë” të mësimdhënies, ky studim kupton ecurinë e aktiviteteve mësimore gjatë procesit të mësimdhënies.

Për të matur performancën e shkollave fillore në regjionin e Anamoravës së Kosovës, ky studim ka zgjedhur dy indikatorë matës:

- Indikator i parë ka natyrë të informacionit;
- Indikator i dytë ka natyrë menaxheriale.

Bazuar në indikatorët dhe parametrat matës, ky studim e sheh variancën e performancës së shkollave në kahun pozitiv. Do të thotë, parametrat matës tregojnë një gjendje më të mirë ose një tendencë rritjeje apo përmirësimi;

Variabël i pavarur në këtë studim është “inovacioni.” Në këtë studim me inovacion kuptohet ai lloj komunikimi i integruar me qëllim të realizimit të mësimdhënies, që përfshin në misionin e vet strategjitë e reja organizative.

Argumenti qendror i këtij studimi është performanca që matet tek shkollat fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës, që mund të shpjegohet me qëndrimin që drejtuesit e tyre mbajnë jo vetëm ndaj ndikimit të inovacionit mësimor, në përgjithësi, por edhe ndaj zbatimi të tij, në veçanti.

Modeli dhe kuadri analitik që shoqëron këtë argument, analizon dy dinamika marrëdhëniesh:

- 1) marrëdhëniet mes komponentëve të inovacionit dhe
- 2) marrëdhëniet mes inovacionit në mësimdhënie si dhe komponentëve të tij.

Gjatë këtij hulumtimi, kemi përdorur disa nga metodat që kemi menduar se janë më të përshtatshme, nëpërmjet të cilave jemi munduar të hulumtojmë këtë problem mjaft të ndjeshëm për shkollat fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës, mes të cilave na është bërë puna më e lehtë për t'i hyrë këtij hulumtimi.

## **4.2. Metodatat e hulumtimit**

Në hulumtimin tonë, konkretisht në pjesën teorike, jemi përpjekur të grumbullojmë sa më shumë të dhëna lidhur me inovacionet mësimore, të cilat u referohen përparësive dhe kufizimeve në procesin e mësimdhënies, duke hulumtuar literaturë vendore, të huaj, ueb faqe etj.

Në përzgjedhjen e metodave të studimit, është mbajtur në fokus qëllimi i studimit, çështjet që do të trajtohen dhe lloji i të dhënave që duhen mbledhur dhe analizuar për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore të studimit.

Në këtë studim janë përdorur metoda sasiore dhe cilësore, me qëllim për të nxjerrë në shesh të vërtetën lidhur me ndikimin e inovacioneve mësimore në mësimdhënie.

Ndër llojet e metodës sasiore të zbatuar në studim është përdorur studimi korrelacional, pasi që në esencë të studimit është hulumtimi i marrëdhënieve ndërmjet variablave, duke eksploruar ndikimet e variablave shkak - pasojë nën administrimin e instrumenteve të nevojshme për të grumbulluar të dhënat e kërkuara që dalin nga të anketuarit.

Nga kjo pikëpamje e metodologjisë, siç u theksua edhe më sipër, për këtë studim është përdorur metoda cilësore, për të përshkruar zbatimin dhe rolin e inovacioneve në shkollë, duke qenë se studimi është i interesuar edhe për perceptimet, përvojat dhe qëndrimet e drejtorëve lidhur me zbatimin dhe ndikimin e inovacioneve mësimore në mësimdhënie.

Në mënyrë që çështja e zbatimit dhe ndikimit të inovacioneve mësimore në mësimdhënie në shkollimin fillor të regjionit të Anamoravës së Kosovës, të hulumtohet

sa më drejt, mendojmë se janë zbatuar metoda të përshtatshme për realizimin e hulumtimit, ku përmes të dhënave të hulumtimit në dispozicion, brenda analizave statistikore (përmes programit SPSS) u realizuan rezultatet e dala nga anketimi dhe intervistimi. Analizat janë realizuar përmes metodës së korrelacionit.

### **4.3. Instrumentet e hulumtimit**

Instrumentet e hulumtimit përfshijnë pyetësorët e standardizuar për nxënës dhe mësimitdhënës. Përmbajnë dimensione dhe pohime të cilat mbështesin hulumtimin tonë rreth ndikimit të inovacioneve në mësimitdhënie dhe nxënie.

Për të siguruar dhe për të realizuar të dhënat të cilat i kemi paraparë me objektivat e hulumtimit, kemi përdorur *teknikën e anketimit (pyetësorin)*, për të grumbulluar të dhënat e nxënësve dhe të mësimitdhënësve dhe *teknikën e intervistës së strukturuar* për grumbullimin e të dhënave nga drejtorët e shkollave të përzgjedhura.

Instrumenti i ndërtuar është i tipit Likert, që mat frekuencën e zbatimit të variablave të studimit. Shkalla Likert, e cila i ka fillimet në vitin 1932, sipas autorëve McCollin, Ramalhoto dhe Wu (2007), përfaqëson një instrument shumë të njohur, i cili përdoret për të matur qëndrimet, preferencat, opinionet, konceptet dhe pikëpamjet e respondentëve (Kislenko dhe Grevholm, 2012). Pyetësorët i kemi hartuar duke u bazuar edhe në shembuj të pyetësorëve të përdorur nga studimet master dhe shembuj të disa pyetësorëve të standardizuar të hulumtuesve shkencorë të së njëjtës fushë të studimit.

Hulumtimi është bërë gjatë vitit shkollor 2015/2016, ndërsa pjesë e hulumtimit kanë qenë gjithsej 6 shkolla fillore të regjionit të Anamoravës së Kosovës (nga dy shkolla prej secilës komunë), gjithsej 726 subjekte hulumtimi.

Pasi që regjioni i Anamoravës së Kosovës, sipas hartave të pas Luftës së Dytë Botërore, përbëhet nga tri komuna të mëdha me shumicë shqiptare: Gjilan, Kamenicë dhe Viti, për hulumtim i kemi marrë të tri komunat, edhe pse tani ekzistojnë edhe tri komuna të banuara nga minoriteti serb, të formuara viteve të fundit (Ranillug, Killokot, Partesh). Arsyeja pse nuk janë komunat serbe pjesë e hulumtimit tonë, për fat të keq, është thjesht politike, nuk kanë pranuar të anketohen, edhe pse jemi munduar t'i bindim se ky hulumtim është personal-shkencor dhe nuk ka karakter politik.

Përzgjedhja e kampionit të mësimdhënësve është bërë sipas metodës së kampionimit të thjeshtë rastësor, duke i anketuar të gjithë ata 40 mësimdhënës që ishin të pranishëm në momentet e anketimit. Së pari kemi shpërndarë pyetësorët dhe pas tri ditësh i kemi marrë ata. Po ashtu, edhe përzgjedhjen e kampionit të nxënësve e kemi bërë rastësisht, duke filluar nga klasa e katërt deri në të nëntën, duke përzgjedhur nga 10 nxënës për klasat IV dhe V, dhe nga 15 nxënës për klasat VI, VII, VIII dhe IX. Përzgjedhjen e nxënësve e kemi bërë sipas numrave tek, që kishin në ditarë. Pyetësorët i kanë marrë nxënësit në shtëpi dhe pas tri dite ato i kanë dorëzuar tek drejtori i shkollës.

Drejtorët e gjashtë shkollave të regjionit të Anamoravës së Kosovës i kemi intervistuar të njëjtën ditë kur ua kemi shpërndarë pyetësorët nxënësve dhe mësimdhënësve.

Përpunimin e të dhënave e kemi bërë përmes programit Microsoft Office Excel, duke aplikuar përpunimin statistikor përmes SPSS-së me kodin e të dhënave sipas pyetjeve të pyetësorëve.

#### **4.4. Kampioni i hulumtimit**

Pasi që popullacioni i hulumtimit të nxënësve dhe mësimit, numerikisht është shumë i madh dhe në pamundësi për t'i përfshirë të gjithë në hulumtim, atëherë këtë problem e kemi zgjidhur ta hulumtojmë përmes kampionit të gjashtë shkollave fillore në tri komuna të regjionit të Anamoravës së Kosovës.

Përcaktimin tonë për kampionin e hulumtimit në këto shkolla, e kemi bërë ngase regjioni i Anamoravës së Kosovës:

- Llogaritet me numër të madh nxënësish dhe mësimit;
- Në gjithë regjionin zbatohen të njëjtat praktika shkollore;
- Zbatohen të njëjtat plane dhe programe mësimore.

Kampioni ynë i zgjedhur përbëhet prej tri grupe subjektsh:

*a) Grupi i parë* është prej 240 mësimit të tri komunave të regjionit të Anamoravës së Kosovës (6 shkolla fillore nga 40 mësimit ose nga dy shkolla prej secilës komunë).

*b) Grupi i dytë* përbëhet prej 480 nxënësve të tri komunave, apo prej secilës komunë nga dy shkolla (6 shkolla fillore nga 80 nxënës, duke përfshirë nxënësit nga klasa IV - IX). Klasën e parë, të dytë dhe të tretë, nuk i kemi futur në hulumtim ngase ata mund të hasnin vështirësi në të kuptuarit e termit inovacion mësimor, ndaj edhe do të mund të krijoheshin paqartësi në plotësimin e pyetësorit.

*c) Grupi i tretë* përbëhet prej gjashtë drejtorëve të gjashtë shkollave të regjionit të Anamoravës së Kosovës, nga dy drejtorë prej secilës komunë, apo nga një drejtor prej secilës shkollë.

Tabela: 1 Pasqyra tabelore e shkollave pjesëmarrëse në hulumtim

Nr	Shkolla	Cikli shkollor	Vendi	Mësimdhënës	Nxënës	Drejtorë	Gj.
1	Thimi Mitko	SHFMU	Gjilan	40	80	1	121
2	Skënderbeu	SHFMU	Përlepticë	40	80	1	121
3	Fan S. Noli	SHFMU	Kamenicë	40	80	1	121
4	Skënderbeu	SHFMU	Hogosht	40	80	1	121
5	Dëshmorët e Vitisë	SHFMU	Viti	40	80	1	121
6	Njazi Rexhepi	SHFMU	Sllatinë	40	80	1	121
Gj	6	6	6	240	480	6	726

#### 4.5. Variablat

Për ta kuptuar rëndësinë e problemit të ndikimit të inovacioneve në mësimdhënie, është më se e nevojshme që më parë të njihemi me shkaqet dhe pasojat e kësaj dukurie.

Për këtë arsye, hulumtimi ynë ka qenë i orientuar të studiojë dy variablat themelore, të njohura si variabla e pavarur dhe variabla e varur.

- *Variabla e pavarur* përcakton faktorët që e shkaktojnë dukurinë, apo shkallën e ndryshimeve në organizimin e mësimdhënies, siç janë vetë inovacionet mësimore në mësimdhënie.



Variabla e pavarur në këtë studim është “inovacioni.” Në këtë studim me inovacion kuptohet ai lloj komunikimi i integruar me qëllim të realizimit të mësimdhënies, që përfshin në misionin e vet strategjitë e reja organizative.

- *Variabla e varur* është vetë mësimdhënia, me qëllim të shtimit të besueshmërisë së nxënësve ndaj nxënies në synim të arritjeve të rezultateve më të mira në shkollë.

Në këtë studim, variabël e varur është “performanca mësimore”, si rrjedhojë e zbatimit dhe ndikimit të inovacioneve në mësimdhënie.

#### **4.6. Vlefshmëria dhe besueshmëria e studimit**

Për të hulumtuar marrëdhëniet ndërmjet mësimdhënësit dhe ndikimit të inovacioneve mësimore në mësimdhënie dhe rezultatet që dalin nga to, është bërë kryesisht një kërkim empirik, pasi hipotezat e formuluar testohen duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara nëpërmjet:

(a) matjeve me pyetësorë të strukturuar të pohimeve të nxënësve dhe mësimdhënësve dhe

(b) matjeve me anë të intervistave të strukturuar të përgjigjeve të drejtorëve të shkollave.

Për të arritur tek gjetjet dhe përfundimet është proceduar nëpërmjet ndjekjes së hapave që pasojnë njëri-tjetrit, si: përcaktimi i problemit, shqyrtimi i literaturës, formulimi i hipotezave, grumbullimi i të dhënave, analiza e gjetjeve dhe nxjerrjet përfundimtare.

Studimi garanton vlefshmëri të brendshme dhe të jashtme të gjetjeve të gjeneruara nga analizat sasiore dhe cilësore në përputhje me standardet e studimit dhe me metodat e përzgjedhura. Vlefshmëria e brendshme garantohet pasi që të gjitha gjetjet dhe përfundimet e studimit janë rezultat i analizave statistikore.

Këto analiza janë kryer në programin SPSS dhe garantojnë sigurinë e rezultateve të përfituara.

Vlefshmëria e jashtme garantohet pasi gjetjet dhe përfundimet e studimit mund të përgjithësohen në popullata të tjera studimore dhe të vërtetohen në shkollat ku është kryer hulumtimi. Gjetjet dhe përfundimet e studimit, përfaqësojnë jo vetëm popullatën e nxënësve, mësimmësuesve dhe drejtorëve të shkollimit fillor, por mund të përdoren si referenca edhe për popullata të tjera të ngjashme.

Besueshmëria e brendshme sigurohet nga fakti që në rast se studimi do të përsëritej në të njëjtat kushte, atëherë do të arriheshin të njëjtat gjetje dhe përfundime. Kjo vjen nga zbatimi me konsekuencë i metodologjisë shkencore të studimit në të gjithë hapat e tij, që nga formulimi i pyetjes kërkimore, formulimi i qëllimit të studimit, përcaktimi i hipotezave dhe variablave, përshtatja e metodave, hartimi i instrumenteve, grumbullimi i të dhënave, analizave dhe përpilimi i përfundimeve dhe rekomandimeve.

Studimi siguron besueshmëri të brendshme dhe të jashtme të gjetjeve, duke ofruar përfundime të qëndrueshme.

#### **4.7. Etika**

Gjatë planifikimit të punës kërkimore në terren, kemi menduar edhe për etikën e hulumtimit. Tema jonë doktrale është në funksion të ngritjes së cilësisë së shkollave tona dhe për atë arsye kjo temë nuk ka qenë edhe aq e ndjeshme për subjektet e hulumtimit.

Nga drejtoritë komunale të arsimit dhe drejtorët e shkollave të caktuara për hulumtim, kemi kërkuar lejen, duke u pajtuar edhe me rregullat e tyre në lidhje me kohën dhe kushtet e hulumtimit.

Qëllimi i hulumtimit ishte që puna jonë kërkimore të mos e pengojë punën në procesin mësimor dhe të mos jetë shqetësim as për subjektet e hulumtimit e as për të tjerët që nuk përfshihen në hulumtim.

Gjatë realizimit të intervistave me drejtorët e shkollave, jemi munduar të gjejmë mënyrën dhe kohën më të përshtatshme, duke u kujdesur që ata të ndihen të lirë, komodë e të respektuar dhe që në fillim i kemi siguruar ata se për hulumtimin tonë janë me rëndësi opinionet dhe përvojat e tyre lidhur me zbatimin dhe ndikimin e inovacioneve mësimore në shkollë.

Komunikimi me respondentët ishte shumë i hapur dhe miqësor, etik dhe mbështetës. Asnjë e dhënë personale e respondentëve nxënës, mësimdhënës dhe drejtorë, të përfshirë në studim, nuk është përdorur për asnjë arsye tjetër, përveçse për efekt studimi. Asnjë e dhënë personale e respondentëve nxënës, mësimdhënës dhe drejtorë, nuk është publikuar dhe të gjitha të dhënat janë përdorur vetëm për studim.

Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga nxënësit, mësimitdhënësit dhe drejtorët e SHFMU të regjionit të Anamoravës së Kosovës, ruhen me përgjegjësi të plotë dhe nuk do të përdoren për asnjë qëllim tjetër, që nuk ka lidhje me këtë studim.

Pyetësorët kanë qenë anonimë, me qëllim që, sikurse mësimitdhënësit, ashtu edhe nxënësit, të mos dyshojnë aspak lidhur me mënyrën e përdorimit të tyre

#### **4.8. Kufizimet e studimit**

Për realizimin e këtij studimi, si instrument matës janë përdorur pyetësorë për nxënësit dhe mësimitdhënësit, ndërsa me drejtorët është përdorur intervista.

Pasi që gatishmëria e të anketuarve ishte që pyetësorin ta plotësonin në shtëpi apo jashtë kujdesit të studiuesit, kufizimet kanë mundur të jenë nga natyra të ndryshme, si:

- Besueshmëria e plotësimit të pyetësorëve nga të anketuarit nuk mund të themi se është edhe aq e sigurt, pasi që ato nuk janë plotësuar para studiuesit.
- Shpërndarja e pyetësorëve për mësimitdhënësit ishte e rastit, pa dallim moshe, gjinie apo kualifikimi.
- Shpërndarja e pyetësorëve për nxënësit ka qenë sipas numrit tek, që kishin në ditarë.
- Disa nga pyetësorët nuk kanë qenë të plotësuar nga të anketuarit.
- Si kufizim tjetër ishte edhe fakti se jo të gjithë drejtorët e shkollave të kontaktuar, kishin dëshirë të ishin pjesë e intervistimit. Mungesa e dëshirës lidhej kryesisht me mungesën e besimit, se ndoshta mund të dalë diçka jo e mirë për ta.

Për sa u përket kufizimeve të literaturës së gjetur në lidhje me këtë problematikë, jemi mbështetur në literaturën bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos në atë ku është ecur më përpara në sistemin edukativ dhe arsimor, e në veçanti në literaturën anglo -amerikane.

## **KAPITULLI V: ANALIZË EMPIRIKE**

### **5.1 ANALIZA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE**

Ky kapitull paraqet gjetjet e hulumtimit tonë doktoral. Nëpërmjet këtyre gjetjeve do të përpiqemi të vërtetojmë hipotezën dhe t'u japim përgjigje pyetjeve të hulumtimit. Më poshtë do të paraqesim të dhënat e hulumtimit me nxënësit dhe mësime të mësuara, si dhe rezultatet e intervistave me drejtorët e shkollave, të cilat janë zhvilluar në 6 shkolla fillore të komunës së Gjilanit, Kamenicës dhe Vitisë. Pra, nga dy shkolla për secilën komunë.

## 5.2 TESTI I BESUESHMËRISË

Testi i besueshmërisë përcakton nëse pyetëtori dhe pyetjet janë relevante dhe të besueshme. Nga tabela e mëposhtme, mund të shohim nivelin e besueshmërisë prej **.993 Cronbach's Alpha**, që është nivel shumë i lartë i besueshmërisë. Nga kjo themi se pyetëtori ynë të cilin e kemi përdorur është tepër i besueshëm dhe na e mundëson të vërtetojmë hipotezat e hulumtimit. Në tabelën e parë është testi i besueshmërisë për pyetëtorin e mësimdhënësve, ku janë gjithsej 240 respondentë/mësimdhënës, ndërsa në tabelën e dytë shohim nivelin e besueshmërisë për pyetëtorin e nxënësve ku ishin pjesëmarrës rreth 480 respondentë/nxënës. Në të dyja rastet niveli i besueshmërisë është **.993 Cronbach's Alpha**.

### Mësimdhënësit

### Nxënësit

Tabela: 2 Analiza e besueshmërisë – Mësimdhënësit

Tabela: 3 Analiza e besueshmërisë - Nxënësit

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	240	100.0
	Excluded <sup>a</sup>	0	.0
	Total	240	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	480	100.0
	Excluded <sup>a</sup>	0	.0
	Total	480	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela: 4 Analiza e besueshmërisë - Mësimdhënësit 2

Tabela: 5 Analiza e besueshmërisë - Nxënësit 2

Reliability Statistics	
<b>Cronbach's Alpha</b>	N of Items
<b>.993</b>	18

Reliability Statistics	
<b>Cronbach's Alpha</b>	N of Items
<b>.993</b>	18

### 5.3 Të dhënat deskriptive - Nxënësit

Tabela: 6 Shkolla dhe komuniteti kanë prioritet ndryshimet që sjellin rezultate më të mira në shkollë?


Shkolla dhe komuniteti kanë prioritet ndryshimet që sjellin rezultate më të mira në shkollë? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count								
		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDE RBEU" Përlepticë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDE RBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHM ORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHE PI" Slatinë	
Shkolla dhe komuniteti kanë prioritet ndryshimet që sjellin rezultate më të mira në shkollë?	SHUMË	29	52	42	47	28	60	258
	PAK	29	15	21	21	29	11	126
	ASPAK	14	7	7	4	14	4	50
	NUK E DI	7	4	8	5	7	3	34
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	2	2	3	2	2	12
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim se tek pyetja: Shkolla dhe komuniteti kanë prioritet ndryshimet që sjellin rezultate më të mira në shkollë? Është kryqëzuar me shkollat, mund të shohim rezultate të ndryshme. Siç mund të vërehet, të gjitha shkollat dominojnë me përgjigjen `Shumë`, që nënkupton se për ta shkolla dhe komuniteti janë prioritet për ndryshime më të mira në shkollë, me 258 përgjigje në total, `Pak` janë përgjigjur 126, 50 janë përgjigjur `Aspak`, 34 `Nuk e di` dhe 12 nuk janë përgjigjur fare.



Figura: 1 Shkolla dhe komuniteti kanë prioritet ndryshimet qe sjellin rezultate më të mira ne shkollë

**Shkolla dhe komuniteti kanë prioritet ndryshimet që sjellin rezultatet më të mira në shkollë**



**Shkolla dhe komuniteti kanë prioritet ndryshimet që sjellin rezultate më të mira në shkollë**

Tabela: 7 Mjedisi shkollor nxit dhe zhvillon aftësitë tuaja individuale për të ditur më shumë?

Mjedisi shkollor nxit dhe zhvillon aftësitë tuaja individuale për të ditur më shumë? * SHKOLLA								
Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU U "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnice	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenice	SHFMU "SKËNDERB EU" Hogosht	SHFMU "DËSHMO RËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Slatinë	
Mjedisi	SHUMË	26	36	52	49	53	52	268
shkollor nxitë	PAK	33	27	16	16	11	13	116
dhe zhvillon	ASPAK	13	9	5	5	11	9	52
aftësitë tuaja	NUK E DI	8	7	5	8	4	5	37
individuale	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	0	1	2	2	1	1	7

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen se: Mjedisi shkollor nxit dhe zhvillon aftësitë tuaja individuale për të ditur më shumë? Nxënësit u përgjigjën në këto mënyra: 268 nxënës nga të gjitha shkollat u përgjigjën ‘Shumë’, 116 u përgjigjën ‘Pak’, 52 u përgjigjën ‘Aspak’, 37 ‘Nuk e di’ dhe 7 prej tyre nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë se shumica e nxënësve e konsiderojnë të rëndësishëm mjedisin shkollor.

Figura: 2 Mjedisi shkollor nxit dhe zhvillon aftësitë tuaja individuale?




Tabela: 8 Mësimdhënësit diskutojnë me ju lidhur me përzgjedhjen e strategjive të reja mësimore?

Mësimdhënësit diskutojnë me ju lidhur me përzgjedhjen e strategjive të reja mësimore? * SHKOLLA								
Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Slatinë	
Mësimdhënësit diskutojnë me ju lidhur me përzgjedhjen e strategjive të reja mësimore?	0	1	0	0	0	0	0	1
	SHUMË	30	45	60	45	56	48	284
	PAK	31	21	11	16	9	15	103
	ASPAK	18	9	4	12	9	6	58
	NUK E DI	0	4	3	6	4	9	26
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	0	1	2	1	2	2	8
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen nëse: Mësimdhënësit diskutojnë me ju lidhur me përzgjedhjen e strategjive të reja mësimore? Nxënësit u përgjigjën në këtë mënyrë: 284 nxënës u përgjigjën ‘Shumë’, 103 u përgjigjën ‘Pak’, 58 ‘Aspak’, 26 ‘Nuk e di’ dhe 8 nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë se shumica e nxënësve janë të kënaqur me diskutimet që mësimdhënësit i bëjnë me nxënës në përzgjedhjen e strategjive.

Figura: 3 Mësimdhënësit diskutojnë me ju lidhur me përzgjedhjen e strategjive të reja mësimore?




Tabela: 9 Mësimdhënësit ju angazhojnë të njiheni me teknika dhe teknologji të reja mësimore?

Mësimdhënësit ju angazhojnë të njiheni me teknika dhe teknologji të reja mësimore? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan'	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë'	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti'	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Mësimdhënësit ju angazhojnë të njiheni me teknika dhe teknologji të reja mësimore?	SHUMË	22	35	48	28	47	46	226
	PAK	31	27	10	29	20	21	138
	ASPAK	16	12	7	14	6	10	65
	NUK E DI	10	4	14	7	4	2	41
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	2	1	2	3	1	10
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shihen rezultatet e pyetjes: Mësimdhënësit ju angazhojnë të njiheni me teknika dhe teknologji të reja mësimore? Nga gjithsej 480 nxënës , 226 janë përgjigjur ‘Shumë’, 138 janë përgjigjur ‘Pak’, 65 janë përgjigjur ‘Aspak’, 41 janë përgjigjur ‘Nuk e di’, 10 nuk janë përgjigjur. Nga ky rezultat themi se mësimdhënësit nuk janë edhe aq të angazhuar në zbatimin e teknikave dhe teknologjive të reja mësimore.

Figura: 4 Mësimdhënësit ju angazhojnë të njiheni me teknika dhe teknologji të reja mësimore?




Tabela: 10 Përzgjedhjet apo aktivitetet mësimore nga mësimdhënësit, janë të përshtatshme për ju?

Përzgjedhjet apo aktivitetet mësimore nga mësimdhënësit, janë të përshtatshme për ju? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count								
		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepticë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Përzgjedhjet apo aktivitetet mësimore nga mësimdhënësit, janë të përshtatshme për ju?	SHUMË	26	45	40	25	40	50	226
	PAK	38	22	28	33	21	12	154
	ASPAK	7	8	5	13	10	9	52
	NUK E DI	8	3	5	8	6	7	37
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	2	2	1	3	2	11
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Përzgjedhjet apo aktivitetet mësimore nga mësimdhënësit, janë të përshtatshme për ju? Nxënësit u përgjigjën në këtë mënyrë: 226 prej tyre u përgjigjën ‘Shumë’, 154 u përgjigjën ‘Pak’, 52 u përgjigjën ‘Aspak’, 37 u përgjigjën ‘Nuk e di’ dhe 11 nuk janë përgjigjur. Nga kjo mund të themi se mësimdhënësit nuk janë të kujdesshëm ndaj përzgjedhjeve apo aktiviteteve të cilat i realizojnë.

Figura: 5 Përzgjedhjet apo aktivitetet mësimore nga mësimdhënësit, janë të përshtatshme për ju?




Tabela: 11 Në shkollën tuaj jeni të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies?

Në shkollën tuaj jeni të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnjë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORË T E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Në shkollën tuaj jeni të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies?	0	0	0	0	1	0	0	1
	SHUMË	37	36	53	29	44	47	246
	PAK	24	21	18	31	20	10	124
	ASPAK	12	11	3	18	10	12	66
	NUK E DI	5	8	4	0	4	10	31
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	2	4	2	1	2	1	12
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim se pyetjes: Në shkollën tuaj jeni të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies? Nga 480 nxënës, 246 janë përgjigjur ‘Shumë’, 124 ‘Pak’, 66 janë përgjigjur ‘Aspak’, 31 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 12 nuk janë përgjigjur. Nga ky rezultat mund të konkludojmë se nxënësit ose shumica e nxënësve janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënësve

Figura: 6 Në shkollën tuaj jeni të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies?




Tabela: 12 Mësimdhënësit zbatojnë mjete, metoda, teknika dhe teknologji inovative mësimore?

Mësimdhënësit zbatojnë mjete, metoda, teknika dhe teknologji inovative mësimore? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnice	SHFMU "FAN S NOLI" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Mësimdhënësit zbatojnë mjete, metoda, teknika dhe teknologji inovative mësimore?	SHUMË	33	51	47	60	40	49	280
	PAK	36	13	21	11	27	14	122
	ASPAK	9	9	4	4	6	9	41
	NUK E DI	1	5	5	3	5	6	25
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	2	3	2	2	2	12
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Mësimdhënësit zbatojnë mjete, metoda, teknika dhe teknologji inovative mësimore? Nga kjo del se 280 nxënës janë përgjigjur ‘Shumë’, 122 janë përgjigjur ‘Pak’, 41 janë përgjigjur ‘Aspak’, 25 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 12 nuk kanë dhënë përgjigje. Nga ky rezultat mund të konkludojmë se nxënësit janë të kënaqur me punën e mësimdhënësve dhe metodat të cilat ata i aplikojnë.

Figura: 7 Mësimdhënësit zbatojnë mjete, metoda, teknika dhe teknologji inovative mësimore?




Tabela: 13 Mësimdhënësit përshtatin inovacionet mësimore me përmbajtjet mësimore?

Mësimdhënësit përshtatin inovacionet mësimore me përmbajtjet mësimore? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" ' Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" ' Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEP" Sllatinë	
Mësimdhënësit përshtatin inovacionet mësimore me përmbajtjet mësimore?	SHUMË	37	44	45	40	29	56	251
	PAK	29	20	16	28	38	9	140
	ASPAK	6	10	12	5	6	9	48
	NUK E DI	7	4	6	5	4	4	30
	KANË DEVIJUAR ( Nuk janë përgjigjur )	1	2	1	2	3	2	11
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Mësimdhënësit përshtatin inovacionet mësimore me përmbajtjet mësimore? Nga 480 nxënës, 251 janë përgjigjur ‘Shumë’, 140 janë përgjigjur ‘Pak’, 48 janë përgjigjur ‘Aspak’, 30 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 11 nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të themi se nxënësit janë të kënaqur me punën të cilën e bëjnë mësimdhënësit.

Figura: 8 Mësimdhënësit përshtatin inovacionet mësimore me përmbajtjet mësimore?






Tabela: 14 Në momentet e paraqitjes së inovacioneve mësimore, ndiheni të motivuar për nxënie?

Në momentet e paraqitjes së inovacioneve mësimore, ndiheni të motivuar për nxënie? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnice	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenice	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORE E VITISE" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatine	
Në momentet e paraqitjes së inovacioneve mësimore, ndiheni të motivuar për nxënie?	SHUMË	52	47	52	28	40	47	266
	PAK	17	20	13	29	28	20	127
	ASPAK	6	6	9	14	5	6	46
	NUK E DI	3	5	5	7	5	4	29
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	2	2	1	2	2	3	12
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Në momentet e paraqitjes së inovacioneve mësimore, ndiheni të motivuar për nxënie? Nga 480 nxënës, 266 janë përgjigjur ‘Shumë’, 127 janë përgjigjur ‘Pak’, 46 janë përgjigjur ‘Aspak’, 29 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 12 nuk janë përgjigjur. Nga ky rezultat del se nxënësit ndihen të motivuar me punën që bëjnë mësimmhënësit në shkollë.

Figura: 9 Në momentet e paraqitjes së inovacioneve mësimore, ndiheni të motivuar për nxënie?




Tabela: 15 Mësimdhënësit shpesh zbatojnë inovacione mësimore në klasë?

Mësimdhënësit shpesh zbatojnë inovacione mësimore në klasë? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Mësimdhënësit shpesh zbatojnë inovacione mësimore në klasë?	SHUMË	41	39	48	25	53	52	258
	PAK	27	18	15	33	18	15	126
	ASPAK	6	15	6	13	3	7	50
	NUK E DI	5	7	9	8	4	4	37
	KANË DEVIJUAR ( Nuk janë përgjigjur )	1	1	2	1	2	2	9
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Mësimdhënësit shpesh zbatojnë inovacione mësimore në klasë? Nga 480 nxënës, 258 janë përgjigjur ‘Shumë’, 126 janë përgjigjur ‘Pak’, 50 janë përgjigjur ‘Aspak’, 37 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 9 nuk janë përgjigjur. Nga ky rezultat shohim se shumica e nxënësve shprehen të kënaqur me inovacionet që mësimdhënësit i përdorin në klasë.

Figura: 10 Mësimdhënësit shpesh zbatojnë inovacionet mësimore në klasë?




Tabela: 16 Aktivitetet inovative në klasë janë nxitës të mirë për të nxënë?

Aktivitetet inovative në klasë janë nxitës të mirë për të nxënë?								
* SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBE U" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" ' Slatinë	
		Aktivitetet inovative në klasë janë nxitës të mirë për të nxënë?	0	0	0	0	1	
	SHUMË	41	43	46	29	47	36	242
	PAK	24	23	21	31	21	27	147
	ASPAK	6	6	10	18	4	9	53
	NUK E DI	8	5	2	0	5	7	27
	KANË DEVIJUAR ( Nuk janë përgjigjur )	1	3	1	1	3	1	10
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Aktivitetet inovative në klasë janë nxitës të mirë për të nxënë? Nga 480 nxënës, 242 janë përgjigjur ‘Shumë’, 147 janë përgjigjur ‘Pak’, 53 janë përgjigjur ‘Aspak’, 27 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 10 kanë devijuar apo fare nuk janë përgjigjur. Nga kjo kuptojmë se shumica e nxënësve shprehin se inovacionet në klasë janë nxitës të mirë për të nxënë.

Figura: 11 Aktivitetet inovative në klasë janë nxitës të mirë për të nxënë?




Tabela: 17 Gjërat e reja ju tërheqin më shumë për të mësuar?

Gjërat e reja ju tërheqin më shumë për të mësuar? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO"	SHFMU "SKËNDERBEU"	SHFMU "FAN S NOLI"	SHFMU "SKËNDERBEU"	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË"	SHFMU "NJAZI REXHEPI"	
		Gjilan	' Përlepnicë	Kamenicë	Hogosht	Viti	Sllatinë	
Gjërat e reja ju tërheqin më shumë për të mësuar?	SHUMË	30	48	50	47	49	45	269
	PAK	38	18	12	20	16	21	125
	ASPAK	6	7	9	6	5	9	42
	NUK E DI	4	5	7	5	8	4	33
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	2	2	2	2	2	1	11
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme, mund të shohim rezultatet në pohimin se: Gjërat e reja ju tërheqin më shumë për të mësuar? Nga 480 nxënës , 269 janë përgjigjur ‘Shumë’, 125 janë përgjigjur ‘Pak’, 42 janë përgjigjur ‘Aspak’, 33 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 11 nuk janë përgjigjur. Nga kjo kuptojmë se shumica e nxënësve janë shprehur se gjërat e reja i tërheqin më shumë për të mësuar.

Figura: 12 Gjërat e reja ju tërheqin më shumë për të mësuar?




Tabela: 18 Jeni kureshtarë për të mësuar diç të re nga mësimdhënësit?

Jeni kureshtarë për të mësuar diç të re nga mësimdhënësit? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Jeni kureshtarë për të mësuar diç të re nga mësimdhënësit?	SHUMË	45	38	47	39	45	35	249
	PAK	27	24	10	18	16	27	122
	ASPAK	5	10	12	15	12	12	66
	NUK E DI	3	6	10	7	6	4	36
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	0	2	1	1	1	2	7
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Jeni kureshtarë për të mësuar diç të re nga mësimdhënësit? Nga 480 nxënës gjithsej, 249 janë përgjigjur ‘Shumë’, 122 janë përgjigjur ‘Pak’, 66 janë përgjigjur ‘Aspak’, 36 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 7 nuk kanë dhënë përgjigje. Në bazë të këtyre rezultateve mund të konkludojmë se shumica e nxënësve ndihen kureshtarë për të mësuar gjëra të reja nga mësimdhënësit.

Figura: 13 Jeni kureshtarë për të mësuar diç të re nga mësimdhënësit?




Tabela: 19 Është tërheqëse ora mësimore atëherë kur mësimdhënësit zbatojnë inovacione mësimore?

Është tërheqëse ora mësimore atëherë kur mësimdhënësit zbatojnë inovacione mësimore? *								
SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Është tërheqëse ora mësimore atëherë kur mësimdhënësit zbatojnë inovacione mësimore?	SHUMË	34	48	49	43	52	21	247
	PAK	32	18	14	23	13	31	131
	ASPAK	7	5	9	6	9	16	52
	NUK E DI	6	5	6	5	5	10	37
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	4	2	3	1	2	13
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim edhe rezultatet për pyetjen: Është tërheqëse ora mësimore atëherë kur mësimdhënësit zbatojnë inovacione mësimore? Nga 480 nxënës gjithsej, 247 janë përgjigjur ‘Shumë’, 131 janë përgjigjur ‘Pak’, 52 janë përgjigjur ‘Aspak’, 37 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 13 fare nuk kanë dhënë përgjigje. Në bazë të rezultateve, shohim se në raste kur mësimdhënësit zbatojnë inovacionet mësimore, për shumicën e nxënësve ora mësimore është tërheqëse.

Figura: 15 Është tërheqëse ora mësimore atëherë kur mësimdhënësit zbatojnë inovacione mësimore?




Tabela: 20 Inovacionet mësimore, ndikojnë që rezultatet në shkollë të jenë më të mira?

Inovacionet mësimore, ndikojnë që rezultatet në shkollë të jenë më të mira? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDER BEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDER BEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Inovacionet mësimore, ndikojnë që rezultatet në shkollë-klasë të jenë më të mira?	SHUMË	40	38	53	40	48	25	244
	PAK	30	27	11	27	15	38	148
	ASPAK	6	5	11	6	6	7	41
	NUK E DI	4	8	4	5	9	8	38
	KANË DEVIJUAR ( Nuk janë përgjigjur )	0	2	1	2	2	2	9
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet e pyetjes: Inovacionet mësimore, ndikojnë që rezultatet në shkollë të jenë më të mira? Nga 480 nxënës gjithsej, 244 janë përgjigjur ‘Shumë’, 148 janë përgjigjur ‘Pak’, 41 janë përgjigjur ‘Aspak’, 38 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 9 nuk janë përgjigjur. Nga kjo mund të konkludojmë se shumica e nxënësve janë të mendimit se inovacionet mësimore ndikojnë që rezultatet në shkollë-klasë të jenë më të mira.

F Figura: 16 . Inovacionet mësimore, ndikojnë që rezultatet në shkollë-klasë të jenë më të mira?




Tabela: 21 Inovacionet mësimore ndikojnë mjaftueshëm në ngritjen e rezultateve mësimore?

Inovacionet mësimore ndikojnë mjaftueshëm në ngritjen e rezultateve mësimore? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" 'Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Inovacionet mësimore ndikojnë mjaftueshëm në ngritjen e rezultateve mësimore?	SHUMË	31	44	56	40	49	36	256
	PAK	27	16	9	24	14	24	114
	ASPAK	9	10	9	6	9	12	55
	NUK E DI	12	7	4	8	6	5	42
	KANË DEVIJUAR ( Nuk janë përgjigjur )	1	3	2	2	2	3	13
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Inovacionet mësimore ndikojnë mjaftueshëm në ngritjen e rezultateve mësimore? Nga 480 nxënës, 256 janë përgjigjur ‘Shumë’, 114 nxënës janë përgjigjur ‘Pak’, 55 nxënës janë përgjigjur ‘Aspak’, 42 nxënës janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 13 prej tyre nuk janë përgjigjur. Nga kjo mund të konkludojmë se shumica e nxënësve janë shprehur se inovacionet mësimore ndikojnë mjaftueshëm në ngritjen e rezultateve mësimore.

Figura: 17 . Inovacionet mësimore ndikojnë mjaftueshëm në ngritjen e rezultateve mësimore?







Tabela: 22 Jeni të kënaqur me rezultatet që dalin nga mësimdhënia inovative?

Jeni të kënaqur me rezultatet që dalin nga mësimdhënia inovative? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Jeni të kënaqur me rezultatet që dalin nga mësimdhënia inovative?	SHUMË	36	40	47	29	53	32	237
	PAK	28	21	20	38	11	36	154
	ASPAK	7	8	6	6	11	9	47
	NUK E DI	6	8	4	4	4	1	27
	KANË DEVIJUAR ( Nuk janë përgjigjur )	3	3	3	3	1	2	15
Total		80	80	80	80	80	80	480

Nga tabela e mësipërme mund të shohim edhe rezultatet për pyetjen: Jeni të kënaqur me rezultatet që dalin nga mësimdhënia inovative? Nga 480 nxënës gjithsej, 237 janë përgjigjur ‘Shumë’, 154 janë përgjigjur ‘Pak’, 47 janë përgjigjur ‘Aspak’, 27 janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 15 fare nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë se shumica e nxënësve janë shprehur se janë të kënaqur me rezultatet e arritura që dalin nga mësimdhënia inovative.

Figura: 18 Jeni të kënaqur me rezultatet që dalin nga mësimdhënia inovative?



## 5.4. Të dhënat deskriptive - Mësimdhënësit

Tabela: 23 Në shkollën tuaj, ka kushte të mjaftueshme për zbatimin e strategjive të reja mësimore?

Në shkollën tuaj, ka kushte të mjaftueshme për zbatimin e strategjive të reja mësimore? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Në shkollën tuaj, ka kushte të mjaftueshme për zbatimin e strategjive të reja mësimore?	SHUMË	25	15	25	15	15	17	112
	PAK	7	14	7	14	14	11	67
	ASPAK	5	6	5	6	6	6	34
	NUK E DI	2	4	2	4	4	5	21
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	1	1	1	1	1	6
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme mund të shohim edhe rezultatet për pyetjen: Në shkollën tuaj, ka kushte të mjaftueshme për zbatimin e strategjive të reja mësimore? Nga 240 mësimdhënës gjithsej, 112 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Shumë’, 67 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Pak’, 34 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Aspak’, 21 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 6 mësimdhënës nuk kanë dhënë përgjigje. Në bazë të kësaj, mund të konkludojmë se mësimdhënësit nuk janë të kënaqur me kushtet e ofruara në shkollë.

Figura: 19 Në shkollën tuaj, ka kushte të mjaftueshme për zbatimin e strategjive të reja mësimore?




Tabela: 24 Shkolla ju nxit në zbatimin e mësimdhënies bashkëkohore?

Shkolla ju nxit në zbatimin e mësimdhënies bashkëkohore? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepticë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Shkolla ju nxit në zbatimin e mësimdhënies bashkëkohore?	SHUMË	18	22	18	25	22	25	130
	PAK	16	9	16	7	9	7	64
	ASPAK	3	4	3	5	4	4	23
	NUK E DI	2	4	2	2	4	3	17
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	1	1	1	1	1	6
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Shkolla ju nxit në zbatimin e mësimdhënies bashkëkohore? Nga 240 mësimdhënës gjithsej, 130 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Shumë’, 64 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Pak’, 23 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Aspak’, 17 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 6 mësimdhënës fare nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë se shumica e mësimdhënësve janë shprehur se shkolla prej nga ata vijnë, nxit në zbatimin e mësimdhënies bashkëkohore.

Figura: 20 Shkolla ju nxitë në zbatimin e mësimdhënies bashkëkohore?




Tabela: 25 Bashkëpunoni me kolegët tuaj lidhur me gjetjen e mundësive më të mira për mësimdhënie?

Bashkëpunoni me kolegët tuaj lidhur me gjetjen e mundësive më të mira për mësimdhënie? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" 'Përlepnicë'	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" 'Hogosht'	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Bashkëpunoni me kolegët tuaj lidhur me gjetjen e mundësive më të mira për mësimdhënie?	SHUMË	28	17	28	18	17	23	131
	PAK	7	11	7	16	11	8	60
	ASPAK	3	6	3	3	6	4	25
	NUK E DI	1	5	1	2	5	4	18
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	1	1	1	1	1	6
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme mund të shohim edhe rezultatet për pyetjen: Bashkëpunoni me kolegët tuaj, lidhur me gjetjen e mundësive më të mira për mësimdhënie? Nga 240 mësimdhënës, 131 mësimdhënës janë shprehur ‘Shumë’, 60 janë përgjigjur ‘Pak’, 25 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Aspak’, 18 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 6 mësimdhënës nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo del se shumica e mësimdhënësve janë shprehur se kanë bashkëpunim të mirë në shkollë me qëllim të gjetjes së mundësive të reja në mësimdhënie.

Figura: 21 Bashkëpunoni me kolegët tuaj lidhur me gjetjen e mundësive më të mira për mësimdhënie?




Tabela: 26 Shkolla juaj është në rrjedha të ndryshimeve inovative?

Shkolla juaj është në rrjedha të ndryshimeve inovative? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Shkolla juaj është në rrjedha të ndryshimeve inovative?	SHUMË	15	25	15	28	25	18	126
	PAK	14	7	14	7	7	16	65
	ASPAK	6	4	6	3	4	3	26
	NUK E DI	4	3	4	1	3	2	17
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	1	1	1	1	1	6
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Shkolla juaj është në rrjedha të ndryshimeve inovative? Nga 240 mësimdhënës, 126 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Shumë’, 65 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Pak’, 26 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Aspak’, 17 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 6 mësimdhënës nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë që shumica e mësimdhënësve janë shprehur se shkolla prej nga ata vijnë, është në rrjedha të ndryshimeve inovative.

Figura: 22 Shkolla juaj është në rrjedha të ndryshimeve inovative?




Tabela: 27 Shkolla juaj është e pasur me teknologji të re mësimore?

Shkolla juaj është e pasur me teknologji të re mësimore? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Shkolla juaj është e pasur me teknologji të re mësimore?	SHUMË	22	23	22	15	23	28	133
	PAK	9	8	9	14	8	7	55
	ASPAK	4	4	4	6	4	3	25
	NUK E DI	4	4	4	4	4	1	21
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	1	1	1	1	1	6
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Shkolla juaj është e pasur me teknologji të re mësimore? Nga 240 mësimdhënës gjithsej, 133 janë përgjigjur ‘Shumë’, 55 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Pak’, 25 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Aspak’, 21 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 6 mësimdhënës kanë devijuar apo fare nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë se shumica e mësimdhënësve janë shprehur që shkolla është e pasur me teknologji të re mësimore.

Figura: 23 Shkolla juaj është e pasur me teknologji të re mësimore?




Tabela: 28 Shkolla juaj ka nevojë për ndryshime në teknikë dhe teknologji të re mësimore?

Shkolla juaj ka nevojë për ndryshime në teknikë dhe teknologji të re mësimore? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Shkolla juaj ka nevojë për ndryshime në teknikë dhe teknologji të re mësimore?	SHUMË	17	22	25	22	22	15	123
	PAK	11	11	7	9	11	14	63
	ASPAK	6	4	5	4	4	6	29
	NUK E DI	5	2	2	4	2	4	19
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	1	1	1	1	1	6
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme shohim rezultatet për pyetjen: Shkolla juaj ka nevojë për ndryshime në teknikë dhe teknologji të re mësimore? Nga 240 mësimdhënës gjithsej, 123 janë përgjigjur ‘Shumë’, 63 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Pak’, 29 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Aspak’, 19 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 6 mësimdhënës nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë se shumica e mësimdhënësve janë shprehur që shkolla ka nevojë për ndryshime në teknike dhe teknologji të re mësimore.

Figura: 24 Shkolla juaj ka nevojë për ndryshime në teknikë dhe teknologji të re mësimore?




Tabela: 29 Zbatoni metoda dhe teknika të reja mësimore në mësimdhënies?

Zbatoni metoda dhe teknika të reja mësimore në mësimdhënies? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Zbatoni metoda dhe teknika të reja mësimore në mësimdhënies?	SHUMË	25	21	18	17	21	22	124
	PAK	7	7	16	11	7	9	57
	ASPAK	4	5	3	6	5	4	27
	NUK E DI	3	4	2	5	4	4	22
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	3	1	1	3	1	10
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Sa zbatoni metoda dhe teknika të reja mësimore gjatë mësimdhënies? Nga 240 mësimdhënës, 124 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Shumë’, 57 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Pak’, 27 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Aspak’, 22 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 10 mësimdhënës nuk janë përgjigjur. Nga kjo mund të konkludojmë që shumica e mësimdhënësve janë shprehur se zbatojnë shumë metoda dhe teknika të reja mësimore gjatë mësimdhënies.

Figura: 25 Zbatoni metoda dhe teknika të reja mësimore në mësimdhënies?






Tabela: 30 Jeni në ndjekje të ndryshimeve inovative që ndodhin në shkollë dhe jashtë saj?

Jeni në ndjekje të ndryshimeve inovative që ndodhin në shkollë dhe jashtë saj? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count								
		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDER BEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDER BEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMO RËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Jeni në ndjekje të ndryshimeve inovative që ndodhin në shkollë dhe jashtë saj?	SHUMË	23	18	27	25	15	17	125
	PAK	8	16	7	7	14	11	63
	ASPAK	4	3	3	4	6	6	26
	NUK E DI	4	2	1	3	4	6	20
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	1	2	1	1	0	6
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Jeni në ndjekje të ndryshimeve inovative që ndodhin në shkollë dhe jashtë saj? Nga 240 mësimdhënës gjithsej, 125 mësimdhënës janë shprehur ‘Shumë’, 63 mësimdhënës janë shprehur ‘Pak’, 26 mësimdhënës janë shprehur ‘Aspak’, 20 mësimdhënës janë shprehur ‘Nuk e di’ dhe 6 mësimdhënës nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë se shumica e mësimdhënësve janë shprehur se janë në ndjekje të ndryshimeve inovative.

Figura: 26 Jeni në përcjellje të ndryshimeve inovative që ndodhin në shkollë dhe jashtë saj?




Tabela: 31 I përzgjidhni vetë inovacionet mësimore gjatë mësimdhënies?

I përzgjidhni vetë inovacionet mësimore gjatë mësimdhënies? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" 'Përlepnicë'	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" ' Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
I përzgjidhni vetë inovacionet mësimore gjatë mësimdhënies?	SHUMË	22	28	14	23	18	18	123
	PAK	11	7	14	8	16	16	72
	ASPAK	4	3	6	4	3	3	23
	NUK E DI	2	1	4	4	2	2	15
	KANË DEVIJUAR ( Nuk janë përgjigjur )	1	1	2	1	1	1	7
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: I përzgjidhni vetë inovacionet mësimore gjatë mësimdhënies? Nga 240 mësimdhënës gjithsej, 123 mësimdhënës janë shprehur ‘Shumë’, 72 mësimdhënës janë shprehur ‘Pak’, 23 mësimdhënës janë shprehur ‘Aspak’, 15 mësimdhënës janë shprehur ‘Nuk e di’ dhe 7 mësimdhënës nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë që shumica e mësimdhënësve janë shprehur se ata vetë i përzgjedhin inovacionet mësimore gjatë mësimdhënies.

Figura: 27 I përzgjidhni vet inovacionet mësimore gjatë mësimdhënies?




Tabela: 32 Në mungesë të inovacioneve mësimore, shfrytëzoni alternativa të tjera?

Në mungesë të inovacioneve mësimore, shfrytëzoni alternativa të tjera? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Në mungesë të inovacioneve mësimore, shfrytëzoni alternativa të tjera?	SHUMË	21	15	14	22	28	28	128
	PAK	7	14	14	11	7	7	60
	ASPAK	5	6	6	4	3	3	27
	NUK E DI	4	4	5	2	1	1	17
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	3	1	1	1	1	1	8
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme mund të shohim rezultatet për pyetjen: Në mungesë të inovacioneve mësimore, shfrytëzoni alternativa të tjera? Nga 240 mësimdhënës gjithsej, 128 janë përgjigjur ‘Shumë’, 60 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Pak’, 27 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Aspak’, 17 mësimdhënës janë përgjigjur ‘Nuk e di’ dhe 8 mësimdhënës nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë që shumica e mësimdhënësve janë shprehur se, në mungesë të inovacioneve mësimore, i shfrytëzojnë alternativat e tjera.

Figura: 28 Në mungesë të inovacioneve mësimore, shfrytëzoni alternativa të tjera?




Tabela: 33 Keni pasur raste të vërtetoni arritjet e rezultateve më të mira me nxënës atëherë kur keni zbatuar strategji të reja në mësimdhënie?

Keni pasur raste të vërtetoni arritjet e rezultateve më të mira me nxënës atëherë kur keni zbatuar strategji të reja në mësimdhënie? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
		SHFMU "THIMI MITKO" Gjilan	SHFMU "SKËNDERBEU" Përlepnicë	SHFMU "FAN S NOLI" Kamenicë	SHFMU "SKËNDERBEU" Hogosht	SHFMU "DËSHMORËT E VITISË" Viti	SHFMU "NJAZI REXHEPI" Sllatinë	
Keni pasur raste të vërtetoni arritjet e rezultateve më të mira me nxënës atëherë kur keni zbatuar strategji të reja në mësimdhënie?	SHUMË	16	22	21	21	15	15	110
	PAK	14	9	9	7	14	14	67
	ASPAK	6	4	4	5	6	6	31
	NUK E DI	3	4	5	4	4	4	24
	KANË DEVIJUAR (Nuk janë përgjigjur)	1	1	1	3	1	1	8
Total		40	40	40	40	40	40	240

Nga tabela e mësipërme mund të shohim se për pyetjen: Keni pasur raste të vërtetoni arritjet e rezultateve më të mira me nxënës, atëherë kur keni zbatuar strategji të reja në mësimdhënie? Nga 240 mësimdhënës, 110 mësimdhënës janë shprehur ‘Shumë’, 67 mësimdhënës janë shprehur ‘Pak’, 31 mësimdhënës ‘Aspak’, 24 mësimdhënës ‘Nuk e di’ dhe 8 mësimdhënës kanë devijuar apo nuk kanë dhënë përgjigje. Nga kjo mund të konkludojmë se pjesa më e madhe e mësimdhënësve, janë shprehur se kanë pasur raste të vërtetimit të arritjeve të rezultateve më të mira në rastet kur kanë zbatuar strategji të reja mësimore.

i Figura: 29 Keni pasur raste të vërtetoni arritjet e rezultateve më të mira me nxënës atëherë kur keni zbatuar strategji të reja në mësimdhënies?




Tabela: 34 Në rastet kur në klasë zbatoni inovacione mësimore, keni vërejtur ndryshime pozitive tek nxënësit tuaj?

Në rastet kur në klasë zbatoni inovacione mësimore, keni vërejtur ndryshime pozitive tek nxënësit tuaj? * SHKOLLA Crosstabulation								
Count		SHKOLLA						Total
